



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 12 MAJ 2011**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
12. MAJA 2011. GODINE**

**MAJ – MAJA
2011**

E enjte, 12.5. 2011, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Pasi kjo pikë nuk kërkon numrin e duhur ose kuorumin, mund t'ia fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës-

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Në pajtim me nenin 47 të Rregullores së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetëve deri në 3 minuta.

Andaj, kërkoj nga deputetët e paraqitur për diskutim që të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën. Ju njoftoj se 30 minutshi është i rezervuar për deputetë dhe nuk ka replika, as kundër replika.

Vazhdojmë me diskutime.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit Parlamentar, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë që në start po e sqaroj që këtë që do ta them, nuk është personale, që të mos ketë keqkuptim, sepse unë jam deputet, mandati i dytë.

Duke pasur parasysh faktin se kryetarët e komunave janë udhëheqës që zgjidhen me votën e lirë dhe të drejtpërdrejtë të qytetarëve, duke pasur parasysh faktin se institucioni i kryetarit të komunës është përgjegjës direkt për jetën e qytetarëve të vet në komunën përkatëse, duke pasur parasysh faktin se shumë kryetarë komunash janë votuar një herë e më shumë mandate dhe kanë pasur përkrahjen e qytetarëve të komunave përkatëse, duke pasur parasysh faktin se gjatë ushtrimit të mandatit disa kryetarë komunash dhe janë vrarë siç janë: zoti Ismet Raci, kryetar i Klinës, Ukë Bytyqi, i Suharekës, disa kanë vdekur natyrshëm do të thotë si Faruk Spahiu, Fadil Ferati, duke pasur parasysh gjendjen e familjeve të njerëzve të cilët vërtet e kanë pasur besimin e qytetarëve edhe sot e kanë ata që janë aktual, në emër të Grupit do ta bëjmë edhe me shkrim, por po e ngre si çështje që të hartohet një ose të nxjerrjet një vendim ose të bëhet plotësim- ndryshim i ligjit, varësisht ku mund t'i gjendet vend i rregullimit të statusit të kryetarëve të komunave. Pas përfundimit të mandatit në mënyrë të rregullt, pas përfundimit në mënyrë të dhunshme nëse mund të thuhet ose me vdekje, ose me vrasje apo edhe me humbjen e aftësisë së tyre për të vepruar.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kemi raste të shumta kur kryetarët ose ish kryetarët e komunave në mungesë ose pas përfundimit të mandatit të tyre, familjet e tyre nuk i kanë as kushtet minimale për jetesë, a i bën nder kjo Kosovës edhe qytetarëve të komunave përkatëse që një ish kryetar komune të mos ketë rregulluar statusin e tij pas përfundimit të mandatit në cilindo formë që e përmenda? A duhet që kryetarët ose familjet e kryetarëve të komunave të presin t'u rriten anëtarët e familjes ose fëmijët e tyre, në mënyrë që të kenë një burim ekzistence? Kjo vlen thashë edhe më herët për kryetarët në cilindo formë që e kryejnë mandatin edhe në cilindo mënyrë që e kryejnë mandatin e rregullt.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e thashë edhe në fillim po e përsëris, me shkrim do t'i drejtohet institucioneve përkatëse për rregullimin e statusit të kryetarëve të komunave, sepse është shumë e padrejtë dhe sot keni, pa e nënçmuar askënd, mund dikush të bëhet ministër, mund të bëhet këshilltar, pa asnjë votë nga qytetarët dhe njerëz në të ardhmen e tillë, përgjegjësit e tillë që e kanë rëndësinë ta kenë të rregulluar statusin e tyre edhe të familjeve tyre sikur që edhe ne si deputetë ta kemi të rregulluar statusin tonë të mos e kenë kryetarët e komunave që bartin një barrë të madhe të punës dhe përgjegjësisë që vrapojnë pas tyre derisa t'i zgjedhim, që kërkojnë punë dhe përgjegjësi, mendoj që, jo që është e paqëndrueshme, por kjo nuk bën në asnjë mënyrë të mos rregullohet dhe besoj që në këtë drejtim institucionet tona, varësisht nga ato që janë përgjegjëse këtë do ta kenë parasysh dhe po e them ne do ta bëjmë edhe me shkrim dhe do ta ngrehim këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Ata që kanë qenë të lajmëruar në mbledhjen e kaluar a donë ta tërheqin fjalën e tyre? Gëzim Kelmendi, është nga seanca e kaluar.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, kryetar!

Unë desha vetëm t'ju njoftoj që tërhiqem nga rendi i fjalimit, pasi që tema sot nuk është aktuale siç ishte para dy jave.

KRYETARI: Mirë faleminderit!

Fikrim Damka, nuk është këtu.

Berat Buzhala e ka fjalën.

BERAT BUZHALA: I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kisha dashur ta ngris një shqetësim lidhur me informatat që i kam marr mbrëmë prej mediave, lidhur me rezistencën e komunës së Prishtinës ndaj Policisë, Shërbimit Policor të Kosovës. E kemi parë përmes mjeteve të informimit se policia është bllokuar ta kryejë punën e vet në komunën e Prishtinës, është ndaluar. Kjo është në vazhden e bllokadës që kryetari i komunës edhe sabotazhet që i bën Shërbimit Policor të Kosovës, në deklaratat e tij që thënë më së buti e kanë dëmtuar gati pariparueshëm Shërbimin Policor të Kosovës. Ky shërbim sipas të gjitha sondazheve dhe sipas të gjitha matjeve të opinionit publik ka qenë institucioni që ka gëzuar reprezentacionin më të madh të qytetarët e Republikës së Kosovës. Prandaj, kisha kërkuar prej përgjegjësve, ministrit të Punëve të Brendshme, drejtorit të Policisë që të na japin informata shtesë se çka po ndodhë me rastin edhe a ka policia në ndikimin e deklaratave politike të kryetarit të komunës së Prishtinës? Ne e

kemi parë se institucioni siç e thashë edhe më herët që gëzon respektin më të madh te qytetarët, është quajtur si masat që i kanë ndërmarrë ata në luftimin e korrupsionit, janë krahasuar me UDB-në edhe me metodat staliniste. Prandaj, kërkoj që kryetari, do të ishte mirë, kryetari i komunës së Prishtinës, i cili është lideri i partisë më të madhe opozitare të shpjegojë lidhur me këtë rast. Rasti siç dihet i hetimeve është në gjykatë dhe gjyqtari i gjykatës paraprahe ka caktuar 30 ditë paraburgim për gjithë ata që dyshohen për korrupsion. A do të thotë që kryetari i komunës së Prishtinës akuzon edhe gjykatat që janë pjesë e SHIK-ut, që janë pjesë edhe e fushatës së UDB-së? Unë mendoj që Ministria e Drejtësisë edhe gjyqtarë që janë caktuar në të gjitha gjykatat e Prishtinës edhe gjykatat e Kosovës kanë qenë ekskluzivisht nën mandatin e ministrave të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe presidentëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Prandaj, do të ishte mirë që kjo çështje të sqarohet. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Ju lutem, ju e dini unë me qëllim iu tregova në fillim, nuk ka replikë. Fjalën e ka deputeti Ramiz Kelmendi.

RAMIZ KELMENDI: I nderuar kryeparlamentar,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Agrari si mundësi e madhe e zhvillimit ekonomik dhe mundësi e përmirësimit të gjendjes sociale të qytetarëve të Republikës së Kosovës është në hall të madh, sepse duke pritur plasmanin të ballafaqohet me tatimimin e dyfishtë që ekziston mbi këto produkte, prandaj, këta agrarë presin nga ne eliminimin e këtij fiskalizimit të dyfishtë. Duke hequr këtë ne do t'iu mundësojmë të jenë konkurrentë me prodhuesit e rajonit, të ngrisin numrin e rendimenteve më shumë se një siç është sot, të krijojmë ambient për prodhimtari eksportuese, do të legalizojmë dhe të kemi informata mbi qarkullimin e parasë, do të eliminojmë informalitetin e imponuar mbi këtë lami, do të kemi shtrirje horizontale fiskale dhe do të kemi rritje të buxhetit të Kosovës dhe do të kemi mundësi të parandalojmë importin e këtyre produkteve duke i zvogëluar çmimet në atë masë që këta agrarë nuk kanë mundësi që të jenë të barabartë me këta matrapazë importues.

Prandaj, i ftoj ministrat e resorëve të caktuar adekuat që të bëjnë një hap të vogël fiskal për ne dhe një hap i madh gjigant për ata agrarë të cilët presin që t'i gëzojnë familjet e veta dhe të përmirësojnë gjendjen, mirëqenien sociale të vetën dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Afrim Hoti.

AFRIM HOTI: I nderuar kryetar,
Të nderuar deputetë,

Kanë kaluar 12 vjet nga përfundimi i luftës dhe gjendja në lidhje me personat e rrëmbyer dhe të zhdukur vazhdon të mbetet e njëjtë. Janë më shumë se 1800 persona të zhdukur dhe kjo shifër nga dita në ditë për institucionet e Kosovës po kthehet vetëm në një numër që s'do të thotë asgjë e më shumë. Kjo fatkeqësi që bart vulën e shtetit serb, për fatin e keq të familjarëve, nuk po perceptohet si fatkeqësi e krejt Kosovës, por si vetëm e këtyre

familjarëve dhe këtu qëndron problemi dhe mungesa e seriozitetit se nuk e ka marrë seriozisht e tregon edhe vetë fakti që rritjen e fundit të rrogave kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, vendosi t'i diskriminojë dhe t'i dëmtojë vetëm familjarët e të zhdukurve, duke mos ua ngritur pensionet vetëm kësaj kategorie e cila vazhdon të përjetojë dhimbjen më të rëndë. Ky është vetëm një element që tregon se pika e ndjeshmërisë së Qeverisë për sa i përket angazhimit për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur është zero. Bile kaq e pandjeshme është kjo Qeveri, sa çështjen e të zhdukurve ka vendosur ta bëjë një nga temat e bisedimeve që po zhvillon me Beogradin. Nga informacionet e mediave në takimin e radhës në Bruksel do të diskutohet pikërisht kjo temë. Është e turpshme që një çështje të tillë thellësisht humane që vjen si pasojë e një krimi i cili është bërë në mënyrë të organizuar dhe të qëllimshëm nga shteti serb, të hidhet në tavolinën e bisedimeve. Merreni me mend, këta po pranojnë të negociojnë për viktimat me vetë atë që e ka kryer krimin, kjo shkon përtej absurdit. Po të ishte serioze kjo Qeveria, gjëja minimale që duhet të bënte ishte t'i kushtëzonte bisedimet pikërisht me çështjen e të zhdukurve, pra kurrësi të mos pranonte të fliste me Beogradin, pa e pranuar krimin e kryer dhe pa i rikthyer personat e rrëmbyer.

Po ne si deputetë, përfaqësues të popullit nuk duhet të qëndrojmë duarkryq e të shohim se çfarë po bën Qeveria, as nuk duhet të mjaftohemi vetëm me ndonjë rezolutë si ajo e vitit 2003, e miratuar nga ky Parlament, por duhet që njëzëri të bëjmë presion tek institucionet vendore e ndërkombëtare për ta zgjidhur një herë mirë këtë punë, për këtë duhet ndërmarrë veprime konkrete, në radhë të parë hapja e një gjykate për krime të luftës, e cila është edhe kërkesë e familjarëve. Së dyti të bëhet intensifikimi i procesit të gjetjes së gjurmëve të njerëzve të evidentuar si të zhdukur dhe njoftimi sa më parë me të vërtetën i familjarëve të tyre. Të shtohet trusnia në Zyrën për Mjekësi Ligjore dhe të Zhdukur në Prishtinë për identifikimin e mbi 400 mbetjeve mortore të cilat qëndrojnë aty tash e sa vite. Të fillojë sa më parë ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, Afrim! Nuk je lajmëruar në emër të grupit parlamentar. Jo, unë regjisë po i them ta vazhdojë, Afrim, veç një gjë po ta them, me diçka të dhimbshme nuk është mirë t'i lëndosh të tjerët. Regjia, vazhdoja fjalën!

AFRIM HOTI: Të shtohet trusnia në Zyrën për Mjekësi Ligjore dhe të Zhdukur në Prishtinë për identifikimin e mbi 400 mbetjeve mortore të cilat qëndrojnë ty tash e sa vite. Të fillojë sa më parë incizimi i kallëzimeve penale për të gjitha krimet e shumta që janë ndaj popullatës civile në Kosovë dhe nxjerrja para drejtësisë e të gjithë kryesve të krimeve. Të merren masa urgjente për miratimin dhe fillimin e implementimit të Ligjit për të pagjeturit e luftës së fundit në Kosovë në interes të së drejtës, të së vërtetës dhe të paqes, të përkrahet ideja e ngritjes e një qendre përkujtimore në nivel të vendit ku do të ruheshin artefakte dhe të gjitha gjësendet të tjera si dëshmi reale për atë se çka ka ndodhur në Kosovë. Vetë familjarët e të zhdukurve janë thellësisht të pakënaqur me punën që kanë bërë institucionet, madje ndihen të braktisur prej tyre. Unë ju bëj thirrje të gjithëve unë ju bëj thirrje të gjithëve për një angazhim të nivelit shtetërorë, të bëjmë presion të vazhdueshëm të bashkësia ndërkombëtare, që ta detyrojë Beogradin të na i

kthej familjarët dhe ai të dënohet për krimet që ka bërë në Kosovë, në të kundërtën do të vazhdojnë të na marrin nëpër këmbë si shtet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Arsim Bajrami, me kartelën e Nait Hasanit.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuari kryetar i Kuvendit!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Kolegë deputetë,

Mora fjalën për të informuar seancën plenare për fillimin e punës së Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mbi bazën e Rezolutës së miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Komisioni tani është funksional, ne kemi miratuar planin e veprimit dhe jemi të gatshëm që të përmbushim mandatin që e kemi marrë nga Kuvendi për të bërë amendamentet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës brenda afatit kohor.

Ne do të informojmë seancën plenare në baza të rregullta për progresin e arritur në procesin e ndryshimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe kërkoj si kryesues i Komisionit nga të gjitha partitë politike parlamentare që të mbështesin punën e Komisionit jo vetëm me anëtarët e Komisionit por edhe me ekspertë në mënyrë që ndryshimet kushtetuese të bëhen në afatin e duhur dhe të bëhen në mënyrë sa më profesionale.

Siç e dini ne e kemi një mandat të caktuar për të bërë ndryshime kushtetuese, por jemi në dispozicionin e Kuvendit se sipas autorizimit të Kuvendit të bëjmë rishikimin kushtetues edhe në segmente tjera për të cilat autorizohemi.

Gjithashtu dëshiroj të falënderoj Kryesinë e Kuvendit për mbështetjen e Komisionit. Kemi një problem për shkak se ky komision është një komisioni i përkohshëm i formuar pas miratimit të buxhetit dhe për momentin ky komision sikurse edhe komisioni tjetër që merret me reformën e Ligjit zgjedhor nuk ka fare buxhet dhe do të kërkojmë mirëkuptim nga Kryesia e Kuvendit që ta akordojnë një buxhet të përkohshëm deri te rishikimi i buxhetit ku komisioni do të financohet sipas rregullave unike të financimit të komisioneve.

Plani i veprimit që ne e kemi bërë dhe që kemi shpërndarë dhe do të miratohet ditën e nesërme, parasheh një punë intensive të komisionit, një punë që do të zgjatë për 9 muaj dhe do të përfundojë brenda afatit 9 mujor, dhe ne e kemi ndarë punën kryesisht në tri etapa.

Etapa e parë do të jetë identifikimi i dispozitave kushtetuese që i nënshtrohen amendamentimit dhe siç duhen këto ndryshime nuk do të jenë teknike, sepse ndryshimi i mënyrës së zgjedhjes së presidentit kërkon edhe disa rishikime të ndarjes së pushteteve.

Në fazën e dytë është paraparë kryesisht një proces i draftimit të amendamenteve, do të identifikojmë sa amendamente do të duhen për ta përmbushur këtë reformë kushtetuese.

Kurse, në fazën e tretë ne do të hartojmë edhe një ligji i cili del nga mandati i dhënë nga Kuvendi Ligji për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit, që është një ligj i parë të cilin Kosova nuk e ka pas. Në mënyrë që të krijojmë kompletë kornizën e nevojshme kushtetuese dhe kornizën ligjore për implementimin e reformës kushtetuese të cilën e kemi miratuar me rezolutë me të cilën kemi mbështetur memorandumin e kryesuesve të tri partive politike për daljen nga kriza kushtetuese. Dola vetëm për të informuar.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Xhevdet Neziraj, e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të ngrejë një çështje për një organizim që është bërë dje nga Këshilli i Evropës i cili ka të bëjë me një takim që ka marrë pjesë edhe zëvendëskryeministri dhe ministrja për Integritet Evropian, dhe dua të them që në atë organizim ose kanagjeq që e ka bërë Këshilli i Evropës në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, kanë fyer shumë rënd integritetin edhe të komunitetit egjiptian për arsye se mediat edhe elektronike edhe të shkruara po e qesin akronimin në RAE që unë si përfaqësues i këtij komuniteti jam kundër, bile edhe ministrja në orën 23:00 në lajme e përmend këtë akronim dhe nuk është mirë që të përdoret ky akronim se me kushtetutë janë cekur origjina e të gjitha komuniteteve dhe është hera e fundit që edhe Qeveria, po edhe në WEB faqen e Kuvendit të hiqet akronimi RAE se nuk i takon nderë këtij Kuvendi dhe të Qeverisë së Kosovës. dhe Këshilli i Evropës mua më qon ftesë dhe më thotë që të marr pjesë në atë takim pa drejtë fjale. Dua ta pyes edhe Qeverinë, dua t'i pyes edhe njerëz tjerë kusht duhet që në emër të komunitetit egjiptas të fol, a duhet deputeti i zgjedhur me vota, apo duhen shoqatat civile, KFOS-i dhe shumë të tjerë që kanë harxhuar me mijëra euro për një strategji që ja ka shitë Qeverisë dhe që ajo strategji nuk ka kaluar në Kuvend të Kosovës dhe nuk janë pyet as deputetët e këtyre komuniteteve, por është një strategji e thatë, një strategji vetëm për t'u arsyetuar se gjëja po bëhet boll e po veprohet për këto komunitete. Është mirë që Qeveria ta lexojë raportin e OSBE-së për këto tri komunitete që s'është duke bërë kurrëgjë dhe s'ka bërë asgjë deri tash. Gjithashtu s'ka bërë asgjë as Këshilli i Evropës dhe është shumë keq që ata me ftesa të tilla të thërrasin në atë takim dhe të thonë që t'i mos merr pjesë në diskutim, thua se unë jam lemez dhe duhet t'i dëgjoj ata çka thonë. Do të thotë, është hera e fundit që Qeveria e Kosovës të bëjë strategji pa njerëz adekuat dhe pa njerëz që janë thirrur. Besoj që edhe kryetari i Kuvendit do të bëjë një kërkesë që në WEB faqen e Kuvendit të hiqet akronimi RAE, përndryshe dikush duhet të dalë në Gjykatë Kushtetuese, sepse WEB maisteri i faqes tha e kam marrë këtë vendim nga sekretaria e Kuvendit. Nëse ka mbetur që sekretaria e Kuvendit t'i tregojë se cilët komunitete qysh duhet të thirren me akronime, atëherë është mirë që ta dimë këtu. Nuk është mirë që akronime të përdoren për komunitete. A do të ishte mirë të përdoret për shqiptarët SH, për boshnjakët B dhe për ashkalitë A dhe del shkurtesa SHBA? Nuk di a ka kuptim? Është mirë që një herë e përgjithmonë t'i jepet fund kësaj ngjarje. Gjithashtu, edhe mediat elektronike, Televizioni publik i RTK-së mbrëmë i ka fyer shumë rënd, vetëm 5 sekonda ka dhënë lajme, ndërsa menjëherë pas ka pasuar një ngjarje tjetër ku është fol për racat e qenve

KRYETARI: Faleminderit!

Kuvendi sipas vendimit të KQZ si ka qenë vendimi i KQZ-së, e ka qitur në faqen e vetë. Përndryshe, Kuvendi kur ka të bëjë me dokumentet e veta, e trajton siç e trajton kushtetuta. Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Në interpelancën e kaluar ne ia parashtruam Qeverisë një 7 pyetje konkrete dhe Qeveria nuk u përgjigj në asnjërën prej tyre. Pyetja e parë që iu bë kryeministrit Thaçi ishte se “A e njeh ai Republikën e Serbisë”? Por, mund të them se e vetmja pyetje në të cilën Qeveria është përgjigjur gjatë javës është kjo pyetje, pra pikërisht e para, sepse Qeveria tashmë po e pret mes Prishtinës përfaqësuesin e Serbisë që nuk na njeh, kryenegociatorin Borko Stefanoviq. Pra, Qeveria e Kosovës jo vetëm që e njeh Serbinë që nuk po na njeh, por i fton përfaqësuesit e saj që ta përhapin propagandën e tyre helmuese antishqiptare dhe shtetit të Kosovës, madje kësaj radhe nga objekti i Qeverisë së Republikës sonë. Ky është një turp i madh dhe skandal i pashoq. Në pyetjet tjera, 6 pyetjet tjera ne nuk kemi marrë përgjigje ende. Kryeministri u pyet se a i ka transkriptet e bisedave me Robert Kuperin kur u përcaktuan temat dhe agjendat e bisedimeve me Serbinë? U pyet pse Qeveria e Kosovës nuk po merr masa reciprociteti ndaj Serbisë? U pyet nëse ekzistojnë transkriptet e negociatave që po zhvillohen në Bruksel? U pyet se a ekzistojnë me shkrim pozicionet politike të delegacionit të Kosovës si dhe rezultatet apo konkludimet e deritashme të negociatave? U pyet se a ka platformë Qeveria e Republikës së Kosovës në këto negociata? Dhe në fund u pyet se a do t’i pranojë ai regjistrat, domethënë kopjet e regjistrave civilë.?

Kur gati e harxhoi kohën e tij duke recituar për Rambujenë, Bashkimin Evropian, NATO-në e të tjera, kërkoi kohë shtesë që të na e lexonte platformën e negociatave. Nëse Qeveria ka platformë të negociatave, pse nuk ua ka dorëzuar atë deputetëve të Kuvendit para se të fillonin këto negociata?

Qeveria e Kosovës është vërtet e mbrapshtë. Në vend që në fillim të prezantojë platformë, ta paraqesë atë në Kuvend eventualisht si rezolutë e pastaj eventualisht mendoj a të shkohet në negociata a jo, Qeveria e Kosovës fillimisht ka shkua në negociata, pastaj na ka prezantuar këtu një rezolutë a të shkohet në negociata a jo dhe sot na flet për platformë të negociatave kur pritet tashmë që të mbahet rundi i katër i këtyre negociatave. Kështu funksionon Qeveria e Republikës së Kosovës, shtëpinë e ndërton prej kulmit, e kjo punë nuk bëhet.

Në kohën që ne po flasim këtu në Kuvend, përfaqësues të lartë të Qeverisë po takohen me Borko Stefanoviqin. Ky zyrtar serb jo vetëm që nuk do të duhej të takohet, por atij nuk do të duhej t’i lejohej fare hyrja në Republikën e Kosovës. Borko Stefanoviq, përfaqëson shtetin e Serbisë, shteti i Serbisë e ka pushtuar Kosovën, e ka shtypur atë për një shekull, i ka shkatërruar shtëpitë tona....

KRYETARI: Tre minuta i ke, i keni harxhuar ju, grupi i juaj 5 minuta. Hajt përfundoje gjysmë minute.

GLAUK KONJUFCA: Atëherë, çka do që Kosova rrezikon të humbë me Serbinë, në çfarëdo aspekti që do të mund të dëmtohet integriteti territorial apo sovraniteti i Kosovës, përgjegjëse definitivisht duhet të mbahet kjo Qeveri e papërgjegjshme, e cila ka mirëkuptim të pa arsyeshëm për ambiciet hegjemoniste të Serbisë në Kosovës.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Zenun Paraziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Javën që shkoi, në adresën time në Kuvend ka ardhur një letër, një petition i nënshkruar nga disa qindra qytetarë të regjionit të Anamoravës. Unë nuk do t'ju lexoj apelin, do t'ju lë një kopje, më duket që ka ardhur edhe në një adresë tjetër, ndoshta edhe të kryetarit të Kuvendit, ministrit të Zhvillimit dhe të Infrastrukturës.

Më lejoni vetëm t'ju lexoj disa reshta nga letra dhe t'ju njoftoj për çka është fjala. Mendoj që pavarësisht se unë kam bërë disa angazhime në ndërkohë dhe disa njoftime, kam edhe disa informata, më duket e rëndësishme që sot t'ju prezantoj në Kuvend.

“Ne intelektualët e Anamoravës, të indinjuar me zhvillimin e pabarabartë rajonal dhe shpërnguljen masive të popullsisë nga zonat kufitare të viseve Gollapit dhe Karadakut, si rrjedhojë e mungesës së investimeve në viset rurale dhe infrastrukturore nga rajoni i Anamoravës, po ju drejtohem me këtë apel me shpresë që diçka do të ndërmerret në favor të zhvillimit të pabarabartë të rajoneve të Kosovës. Hidhërimi ynë shtohet edhe më tepër kur vërejmë se edhe me vizionin e zhvillimit ekonomik nuk parashihi investime kapitale infrastrukturore për këtë rajon. Margjinalizimi politik dhe ekonomik i rajonit të Anamoravës jo vetëm që i rritë problemet sociale, por edhe e çrregullon edhe ambientin, përbërjen e biznesit dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës. Rritja e presionit të popullsisë së shpërngulur nga këto vise qendra urbane, mbi të gjitha në Prishtinë, i rritë edhe më tepër tensionet sociale dhe ekonomike të Kosovës”.

Më lejoni t'ju them që unë në ndërkohë kam parë edhe kam marrë edhe disa informata në Ministri respektive, kam parë që me të vërtet për sa i përket rrugëve në këtë regjion, projektet e fundit janë të viteve 70 diku, domethënë nuk ka asnjë projekt as ideor, as tjetër. Kisha kërkuar që para rishikimit të buxhetit në Ministrinë e Infrastrukturës të mendohet mirë për këtë çështje. Unë e di që nuk është fjalë vetëm për një regjion, ka çështje të ndjeshme të tilla të rrugëve që lidhen edhe me kufirin me Malin e Zi, edhe me Maqedoninë, por megjithatë është mirë që të dilet me një projekt ose me një plan të përgjithshëm me prioritete dhe sidomos kur kemi të bëjmë me çështje specifike. Ju e dini që në atë anë është i koncentruar edhe një numër i madh i qytetarëve të Luginës së Preshevës dhe kërkesat janë, përveçse ekonomike, po ashtu edhe politike edhe me karakter të rëndësishëm nacional. Unë pres dhe do të jetë shumë e rëndësishme edhe për mua personalisht, por edhe për të tjerët që me rishikimin e buxhetit të kemi një përgjigje

konkrete në këtë drejtim dhe kjo do të ndikonte pozitivisht edhe te këta qindra qytetarë të profileve të ndryshme që kanë nënshkruar këtë apel. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Koha është e harxhuar. Ka mbetur vetëm Agim Kuleta për seancën e radhës ose po e kryejmë Afrim edhe unë jam dakord.

Fjalën e ka deputeti Agim Kuleta.

AGIM KULETA: Zoti kryetar i Kuvendit,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Faleminderit që ma krijuat mundësinë të flas sot!

Për çdo çështje apo fenomen të caktuar ekzistojnë qëndrime të ndryshme që shpeshherë dinë të jenë edhe diametralisht të kundërta, përderisa për dikë një fenomen është absurd, për tjetrin është rrjedhë normale e gjërave, se cili ka të drejtë, në këtë rast, vlerësohet nga motivi në të cilin bazohet ky qëndrim.

Një fenomen të tillë e kemi edhe ne prezent qysh pas përfundimit të luftës, do të thotë që 12 vjet prej përfundimit të luftës dhe 3 vjet pas shpalljes së pavarësisë ne vazhdojmë të përdorim prefikse të huaja. Përveç të tjerash, ne vazhdojmë të përdorim prefiksin e një shteti i cili deri dje na ka mbajtur të pushtuar, ndërsa sot vazhdon pandërprerë në çdo variant që ka mundësi dhe në çdo rrethanë të punojë dhe të bëjë obstrukcione kundër nesh. Këtë shërbim që ia bëjmë ne këtij shteti, përveç kostos politike, neve na kushton edhe miliona euro. Pasojat e përdorimit të këtyre prefikseve janë shumë të mëdha dhe të gjithanshme, mirëpo unë do t'i profilizoj në dy fusha, në atë politike dhe ekonomike. Në kuptimin politik, rrjedhoja politike është kryesisht në përdorimin e prefiksit të Republikës së Serbisë. Në këtë rast, ne vetvetiu po e pranojmë që jemi pjesë e një tërësie pa qenë të detyruar ta bëjmë këtë dhe pikërisht në rrethanën kur ne do të duhet të përpiqeshim për të kundërtën e kësaj. Pasojë ekonomike bartin përdorimi që të tri prefikseve dhe vetëm prej pas luftës, në periudhën e pasluftës kur përdorim këto prefikse, llogaritet qindra miliona euro që Kosova ka humbur si pasojë e këtij përdorimi.

Situata është vërtetë alarmante, mirëpo unë nuk do të thosha se është pashpresë, sepse për të dalë nga ky absurd, ekziston një derë dhe për të hapur kjo derë ekziston një çelës se ky është kodi +355, do të thotë është kodi telefonik i Republikës së Shqipërisë. Përparësitë e përdorimit të këtij kodi janë të shumta, do t'i përmendi shumë shkurtimisht 2 – 3, është shkëputja edhe në një aspekt nga Republika e Serbisë, pra si element politik, pastaj është kostoja shumë e ulët e përdorimit të kodit +355 se sa e përdorimit të kodeve që përdoren aktualisht dhe komunikimi midis qytetarëve me përdorimin e këtyre dy kodeve, si në Republikën e Kosovës, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë dhe midis këtyre dyjave do të ishte një kosto shumë, shumë më e ulët. Vetëm më lejon një shembull, SHBA-të e përdorin të njëjtin kod me Kanadanë, e kanë +1. Në këtë situatë shtrohet logjikshëm pyetja - pse atëherë Republika e Kosovës nuk e përdor kodin e përbashkët me Republikën e Shqipërisë. Unë konsideroj se këtu në bazë të analizës që kemi bërë si Lëvizje për Bashkim, nuk kemi gjetur ndonjë pengesë reale

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe një minutë, Agimit!

AGIM KULETA: Pengesa e vetme reale është faktikisht mungesa e vullnetit nga Qeveria e Republikës së Kosovës për ta aplikuar këtë kod. Dhe për çdo njeri që në vlerësimin e tij motivohet nga dobia e përgjithshme, jo nga interesi personal, ky do të përbënte një absurd. Mirëpo, është shumë normale për dikë që e konsideron rrjedhë normale të gjërave shfrytëzimin e djersës së tjetrit për interesat e veta. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Tani kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetjet parlamentare

Në pajtim me nenin 45.1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputetët për një mbledhje mund të parashtrojnë më së shumti 2 pyetje.

Ju njoftoj se në këtë seancë kemi 5 pyetje parlamentare.

E fillojmë me pyetjen e parë të deputetes Alma Lama, pyetje për kryeministrin zotin Hashim Thaçi. Deputetja s'është këtu.

Vazhdojmë pyetjen e dytë, deputetja Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për zëvendëskryeministrin Behxhet Pacolli. Deputete zëvendëskryeministri Pacolli nuk është këtu, mund të parashtroni pyetjen.

Mirë, vazhdojmë. Pyetja e tretë, Teuta Haxhiu, pyetje për zëvendëskryeministrin Behxhet Pacolli, a do ta lexoni pyetjen deputete? Jo. Faleminderit!

Pyetja e katërt deputetja Salie Mustafa, pyetje për ministrin Ferid Agani. Ministri s'është këtu, deputete doni ta bëni pyetjen. Urdhëroni!

Fjalën e ka deputetja Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Edhe pse ministri i Shëndetësisë nuk është sot këtu, unë pyetjen do ta bëj dhe pres përgjigjen në një nga seancat e ardhshme.

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dihet se tani më në Kosovë ekziston një sasi e madhe e barërave me afat të skaduar. Pyetja për ministrin e Shëndetësisë është: “A ka ndonjë plan konkret ministri për grumbullimin dhe asgjësimin e këtyre barërave me afat të skaduar? Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ndoshta e dëgjon edhe ministri. Dhe pyetja e fundit, deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Ferid Agani. Deputete, doni ta bëni pyetjen?

Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendim numër 08/79 të datës qershor 25.2009, shfuqizoi vendimin paraprak për moslejimin e vazhdimet të punimeve të spitalit privat në hapësira të ngjitur me Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), dhe lejojnë ndërtimet private brenda hapësirës së QKUK-së. Sipas udhëzimit administrativ 08/2007 për shërbimin spitalor në Kosovë, neni 4.1 pika (f) thotë: “Objektet private spitalore duhen të jenë në largësi së paku 1.5 kilometra nga spitalet publike” dhe çuditërisht spitali vazhdon të ndërtohet pa u penguar nga Qeveria që thirret për sundimin e ligjit: Pyetja: “Cilat janë arsyet që Qeveria e Republikës së Kosovës i shfuqizon vendimet e veta dhe lejon precedencë për spitalet private në Kosovë dhe çka do të ndodhë me spitalet publike kur të mbushen oborret me spitale private”? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Dhe kjo ishte pyetja e fundit. Deputete, u vonove, fjalën e ka deputetja Alma Lama, pyetje për kryeministrin zotin Hashim Thaçi.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do të bëjë të njëjtën pyetje për kryeministrin e Kosovës, Cila është vlera e kontratës që është lidhur me konzorciumin mes Qeverisë së Kosovës dhe konzorciumit Bechtel & Enka në lidhje me autostradën, pra vlera e saktë e kontratës?

KRYETARI: Kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

E nderuara deputete,

Qeveria e Kosovës do të respektojë me përpikëri dispozitat e Marrëveshjes, pra do të respektohen plotësisht. Dëshiroj të theksoj se kjo marrëveshje ka qenë marrëveshja më e madhe ndonjëherë e arritur mes ndonjë qeverie të Kosovës me ndonjë konzorcium ndërkombëtar për të punuar në ndonjë projekt të Kosovës. Në anën tjetër, dëshiroj juve deputetë të nderuar dhe gjithë qytetarët e vendit, juve e nderuara deputete, megjithëse në vizitën e fundit kishe premtuar se do të vishë për t'i vizituar punishtet, ke munguar. Seksioni i parë, tani që është duke u punuar për 2 muaj, është duke shkuar para planit të paraparë, seksioni i dytë për 6 muaj, seksioni i tretë për 11 muaj para afatit të paraparë, ndërsa seksioni i katër veç kanë filluar punimet tani. Në autostradën Vërmicë – Merdare punohet në 43 kilometra, ndërsa theksoj se ishte planifikuar që deri më 30 tetor të përmbyllen së punuari 34 kilometra. Tani kemi konfirmimin se nga puna e mirë që po bëhet, por edhe puna para afatit të planifikuar dhe një bashkëpunimi të shkëlqyeshëm të Qeverisë së Kosovës me konzorciumin Bechtel & Enka, për çka falënderoj edhe gjithë autoritetet komunale edhe në Prizren, edhe në Therandë, edhe në Malishevë tash që kanë punuar për punuar për shpronësim të suksesshëm, do të thotë mund t'i informoj gjithë qytetarët e vendit edhe një herë se më 30 tetor do të përmbyllen së punuari 38 kilometra të autostradës Vërmicë – Merdare. Ndërsa, nga shtatori apo në fund të gushtit planifikojmë të fillojmë punimet edhe në seksionin e pestë Qafë e Dulës në drejtim të magjistrals Prishtinë – Pejë në Orllat. Vlera që ishte planifikuar natyrisht unë jam i obliguar t'i respektoj dispozitat e marrëveshjes sipas standardeve ndërkombëtare dhe gjithçka çka më lejon ligji, do të jetë rreth 700 milionë euro. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!
Deputete, ke pyetje shtesë? Regjia, fjalën deputetes!

ALMA LAMA: Faleminderit!

Pyetje shtesë nuk kam, sepse më në fund kryeministri e dha vlerën e kontratës 700 milionë, rreth, domethënë nuk është shifër e saktë. Zoti kryeministër, në pyetjen time ishte në kllapa, besoj që e keni marrë pyetjen, ishte shifra e saktë, domethënë shifër e saktë me të gjitha, edhe me centë e kam fjalën. Tjetra është që unë nuk bëra premtim herën tjetër, e keni kuptuar gabim, unë thashë në rast se do ta marrë parasysh ftesën, thashë në rast se ju do ta bëni publike kontratën. Dhe kjo përgjigje me gojë nuk mendoj që është bërja publike e kontratës, sepse ne duam ta shohim krejt kontratën dhe jo përafërsisht, sepse përafërsisht këtë shifër e ka dhënë edhe media. Pra, kërkojmë vlerën e saktë të kontratës.

KRYETARI: Faleminderit!

Pyetjet e deputetëve që nuk morën përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit, neni 45, paragrafi 11 i Rregullores së Kuvendit.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 5 maj 2011

Pyes, nëse ka vërejtje në këto procesverbale? Nëse nuk ka, konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 5 maj 2011.

Pika e katërt e rendit të ditës.

Ju njoftoj se në sallë kemi 89 deputetë.

4. Shqyrtimi i parë i projektligjit për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritet

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime andaj janë përmbushur kushtet për shqyrtim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Administratës dhe Pushtetit Lokal, zotin Slobodan Petroviq, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantoj dhe arsyetoj projektligjin

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Uvaženi zamenici premijera, ministri,

Narodni poslanici,

Međuopštinska saradnja se odnosi na saradnju dve ili više susednih opština koje zajedno rade na sprovođenju administrativnih opštinskih delatnosti, pružanju javnih usluga za građane i promovisanju lokalnog razvoja, kao i efikasnog i efektivnog značenja zakonom određenih nadležnosti u cilju postizanja zajedničkih interesa i ciljeva. Opštine u svim zemljama sprovode veoma značajne funkcije koje poboljšavaju uslove života građana,

kao javna dobra istih, kao na primer, putevi, saobraćaj, prevoz, škole i dečja obdaništa, zdravstveni centri, sportski objekti, skupljanje otpada, muzeji, pozorište i tako dalje.

Međutim opštine veoma često ne raspolažu neophodnom količinom sredstava koja bi im omogućila samostalno sprovođenje velikog broja funkcija na efektivan način.

Međuopštinska saradnja u takvim okolnostima podrazumeva angažovanje neophodnog broja radnika i finansijskih resursa za pružanje kvalitetnijih i jeftinijih javnih usluga. Susedne opštine su veoma često povezane kako fizički, tako i ekonomski, društveno i kulturno. Ekonomske aktivnosti jedne opštine mogu uticati na ekonomski razvoj susedne opštine. Prema tome, promovisanje i razvoj ekonomije i društva, koji nije štetan po susedne opštine, predstavlja još jednu značajnu funkciju koju bi te susedne opštine, posebno one manje, mogle da sprovedu preko međuopštinske saradnje.

Međuopštinska saradnja iz dana u dan postaje sve značajnija u današnjem globalizovanom u konkurentnom svetu, jer kako teritorije, tako i stanovništvo postaje sve više i više zavisno.

Jednom rečju, međuopštinska saradnja predstavlja reakciju na opštu revoluciju modernih društava. Centralne vlasti zemalja zapadne Evrope već godinama promovišu međuopštinsku saradnju kao mogućnost rešavanja problema, troškova i kvaliteta javnih usluga koje se javljaju u teritorijalno malim opštinama, u kojima su građani vršili pritisak za pružanje boljih usluga.

Cilj ovog predloga zakona je jasno određivanje pravnog okvira za organizaciju i funkcionisanje međuopštinske saradnje, kao i ostalih pitanja od značaja za međuopštinsku saradnju. Potreba za ovim predlogom zakona je veoma značajna i ima za cilj efikasnu i brzu realizaciju opštinskih usluga, lokalnih i urbanih razvoja opština preko različitih oblika međuopštinske saradnje koja je regulisana ovim predlogom zakona.

Razlog donošenja ovog predloga zakona je određivanje uslova i uspostavljanje međuopštinske saradnje, kao i oblika finansiranja i praćenja međuopštinske saradnje. Određivanje pravnog osnova i uspostavljanje jasne struktura Predloga zakona za međuopštinsku saradnju i partnerstvo. Ovaj Predlog zakon predstavlja i inovaciju zato što po prvi put ima za cilj pravno regulisanje organizacije i funkcionisanje međuopštinske saradnje i partnerstvo.

Poštovani narodni poslanici,

Predlog zakona je u saglasnosti sa Ustavom, a takođe je važno pomenuti i to da su regulativne mere ovog predloga zakona saglasne uslovima Evropske povelje za lokalnu samoupravu. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Fjala është ose rendi i fjalës është për kryetarin e Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini Sport, Administratë Publike, deputetin Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: I nderuar zoti kryetar,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,
Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 27.4.2011 shqyrtoi në parim Projektligjin për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqes këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete.

A r s y e t i m:

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete, vlerësoi se Projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim, në parim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Tani është radha e kryetarëve ose në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Xhevahire Izmaçu.

XHEVAHIRE IZMAKU: I nderuari kryetar,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Projektligji për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete ka përcaktuar mënyrën, kushtet dhe vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal, si dhe format dhe mënyrat për realizimin e këtij bashkëpunimi.

Bashkëpunimi ndërkomunal është me rëndësi për të gjitha komunat, pavarësisht madhësisë së tyre, por është veçanërisht me rëndësi për komunat e vogla të Republikës së Kosovës, sepse sa më e vogël komuna, aq më e lartë është kostoja për njësi dhe aq më i vogël është efikasiteti në kryerjen e funksioneve komunale. Fushat e bashkëpunimit ndërkomunal të përcaktuara me këtë Projektligj, janë: ofrimi i shërbimeve të përbashkëta publike dhe administrative, administrimi i përbashkët i shërbimeve të ofruara, planifikimi dhe zhvillimi i përbashkët dhe financimi i përbashkët. Ndërsa përfitimet nga bashkëpunimi ndërkomunal të përcaktuara me këtë projektligj, janë: ndarja e shpenzimeve administrative për kryerjen e detyrave dhe shërbimeve administrative, uljen e shpenzimeve për njësi dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, arritjen e madhësisë minimale ekonomike, e cila arsyeton ofrimin e këtij shërbimi, përmirësimin e performancës ekonomike sociale dhe të mbrojtjes së mjedisit përmes planifikimit të përbashkët dhe tërheqjen e fondeve të investimeve nga burimet publike, private ose donatorët, të rezervuara ose ekonomikisht të arsyeshme për projektet e një madhësie të caktuar minimale.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet në këtë fazë dhe vazhdon me vërejtjet e veta në fazën e më tutjeshme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Sadri Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Ju faleminderit, i nderuari kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Edhe ne në grupin parlamentar e kemi shqyrtuar dhe analizuar këtë projektligj. Mendojmë se është i rëndësishëm nga se me këtë ligj u jepet një mundësi më e madhe komunave në bashkëpunimet ndërkomunale që të mund të ngrisin kapacitetet në shërbimet më të mira administrative, për të zvogëluar koston dhe përmirësuar shërbimin që ofron për qytetarët. Prandaj, duke marr parasysh këtë, mendojmë se është e qëlluar që kjo çështje, pra kushtet dhe forma e bashkëpunimit të rregullohet me ligj të veçantë. Ky projektligj është në përputhje të plotë me parimet kushtetuese dhe me ligjet bazike për pushtetin lokal.

Ne kemi diskutuar dhe do të japim kontributin tonë në punën e mëtejme që do të bëhet në grupin funksional për të përmirësuar disa prej neneve dhe formave të përkufizimit, në mënyrë që ligji të bëhet më praktik. Me këtë rast do të theksoj vetëm dy momente, në nenin 16, duke marrë parasysh... e përgjegjësisë të komunave, natyrisht se komunat kanë nevojë në format e bashkëpunimit që do të ndodhin më tutje, mbështetjen e ministrive të linjave, por në formën e mbështetjes, por jo të monitorimit, ngase, atëherë kishte për t'u krijuar një konfuzion sepse edhe më tutje Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duhet të mbetet e vetmja ministri monitoruese. Por, pra në nenin 16, formulimi: "Komisioni për stimulim dhe monitorim" të jetë vetëm për mbështetje dhe stimulim, por jo monitorim. Dhe, një sferë që ky projektligj nuk i ka përfshirë fare, është bashkëpunimi ndërkombëtar ndërkomunal. Ne edhe tani kemi bashkëpunime të komunave me komunat e vendeve të tjera, siç janë binjakëzimet, por kjo lë vend që këto bashkëpunime të thellohen edhe më tutje. Prandaj, duhet që në kuadër të këtij projektligji të inkorporohet edhe pjesa e bashkëpunimit ndërkomunal ndërkombëtar.

Ne si grup parlamentar, me përfaqësuesit tonë në komision, do të japim kontributin tonë, në mënyrë që ky ligj të bëhet sa më praktik dhe në mbështetje të komunave.

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Lëvizjes "Vetëvendosje", kush e donë fjalën? Deputeti Afrim Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: I nderuari kryetar,

Të nderuar deputetë,

E para, Projektligji për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete, në bazë të një sërë abikuitetesh juridike dhe ambivalencë semantike, sidomos në nenin 3.1, kur thotë se "Bashkëpunimi ndërkomunal, në kuptim të këtij ligji nënkupton marrëdhëniet formale dhe joformale, të vendosura mbi dy apo më shumë komuna". Pra, mbetet e paqartë çfarë

nënkupton kjo “marrëdhënie joformale”, apo ndoshta Qeveria e Kosovës është mësuar të krijojë vetëm marrëdhënie joformale.

E dyta, në nenin 5.1, “Bashkëpunimi ndërkomunal nuk nënkupton transferimin e plotë të funksioneve komunale. Qeveritë komunale do ta mbajnë së paku kontrollin indirekt mbi vendimet dhe shërbimet e rezultuara nga bashkëpunimi”. Edhe kjo “së paku kontroll indirekt”, mbetet e paqartë në aspektin juridik. Po ashtu, Qeveria e Kosovës këtë projektligj nuk e ka sjellë këtu për shkak se është në interes të qytetarëve të Kosovës, por e ka sjellë këtu pasi kështu parashihet në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, të njohur si Plani i Ahtisarit. Plani Ahtisarit bashkëpunimin ndërkomunal e parasheh në nenin 6.3 të dispozitave të përgjithshme, mandej në nenin 8.4 të Ankesit 1, si dhe në nenin 9 të Aneksit 3. Decentralizimi në Kosovë është një projekt i dëmshëm, i cili e ndanë Kosovën në baza etnike. Nuk është një plan i cili ofron shërbime më afër qytetarit, por përkundrazi i largon ato në shumë raste. Janë krijuar komuna të cilat janë mono etnike, siç është komuna e Parteshit dhe e Ranillugut, që është në kundërshtim me Kartën evropiane për vetëqeverisjen lokale.

Në nenin 4 të këtij projektligji thuhet: “Për arritjen e qëllimeve dhe të interesave të përbashkëta, për ekzekutimin e kompetencave të tyre komunat mund t’i bashkojnë burimet e tyre financiare, materiale, njerëzore dhe të tjera”. Pra, ky projektligj mundëson krijimin e një entiteti autonom serb në Kosovë. Dihet se plani i Ahtisarit është brenda Kushtetutës së Kosovës dhe mbi të, komunave me shumicë serbe në bazë të këtij plani, pra edhe në bazë të Kushtetutës së Kosovës, u lejohej përpos bashkëpunimit ndërkomunal edhe bashkëpunimi ndërkufitar. Komunat me shumicë serbe do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë brenda kompetencave të tyre me komunat dhe institucionet, përfshirë agjencitë qeveritare të Republikës së Serbisë. Këto komuna, përpos të hyrave vetanake, do të gëzojnë grante nga Qeveria e Kosovës, por njëkohësisht do të financohen edhe nga institucionet e Serbisë, duke përfshirë edhe ndihmën me ekspertë, profesionistë dhe pajisjen e implementimin e kompetencave komunale.

Ky projektligj mundëson themelimin e trupit të përbashkët administrativ të komunave me institucione me shumicë serbe, neni 10, themelimin e ndërmarrjeve të përbashkëta publike, neni 11, institucioneve të përbashkëta publike, neni 12. Kësaj ndryshe i thonë krijim i një “Republika srpska” në Kosovë. Kjo ndryshe quhet bosnjizim i Kosovës. Populli i Kosovës ka nevojë vërtet për një proces të mirëfilltë të decentralizimit, i cili do të jetë në shërbim të qytetarëve të saj e jo krijimin e asociacioneve të komunave në baza etnike. Është e qartë se kur, për shembull, komuna e Klllokotit nuk do të ketë interes për bashkëpunim ndërkomunal me komunën e Vitisë, sepse cila është arsyeja logjike që është ndarë nga ajo atëherë, por komuna e Klllokotit do të bëhet bashkë me komunat tjera me shumicë serbe dhe njëkohësisht do të ndalojë bashkëpunimin ndërkomunal, do të bashkëpunojë me komunat e institucionet nga Serbia. As një nen në këtë ligj nuk e ndalon bashkëpunimin ndërkomunal të komunave me shumicë serbe. Me këtë projektligj ne po e fusim Serbinë edhe më shumë brenda Kosovës. Në vend të këtij projektligji, deputetët e Kosovës do të duhej që të angazhoheshin për shfuqizimin e Planit të Ahtisarit, në mënyrë që pavarësisht së shpallur t’ia shtojnë sovranitetin, sepse këtë e kërkojnë qytetarët.

Për këtë arsye, Lëvizja “Vetëvendosje”, nuk e voton këtë projektligj dhe kërkon edhe nga të gjithë deputetët që para interesave të ngushta partiake, të mendojnë për interesin e Kosovës dhe të mos e votojnë këtë projektligj.

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete, ne si Aleancë mendojmë se e tejkalon fushën e rregullimit të tij, duke paraparë rregulla dhe veprime juridike të panjohura për kushtetutën dhe ligjin deri më tani.

Neni 3, paragrafi 5, parasheh transferimin e kompetencave komunale. Nuk mund të ketë transferim të kompetencave komunale, por mund të ketë delegim të tyre nga organi qendror në atë lokal.

Neni 4 i projektligjit, nën paragrafin 1.3, parasheh bashkëpunimin e obligueshëm ndërkomunal, një rregull i cili cenon kompetencat vetanake dhe shkallën e vetëqeverisjes lokale.

Neni 7 i projektligjit, si instrument juridik të vendosjes të bashkëpunimit ndërkomunal, parasheh kontratën e cila në gjuhën shqipe përdoret si kuptim i së drejtës juridiko-civile e jo i të drejtës publike. Pra, fjala “kontratë” duhet të zëvendësohet me fjalën “marrëveshje”.

Projektligji parasheh personat kompetentë për negocimin dhe nënshkrimin të marrëveshjes, si dhe mënyrën e hyrjes në fuqi të saj, po lë paqartësi dhe zbrazësi të mëdha juridike, duke mos paraparë hapat e nevojshëm procedural, si dhe shumë çështje tjera të parregulluara fare, që në praktikën e zbatimit të këtij akti do të krijojnë mundësi interpretimi të shumëfishët, prej rasti në rast.

Neni 8 i projektligjit është dispozitë e natyrës juridiko - kushtetuese dhe parash institucione mbi komunale, pozita e të cilave është e paqartë, të cilave u përshkruan autorizime të ngjashme me ato ligjvënëse dhe ekzekutive, duke rezervuar për to të drejtën e aprovimit të ndonjë dokumenti tjetër apo statutit. Është e paqartë pozita, kompetencat dhe radhitja e këtyre organeve administrative në hierarkinë e organeve shtetërore, Ato janë organe administrative mbi nivelin lokal dhe nën nivelin qendror, lloj i organeve që nuk parashihi me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Projektligji lë hapësirë, lë hapur mundësitë e krijimit të institucioneve publike me kontratë, e cila do të përcaktonte njëherësh edhe kompetencat në fushën e veprimit të atyre institucioneve, çfarë nuk është në pajtim me pajtimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Po ashtu, projektligji është shumë i paqartë lidhur me natyrën dhe fuqinë juridike të akteve që i nxjerrin trupat e përbashkët administrativ.

Projektligji në nenin 16 parasheh përbërjen e komisionit që monitoron bashkëpunimin ndërkomunal.

Nën paragrafi 3.3. përcakton se përbërjen e këtij komisioni, këtë komision në fakt e përbëjnë 5 anëtarë përfaqësues të agjencioneve zhvillimore. Në këtë formulim nuk përcaktohet se çfarë agjencionesh janë ato, pra a janë të brendshme apo ndërkombëtare. Projektligji ka kundërthënie në mes dispozitave të tij, veçanërisht për çështjen e monitorimit të bashkëpunimit, ku parashihet formimi i Komisionit qeveritar për monitorimin, e më vonë të Komisionit ndërkomunal, gjithashtu për monitorim.

Projektligji si tërësi ka kundërthënie, paqartësi, zbrazësi juridike dhe mangësi në sqarimin e dispozitave dhe të nocioneve të caktuara. Në dispozitat e projektligjit nuk është sqaruar se cilat do të jenë format e bashkëpunimit ndërkomunal, cilat do të jenë institucionet për zbatim dhe mbikëqyrje të bashkëpunimit ndërkomunal, nuk është sqaruar pozita juridike e institucioneve që to të themelohen sipas këtij ligji, kompetencat e këtyre institucioneve. Kur jemi te bashkëpunimi ndërkomunal, gjithashtu pajtohem me parafolësin, pra ish ministrin Ferati që duhet të jetë gjithsesi edhe bashkëpunimi ndërkomunal ndërkombëtar.

Kemi edhe shumë paqartësi në formulimin e fjalëve si, për shembull, neni 2 i projektligjit, përdor fjalën “bashkëpunim dhe partneritet”, fjalë të cilat kanë kuptim të barasvlershëm.

Neni 6, themelimi i bashkëpunimit ndërkomunal, është nocion i formuluar gabimisht ngase nuk themelohen bashkëpunimet, kontratat apo veprimet e tjera juridike, por vendosen si produkt i aktit të marrëveshjes së subjekteve.

Paragrafi 7, i nenit 12, formulimi: “personi që do t’i udhëheqë punët deri në konstruktimin e institucionit”, është formulim i pakuptueshëm si gjuhësor, po ashtu edhe juridik.

Neni 13, përmbushja e kompetencave, është formulim dhe terminologji e pakuptueshme dhe e panjohur. Por, Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do ta votojë në parim, por do të jemi këmbëngulës që të inkorporohen të gjitha vërejtjet që u përmenden. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, kudo e do fjalën? Deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: I nderuar kryetar,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Koalicioni për Kosovë të Re mbështet, në parim, Projektligjin dhe kontributin e vet do ta japë në komisionet përkatëse. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputeti Sasha Rashiq e ka kërkuar fjalën.

SAŠA RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Parlamentarna grupa je razmotrila Zakon o međuopštinskoj saradnji i parnterstvu i u načelu će podržati ovaj zakon iz više razloga. Formalno-pravno ovaj zakon ispunjava sve uslove da bi bio uzet u razmatranje i u skladu je sa Ustavom i ostalim zakonima. Suštinski ovaj Zakon će svakako olakšati svakodnevni život građana, povećati pristup i rad javnih službi i svakako omogućiti uslove, odnosno stvoriti uslove za eventualni ekonomski razvoj kako na opštinskom, tako i na centralnom nivou.

Samostalna liberalna stranka, odnosno Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke će u načelu podržati ovaj zakon i svoj doprinos će dati kroz funkcionalnu komisiju.

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem, predsedniče!

Posle razmatranja Nacrta zakona za međuopštinsku saradnju i parnterstvo, koji ima za cilj da jasno odredi zakonski okvir za organizaciju i funkcionisanje međuopštinske saradnje, način za njeno ostvarivanje, financiranje i sprovođenje zajedničkih odgovornosti, podržavamo ga i smatramo kao vrlo značajnim. Podržavamo zakon u načelu i daćemo svoj doprinos za njegovo dalje inkorporisanje u zakon i implementaciju. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Tani është radha e deputetëve. Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Unë do t'i paraqes tre arsye se pse ky projektligj nuk duhet të kalojë fare në Kuvend dhe duhet t'i kthehet Qeverisë për t'u ripunuar. Përveç vërejtjeve që dha kolegu im, kam edhe disa vërejtje tjera.

Bashkëpunimi ndërkomunal është një fenomen relativisht i ri edhe në vendet e zhvilluara të Bashkimit Evropian, sidomos. Bashkëpunimi ndërkomunal është gjithashtu një risi dhe objekt i analizave të studimeve shkencore. Madje, vetëm kohët e fundit ka filluar të marrë një vëmendje të shtuar nga studiuesit në disa vende. Procesi i evropianizimit i shtyn nivelet lokale të përballen me kompetenca të reja, kërkesa, gjithashtu bashkëpunim ndërkufitar dhe bashkëpunim ndërinstitucional që të praktikohet në të gjitha nivelet, përfshirë edhe ato komunale.

Edhe pse praktikatat ndërkomunale janë të përhapura në një numër të vendeve të BE-së, vazhdon të mbetet një sfidë për shumë këto vende ku zhvillohen, pra ky lloj bashkëpunimi vazhdon të mbetet një sfidë për shumë këto vende, ku zhvillohen praktika të ndryshme të këtij bashkëpunimi dhe ende nuk ka rezultuar me ndonjë praktikë rreth së cilës janë bashkuar të gjithë. Pra, duke qenë se është një praktikë e re për vendet e BE-së, nuk ka ndonjë arsye që Qeveria e Kosovës të ngutet të bëjë një ligj të tillë, ndërkohë që

ka ligje të tjera shumë më të rëndësishme për t'i bërë dhe, për më tepër, sa kohë që ende nuk ka bërë shumë funksional pushtetin lokal.

Gjithashtu, ka ardhur koha të shqyrtohet procesi i decentralizimit sipas pakos së Ahtisrit dhe besoj se të gjithë jemi dakord që nuk kemi se si të ndërtojmë katin e dytë dhe të tretë akoma pa e ndërtuar katin e parë. Arsyeja e dytë, se pse unë jam kundër, lidhet me situatën aktuale në Kosovë, duke qenë se objekti i këtij bashkëpunimi ndërkomunal është përmirësimi i shërbimeve publike dhe si t'i bëjmë këto shërbime të arritshme territorialisht dhe demografikisht dhe, nga ana tjetër, duke pasur parasysh situatën politike në vend, ku disa komuna nuk bashkëpunojnë dhe nuk e njohin autoritetin e Qeverisë, është e parakohshme dhe e dëmshme që të lejohet të formalizohet një nivel i ndërmjetëm pushteti, pra në mes atij qendror dhe komunal, sepse kjo gjë ju jep mundësi këtyre komunave të krijojnë institucione paralele.

Arsyeja e tretë, se pse unë jam kundër, ka të bëjë pikërisht me gjuhën. Teksti i shkruar është me një gjuhë tepër të varfër juridike, ka gabime të mëdha sintaksore, strukturore, është i pakuptueshëm dhe nuk i përmbush kriteret për të qenë ligj, ku kriteri kryesor i një ligji është pikërisht qartësia. Më lejoni t'ju citoj vetëm nenin 3, të cilin e kam lexuar së paku dhjetë herë dhe nuk arrita ta kuptoj se çka do të thotë: “Bashkëpunimi ndërkomunal në kuptimin e këtij ligji, nënkupton marrëdhëniet formale dhe jo formale të vendosura midis dy apo më shumë komunave për arritje të një ekzekutimi më efikas dhe me kosto efektive, të kompetencave të komunave të përcaktuara me ligj dhe për arritjen e interesave dhe qëllimeve të tyre të përbashkëta”. Kompetencat, unë nuk e di që ekzekutohen, por ushtrohen. Nëse ka këtu ndonjë deputet që arrin ta kuptoj se çka është dashur të thuhet me këtë nen, për shembull, atëherë të diskutojmë.

Ky është vetëm një nga këto nene, sepse të gjitha nenet janë të mbushura me pakuptimësi të tilla. Më sa kam unë informacion, Qeveria e Kosovës i përkthen këto ligje, kryesisht nga gjuha serbokroate, i merr nga Sllovenia po Kroacia, pra përkthehen në shqip, pastaj nga shqipja kthehen në anglisht dhe në serbisht i kanë të gatshme, ndërkohë që edhe ligjet të cilat janë marrë nga gjuha serbokroate nga këto dy vende, me siguri janë marrë nga ndonjë vend i Bashkimit Evropian në anglisht dhe përfundimi është që kemi një kopje të katërfishtë të ligjeve, ku në fund nuk dihet se për çfarë flitet, kështu që me të vërtetë është i papranueshëm dhe mendoj se duhet të kthehet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Ju faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot kemi një ligj që mendoj se është ndër ligjet më të rëndësishme të cilat duhet të trajtohen sa i përket bashkëpunimit ndërkomunal dhe rritjes së kapaciteteve komunale për vetëqeverisje. Prandaj, mendoj se këtu flitet më shumë për koncepte, sesa për nene konkrete. Njëra prej koncepteve të frymës së këtij ligji është koncepti i parimit të subsidiaritetit, që është prurja e vendimmarrjes sa më afër qytetarit, e cila parashihet edhe me Kartën evropiane të vetëqeverisjes lokale.

Vetë fryma e këtij ligji është në kuadër të Kartës evropiane të vetëqeverisjes lokale, mirëpo, si koncept, ky ligj na bjen ndesh me shumë ligje tjera. Bile na bjen ndesh me një ligj që sot kemi për ta aprovuar pak më vonë. Ky ligj thotë se qëllimi i këtij Ligji është krijimi i mundësive për bashkëpunimin ndërkomunal për të ofruar shërbime sa më cilësore për qytetarët. Në të njëjtën kohë, se sot ne e aprovojmë një ligj tjetër ose pritet që të aprovohet një ligj tjetër, i cili është Ligji për mbrojtjen nga zjarri, i cili parasheh që kompetencat për mbrojtjen nga zjarri të shkojnë në nivelin qendror. Këtu kemi një përplasje, cilin shërbim do ta ofrojë në këtë rat, çfarë bashkëpunimi do të ketë ndërmjet komunave për këtë shërbim.

Po flasim për një çështje tjetër. Çështjet e inspektoratit, prapë janë në kundërshtim me parimin e substidiaritetit dhe parimin e Kartës evropiane të vetëqeverisjes lokale, sepse inspektoriatet po centralizohen.

Flasim për një ligj që është aprovua në parim javën e kaluar ose para dy javësh, Ligjin për tregtinë e brendshme. Ligji për tregtinë e brendshme, ministri erdhi këtu na tha neve se po ndryshohen disa parime të regjistrimit të biznesit dhe njëra prej tyre është heqja e lejeve të punës nga autoriteti komunal dhe centralizimi i tyre ose heqja fare. Çka ndodhë këtu? Këtu ndodhin disa probleme. E para, hiqen disa mundësi si burim financiar për komunat, e dyta, u hiqet mundësia komunave që të identifikojnë se çfarë lloj aktiviteti ushtrohet në ato komuna dhe si do të duhej të planifikohet strategjikisht që të zhvillohen ato komuna. Dhe, e treta, prapë në kundërshtim me parimin e substidiaritetit dhe me parimin e Kartës evropiane të vetëqeverisjes lokale. Këtu lindë pyetja, çfarë lloj koncepti po ndërtojmë na sa i përket vetëqeverisjes lokale në Kosovë?

Kemi dy tendenca. Njëra është tendenca e decentralizimit apo riorganizimit territorial në bazë mono etnike, që bëhet kryesisht në pjesët me shumicë serbe, që ka ardhur si rezultat i negociatave ndërkombëtare të cilën Kosova e ka aprovuar dhe na bie një problem tjetër, ku kemi tendenca të rritjes së këtyre autoriteteve dhe përgjegjësive për pjesën veriore, si rezultat i negociatave që mbahen në Vjenë. Çka na ndodhë? Kemi dy fytyra me të cilat sillet Kosova përballë qytetarëve të vet. Fytyra e parë është që komunat të cilat mund të kenë shans që të jenë komuna efikase dhe vetëqëndrueshme nga aspekti financiar dhe nga aspekti i administrimit të qëndrueshëm komunal, ju merren autoritetet dhe përgjegjësitë dhe centralizohen në nivel qendror dhe, në anën tjetër, për arse etnike dhe për arsye të presionit të pakicës serbe ose të presionit që vjen nga Qeveria serbe, autoriteti dhe përgjegjësitë sidomos në pjesën veriore synohen që të kenë një asimetri shumë të madhe. Në vetvete sistemi ka asimetri, ka asimetri sepse me pakon e presidentit Ahtisari është paraparë që të ketë një asimetri për komunat me shumicë serbe dhe të ketë në të ardhmen një decentralizim substancial për komunat me shumicë shqiptare.

Mirëpo, çfarë po ndodhë? Ne çdo ditë këtu në këtë Kuvend shohim që aprovohen ligjet të cilat nuk kanë për qëllim decentralizimin, por kanë për qëllim centralizimin. Po i përmend disa ligje. Ligji që do të diskutohet sot, Ligji për mbrojtje nga zjarri, është një ligj i cili bie në kundërshtim të plotë me këtë ligj që po e diskutojmë ne sot dhe bie në

kundërshtim të plotë me Kartën evropiane të vetëqeverisjes lokale dhe do të vjen një moment tjetër, ku Qeveria e Kosovës do të detyrohet, se si rezultat i negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, ose përafrimin me Bashkimin Evropian, do të duhet t'i ndryshojë këto ligje dhe prapë do t'i kthejë këto autoritete dhe përgjegjësi në nivel lokal, sepse është kompetencë ekskluzive e autoriteteve lokale që të merren me aspektin e mbrojtjes nga zjarri.

Çka ka ndodhur? Me këtë Projektligj që propozohet pak më vonë, që është në kundërshtim që po e diskutojmë sot dhe me frymën që synon ta implementojë ky ligj sepse, në fund të fundit, për këtë ligj që po flasim sot, flitet më shumë për frymën, sesa flitet për çështjet konkrete, për nenet apo bashkëpunimet, flitet për frymën të cilën po e implementojmë dhe fryma që pretendohet të implementohet këtu, është ngritja e kapaciteteve lokale për vetëqeverisje të qëndrueshme dhe zhvillim socio-ekonomik në nivel lokal dhe ky ligj i heqë këto mundësi. Po e jap një shembull konkret. Me Ligjin që u aprovua para dy javësh, në parim, Ligjin për tregtinë e brendshme, po marrim si shembull Komunën e Prishtinës.

Komunës e Prishtinës, ku veprojmë mbi 12.000 biznese, i hiqet leja e punës, ku mesatarisht për këto 12.000 biznese, vitin e kaluar komuna e Prishtinës ka inkasuar mbi 730.000 euro, dhe i bie që Komuna e Prishtinës do të humbë burim financimi prej 730.000, dhe në të njëjtën kohë, institucionet e Kosovës dhe Parlamenti i Kosovës, kërkon nga komunat që t'i rrisin të hyrat vetanake dhe të jenë të vetëqëndrueshme financiarisht. Në momentin që ne ia heqim këtë mundësi, atëherë krijojmë një situatë të paqartë. Momenti që ia kemi hequr mundësinë me Ligjin për inspektoratin dhe Ligjin për tregtinë e brendshme, që inspektorët e tregut të kontrollojnë se çfarë cilësie apo çfarë lejesh të punës, aktivitetesh që ushtohen në objektet e caktuara, kemi humbur mundësinë që komuna të kontrollojë aktivitetin dhe realitetin që zhvillohet brenda saj. Prandaj, jemi në një situatë ku përplasen konceptet dhe përplasen realitetet. Dhe, ky koncept i paqartë, i cili po synohet të implementohet, sot na bihet një ligj i cili është ligj modern, për mendimin tim, që ka përparim kryesor Kartën evropiane të qeverisjes lokale, që thotë: Vendimmarrja vjen sa më afër qytetarit, që ka për qëllim vetëqëndrueshmërinë financiare politike, sociale dhe ekonomike në nivel lokal, në të njëjtën kohë i hiqen kapacitetet. Çka do të bashkëpunojë komuna e Prishtinës me komunën e Fushë Kosovës sa i përket mbrojtjes nga zjarri? Sënjë gjë, sepse komuna nuk do të ketë autoritet dhe përgjegjësi, sepse Qeveria hala pa u formuar, pa hyrë ligji në fuqi, pa u diskutuar në parim, ka themeluar Agjencinë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe, më e çuditshmja, për të njëjtën kohë më absurdja dhe e tmerrshmja, se komuna e Prishtinës, kur ka shkuar për t'i regjistruar automjetet për mbrojtje nga zjarri pardje, i ka regjistruar në fletët e regjistrimit të automjeteve, i ka regjistruar si pronë të Agjenciës për Mbrojtje nga Zjarri, agjenci e cila realisht nuk ekziston me ligj dhe në të njëjtën kohë është shkelje e kompetencave dhe autoriteteve të vetëqeverisjes lokale, sepse ajo është pronë e komunës. Nuk mund të regjistrohet pronë e një agjencie përderisa është pronë e një komune. Prandaj, këtu kemi përplasje konceptuale dhe lëvizje të qëllimshme për ta dëmtuar interesin e vetëqeverisjes lokale.

Po pretendohet që këto ligje do të përmirësojnë performancën e Kosovës në dërgimin e biznesit ose në Raportin e progresit. Këto do ta përkthejnë, sepse Karta evropiane për vetëqeverisjen lokale është një dokument shumë i rëndësishëm sa i përket vetëqeverisjes lokale dhe përafrimit për anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe duke u përplasur me këtë kartë, jam i bindur se do të kemi një raport hala më negativ dhe një raport i cili do të dëmtojë edhe perceptimin për vetëqendrueshmërinë institucionale dhe demokratike të Kosovës, por në të njëjtën kohë do të dëmtojë substancialisht qëndrueshmërinë e komunave.

Paramendoni, sipas ligjit që do të propozohet pak më vonë, që është në kundërshtim me këtë ligj dhe me këtë frymë të këtij ligji, thuhet se Inspektorati i zjarrit do të jetë në nivel qendror. Një inspektor i zjarrit për një lokal, i cili do të ushtrojë aktivitet në komunën e Dragashit, duhet të shkojë prej Prishtinës të këqyrë se a ka fikësin nga zjarri a jo. Ky është një koncept absolutisht i papranueshëm, ky është në koncept i gabueshëm dhe që bie në kundërshtim me parimin dhe frymën e këtij ligji dhe që bie në kundërshtim me parimet e vetëqeverisjes lokale dhe të Kartës evropiane për vetëqeverisjen lokale. Prandaj, ju kisha këshilluar që të kemi parasysh që ligji si i tillë, fryma e ligjit është një ligj modern, mirëpo qasja që e ka Qeveria për vetëqeverisjen lokale, është një qasje e gabuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputet, Arben Gashi, fjalën ke të drejtë ta marrësh në dash në vend, në dash në foltore ku ishte, por emri të unë nuk del pa kartelë.
Vazhdojmë. Fjalën e ka Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Dëshirova t'i shtoj disa çështje që lidhen po ashtu me disa ligje të cilat janë në frymën e legjislacionit të BE-së dhe të cilat po ashtu marrin një varg kompetencash të qeverisjes lokale. Po, ajo që kryesisht u shter këtu dhe më mbetet vetëm të shtroj diçka që mendoj i mungon këtij procesi në përgjithësi dhe përgatitjes të këtij ligji. Një vlerësim pak më i mirë, ne nuk e kemi të qartë ende në çfarë rrethanash po inicohet ky projektligj, edhe pse unë nuk dëshiroj të paragjykoj as nga aspekti politik, as nga ai etnik, është qëllimi shumë pozitiv në frymën e bashkëpunimit të komunave, por një vlerësim që do të nxirrte në pah se për të cilat nevoja është fjala, cila mungesë e ligjeve ose cila mungesë e legjislacionit ka ndikuar që ne ta nxjerrim këtë ligj, a është fjala për komunat e mëdha, a është për komunat e tjerë dhe të nxirren shembuj në bazë të cilëve ky projektligj do të dilte sa me i mirë dhe sa më i frytshëm për komunat.

Nëse kjo do të ishte për komunat e mëdha, do të nxirrej një mësim i mirë dhe ligji do të përgatitej më i mirë. Nëse është këtu fjala për komunat e vogla, më lejoni të ju them që javën që shkoi unë mora pjesë në një tryezë pikërisht për realizimin e interesave të qytetarëve pakicë në komunat e reja dhe pati aty diskutues të komunitetit serb kryesisht, ku u vlerësuan disa nga komunat e regionit të Gjilanit dhe u tha tekstualisht që ka ngecje jashtëzakonisht të mëdha në funksionimin e këtyre komunave.

Unë dëshiroj të them që, sipas këtij projektligji ose sipas këtij ligji të ardhshëm, nëse nuk ndryshohet diçka, krijimi i trupave administrative do të ishte barrë e madhe për këto komuna. Edhe ashtu këto komuna kanë një numër të madh administratorësh, njerëz që marrin paga dhe ende nuk punojnë asgjë. Unë shpresoj se është fillimi, domethënë, krejt faza e parë e këtij ligji, do të trajtohet në grupe punuese nga ekspertë të ndryshëm dhe, po ashtu, ajo çka është e rëndësishme, deri në fund të realizimit të këtij ligji do të ishte mirë të nxirrej një vlerësim për funksionimin e këtyre komunave të reja. Kjo do t'ju ndihmonte qartësimin edhe më tutje edhe nxjerrjes finale të këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Lutfi Zharku, është diskutuesi i fundit.

LUTFI ZHARKU: I nderuari kryetar,
Zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,

Disa vërejtje parimore mbi projektligjin. Besoj se dispozitat e nenit 11 të këtij projektligji, e cila ka të bëjë me formimin, me krijimin e ndërmarrjeve të përbashkëta publike, janë në kundërshtim me Ligjin mbi ndërmarrjet publike, i cili është aktualisht në fuqi, Ligji mbi ndërmarrjet publike përcakton në mënyrë të saktë se ndërmarrjet publike, çdo ndërmarrje e re publike duhet të bëhet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, kurse neni tjetër po ashtu përcakton në mënyrë të saktë se çdo ndërmarrje e re publike duhet të jetë ndërmarrje e nivelit nacional, domethënë nuk mund të jetë ndërmarrje e nivelit regjional, ashtu siç është paraparë me këtë Ligj. Besoj se këto konflikte apo kundërshtime në mes të ligjeve duhet të zgjidhen në komisionin funksional apo këto dispozita të hiqen për mundësinë e krijimit të ndërmarrjeve të përbashkëta publike. Të them nga përvoja në Qeverinë e kaluar, ne kemi pasur disa probleme me themelimin e ndërmarrjeve komunale publike nga disa komuna, të cilat probleme nuk besoj se deri tash janë zgjidhur, përkundër asaj se kemi marrë vendim si Qeveri që mos t'i lëmë ndërmarrje publike.

Vërejtje tjetër, them propozimet apo iniciativën për themelimin e partneriteteve ndërkomunale, bashkëpunimin indërkomunal është që inicimi mund të vijë nga 2% të qytetarëve me të drejtë vote apo të asociacioneve të ndryshme, të asociacioneve apo të grupeve tjera të interesit. Në këtë aspekt besoj se për qytetarin me të drejtë vote është, të them nuk janë në nivelin e njëjtë ... Po e marrë për shembull komunën e Kaçanikut. Nëse duhet një bashkëpunim komunal, duhet të mblidhen afër 600 qytetarë që ta bëjnë atë iniciative, kurse një asociacion, që unë besoj se shumica e tyre janë organizata joqeveritare, përbëjnë nga një apo dy anëtarë, e kanë të drejtën e barabartë me 600 qytetarë.

Vërejtje tjetër është se komisioni për stimulimin dhe bashkëpunimin ndërkomunal, unë e shoh të panevojshëm në nivel Qeverie që të jetë ai komision, Ministria mund ta ketë atë komision dhe duhet të jetë në nivel të Ministrisë, po ashtu edhe vlerësimi i bashkëpunimit ndërkomunal është çështje e komunave që e bëjnë atë bashkëpunim

ndërkomunal dhe nuk ka nevojë të themi për dispozita të posaçme, pasi që ajo duhet të parashihet dhe është e drejtë që të parashihet me marrëveshje.

Në anën tjetër, për fund, besoj se Ministria nuk duhet ta kufizojë veten që aktet nënligjore, me afate të caktuara, 6 muaj, përkundër asaj që ndoshta është mirë t'i caktojnë vetit disa herë limite në përpilimin e disa akteve, por shpesh dështojnë këto, kështu që veç lëmë hapësirë ndoshta për një kritikë shpesh të pa vend. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Zoti zëvendëskryeministër, mund të merrni fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,
Anëtarë të Qeverisë,

Jo, unë vetëm pata në raport me zotin Gashi, që e përmendi. Unë e pash që zoti Gashi u orientua më shumë në filozofinë e ndërtimit të pushtetit lokal, më pak në Ligjin konkret. Unë e ftoj që të bëjmë debat për këtë çështje, t'i ballafaqojmë idetë, mendimet e pastaj shohim atë çka vendos Kuvendi, ne e miratojmë, ngase ishte diskutim më shumë se sa për ligjin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Replikë, Arben Gashi. Regjia, fjalën deputetit Arben Gashi!

ARBEN GASHI: Ju faleminderit kryetar!

Unë mendoj se këtu jemi për të bërë, të shohim edhe filozofinë e ligjit, frymën e ligjit, të shohim konceptin e ndërtimit të shtetit, konceptin e funksionimit të instrumenteve të shtetit ta ndërtojmë një shtet funksional i cili do të jetë në interes të qytetarëve të Kosovës dhe jo në interes të individëve apo grupeve joformale ose formale të cilat mund të na paraqiten këtu dhe jashtë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Prandaj, unë mendoj se jemi në një situatë kur ne duhet të krijojmë ligje dhe të hartojmë ligje të cilat janë në interes të qytetarëve të Kosovës dhe në këtë kuptim unë jam i bindur se Qeveria e Kosovës nuk e ka të qartë konceptin e vetëqëndrueshmërisë institucionale dhe të vetëqëndrueshmërisë të nivelit lokal dhe nivelit qendror, ndarjes së pushtetit dhe krijimit të predispozitave për zhvillim të qëndrueshëm edhe ekonomik, edhe social, edhe ligjor. Në këtë kuptim, kemi paqëndrueshmëri ligjore, sepse ky ligj përplasat me ligjet tjera, ky koncept i partneritetit publik dhe i partneritetit ndërmjet komunave përplasat me konceptin i cili po zbatohet realisht, duke centralizuar autoritete dhe përgjegjësi dhe në të njëjtën kohë duke krijuar një realitet tjetër në pjesët tjera të territorit të Kosovës. Prandaj, unë mendoj se ligjet e Kosovës duhet të jenë të barabarta për të gjithë qytetarët e Kosovës, prandaj unë mendoj se ligjet e Kosovës duhet të jenë të zbatueshme për të gjitha komunat e Kosovës dhe prandaj unë mendoj dhe jam i bindur se qasja filozofike, qasja konceptuale dhe qasja intelektuale ka shumë mundësi në hartimin dhe zbatimin e ligjeve në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Zëvendëskryeministri e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HARJEDIN KUÇI: Zoti Gashi, kjo veç për kureshtjen edhe tënden, edhe timen. Unë asgjë nuk kërkoja më shumë se sa debat dhe urdhëroni debat, ju i hapni një 10 tema. Unë jam i gatshëm në emër të Qeverisë të marrë pjesë në debat. Debati është diçka që edhe ju i jepni mendimet tuaja, edhe ne dhe po e them që pushtetin lokal nuk e kemi ndërtuar ne, do të thotë i iki përgjegjësisë. Janë dy faktor që e kanë ndërtuar: e para, faktori marrëveshjes politike, që është decentralizim etnik dhe unikat për Kosovën dhe, e dyta, faktori që brenda për brenda vendit ende nuk kemi filluar me një decentralizim në kuptimin e mirëfilltë qytetarë. Unë ju ftoj juve, secilin prej nesh, kur e përmend unifikimin dhe zbatimin uniform të ligjeve në tërë Kosovën, të mos ta shoh nga prizmi i komunave ku udhëheqim ne, por ne bëjmë ligje për tërë Kosovën dhe natyrisht që i marim ato që vijnë nga komunat.

Unë jam i gatshëm, Qeveria është gatshme që ta bëjmë një debat për qasje ndaj vetëqeverisjes lokale. Do t'i ndihmonte Qeverisë, do ta fuqizonte Qeverinë në këtë drejtim dhe natyrisht idetë e mira janë të mirëseardhura, por brenda një debati, brenda një ligji kur diskutohet, nuk mund të shterren këto çështje. Një debat i mirë, përfundimet e mira do të na ndihmojnë të dy palëve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Të njëjtën gjë ke për ta thënë Arben, sa herë të folesh. Urdhëro, urdhëro, fjalën e ka deputeti Arben Gashi!

ARBEN GASHI: Ju faleminderit!

Ta kemi parasysh, debati është i mirëseardhur, mirëpo po flasim, pikërisht po bëjmë debat konceptual në këtë rast, mirëpo meqë kemi nevojë për ilustrim, ka nevojë zëvendëskryeministër për ilustrim, po japi një ilustrim. Është dispozitë kushtuese që kryeqyteti i Republikës së Kosovës duhet të qeveriset me ligj të veçantë dhe kemi 3 vjet që nuk zbatohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës sa i përket kësaj pune dhe diskriminohet një qytet që është kryeqyteti i Republikës së Kosovës, qëllimisht. Prandaj, unë po e marrë si shembull ilustrues kryeqytetin e Republikës së Kosovës, por realisht të gjitha komunave në Kosovë, duke ju centralizuar kompetencat, po bëhen të paqëndrueshme në aspektin financiar dhe në aspektin ekonomik dhe nuk po krijojnë predispozita që këto komuna të jenë të vetëqëndrueshme dhe të japin një orientim për zhvillimin e tyre. Prandaj, mendoj se duke i kaluar ato ligje, të cilat marrin kompetenca nga niveli lokal dhe i qojnë në nivel qendror për arse të grupeve të caktuara dhe interesave ekonomike, është një veprim i papranushëm dhe konceptualisht i gabueshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, zëvendëskryeministër dhe e kryem!

ZËVENDSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Që tha zoti Gashi, Ligji për Prishtinën, unë e kam kuptuar në kohën kur ka qenë fushata elektorale dhe është përmendur. Ka qenë e natyrshme, sot nuk e kuptoj. Unë po ju ftoj juve personalisht, bashkë me mua, të arrijmë marrëveshje me Fondin Monetar Ndërkombëtar, sot një javë e ke në Kuvendin e Kosovës.

KRYETARI: Ju faleminderit! Unë mendoj se debati ka përfunduar. Ministri nëse e do fjalën? Nuk e do, atëherë vazhdojmë.

Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin, në parim, të Projektligjit për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritetete. Në sallë kemi 74 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, në parim, dhe votojmë tash.

Konstatoj se me 47 vota “për”, 24 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete. Adem Grabovci nuk ka kartelë, i shtohet numrit të votave “për”.

Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete. Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportin me rekomandime. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e radhës, pika e pestë e rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksion ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, andaj janë përmbushur kushtet për shqyrtim në parim të këtij projektligji. Ftoj ministrin e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor, zotin Dardan Gashi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe të arsyetojë projektligjin.

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Deputetë të nderuar,

Zëvendëskryeministra, kolegë ministra,

Ky projektligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme. Ky projektligj është në pajtueshmëri me legjislacionin e BE-së, Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Nuk ka implikime buxhetore, por të krijojë bazën për gjenerimin e të ardhurave si dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm afarist për biznese në Republikën e Kosovës.

Me këtë projektligj bëhet përcaktimi i rregullave për regjistrimin e të drejtave dhe ngarkesave për pronën e paluajtshme në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme, i themeluar me Ligjin nr. 2002/5.

Ky projektligj procedohet në të njëjtën kohë krahas Projektligjit të ri për kadastrin, sepse këto projektligje kanë lidhshmëri me njëri - tjetrin, andaj është domosdoshmëri harmonizimi i tyre.

Përmes këtij ligji synohet që me zhvillimin e ekonomisë së tregut dhe teknologjisë, në përgjithësi, është paraqitur nevoja për kërkesa për regjistrime të reja, siç janë: barra tatimore, barra tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme, masat e ndryshme të sigurisë, përparësitë në pronat e paluajtshme e të tjera, krijimi i bazës ligjore për zbatimin e direktivës së Komisionit Evropian të vitit 2007, lidhur me të dhënat hapësinore për secilin shtet, që me këtë projektligj të regjistrohen llojet e ndryshme të të drejtave pronësore dhe të rritë numrin e llojeve të dokumenteve për regjistrimin e këtyre të drejtave të paluajtshme, përcaktimi i saktë i nivelit të tarifave për regjistrimin e të drejtave pronësore në RDPP, duke u bazuar në koston e kryerjes së shërbimeve përkatësisht të regjistrimeve.

Ky projektligj nuk përmban elemente diskriminuese. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjala është për kryetarin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinorë, deputetin Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje, Kabineti qeveritar!

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Ambient dhe Mjedis, në mbledhjen e mbajtur më 3.05.2011, shqyrtoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2002/5 për themelimin e regjistrimit të të drejtave të pronës së paluajtshme dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë rekomandimin, të miratohet në parim projektligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit 2002/5 për themelimin e regjistrimit të të drejtave të pronës së paluajtshme. Komisioni e ka miratuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Deputeti Njazi Idrizi e ka fjalën.

NJAZI IDRIZI: I nderuari kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në emër të grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës do të paraqes mendimin lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 202/5 për themelimin e regjistrimit të të drejtave të pronës së paluajtshme. Çështja e pronës dhe e të drejtave mbi pronën, qytetarëve tanë në të kaluarën në proces iu ka sjellë shumë fatkeqësi. Ata janë ballafaquar me një mori problemesh rreth përkufizimit të qartë të çështjeve pronësore dhe të drejtës për pronën, proces ky i cili ka kaluar nëpër një rrugë të vështirë të politizimit edhe me prona individuale, shpesh edhe të konfiskuara nga pushteti, ndërsa regjistrimi i të drejtave pronësore mbi sendet e paluajtshme shpesh nuk ka qenë e mundur të realizohet.

Problemet pronësore kanë lënë pasoja të cilat janë duke u ndier në procesin e filluar të regjistrimit kur janë paraqitur disa probleme pronësore për shkak të paqartësive në të drejtat mbi pronën dhe ekzistimit të pronës faktike, por jo edhe juridike. Kjo situatë po

shkakton probleme dhe ngecje në procesin e legalizimit të drejtave të pronësisë së paluajtshme.

Sipas konventave ndërkombëtare dhe Kushtetutës sonë, prona dhe të drejtat në pronë janë të drejta themelore të individit. Në këtë aspekt, edhe themelimi i regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme është plotësim i një kushti të rëndësishëm për ta fuqizuar edhe më shumë të drejtën në pronë të paluajtshme dhe fitimin e të drejtave mbi pronën e cila do t'i mundësonte pronarit përfitime në ndonjë proces eventual, ndërsa edhe institucionet kompetente do t'i bënte shumë efikase.

Në sistemin ligjor të vendit tonë janë shumë të nevojshme reformat e vazhdueshme dhe ligjore. Në këtë aspekt, edhe projekti për të cilin po diskutojmë – Projektligji për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit Numër 2002/5 për themelimin e regjistrit të drejtave të pronës së paluajtshme po e përmbush një standard shumë të rëndësishëm të kësaj reforme.

Ky projektligj do të bëjë ndryshimin e Ligjit për themelimin e regjistrit të të drejtave mbi pronën e paluajtshme duke i riformuluar më shumë disa paragrafe dhe duke shtuar edhe disa të reja për ta saktësuar më shumë atë. Me këto ndryshime në këtë ligj është e domosdoshme të kompletohet ai, i cili do të japë mundësi që të aplikohet në tërësi.

Grupi Parlamentar i PDK-së ka marrë vendim që si të tillë ta votojë. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Sali Morina!

SALI MORINA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike ka shqyrtuar këtë projektligj me disa vërejtje apo mangësi të cilat kanë qenë të paraqitura. Vlen të përmendet sidomos që ky ligj nuk ka implikime buxhetore, por ky ligj krijon edhe të hyra si në nivelin qendror, po ashtu edhe në nivelin lokal dhe kjo mbetet që në kuadër të Komisionit, Grupi Parlamentar i LDK-së do të sqarojë dhe njëkohësisht kërkon që kur është çështja e të hyrave, të definohet me një nen të veçantë se këto të hyra me përqindje sa do t'i takojnë nivelit lokal dhe po ashtu nivelit qendror. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për “Vetëvendosje”, kush flet? Albulena Haxhiu!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Ndryshimet dhe plotësimet e projektligjeve nga Qeveria në mënyrë të shpejtë dhe të pa kontrolluar janë duke u bërë për hir të përmbushjes së një agjende formale legjislative, e cila mbron dhe avancojnë interesat klano-fisnore të Qeverisë pa e përfillur interesin e përgjithshëm shoqëror. Në grupin e kësaj agjende, së bashku me projektligjet për standardizim, është edhe ky Projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër

2002/5 për themelimin e regjistrimit të të drejtave të pronës së paluajtshme, i cili nuk u plotëson kushtet minimale për rregullimin e fushëveprimtarisë së tij.

Duke marrë parasysh faktin se as Ligji i vjetër Numër 2002/5, e aq më pak ky Projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e regjistrimit të të drejtave të pronës së paluajtshme nuk e parasheh dispozitën që ka të bëjë me ndalimin e regjistrimit të një të drejte të pronësisë në rast qarkullimi juridik, shitblerjes së pronës së paluajtshme, e cila kalon vlerën 10.000 euro nuk mund të regjistrohet pa kaluar në transferet bankare për faktin se mosekzistimi i ndalesës së tillë iu mundëson personave të caktuar shpëlarjen e parave në tregun e paluajtshmërive.

Po ashtu, ky projektligj për ndryshim nuk e parasheh edhe dispozitën juridike që ka të bëjë me regjistrimin e pjesërishëm të hipotekës, duke e ditur faktin se marrëdhëniet juridike kanë ndryshuar në parim dhe një numër i madh i shteteve të rajonit e përqafojnë parimin bashkëkohor të së drejtës së regjistrimit të pjesshëm të hipotekës. Për shembull, nëse pjesërisht përmbushet kërkesa kryesore, dhënësi i hipotekës ka të drejtë të kërkojë nga hipotekëmarrësi që ta lirojë atë pjesë të hipotekës dhe në rastin e tillë hipotekëmarrësi ka për detyrë ta lirojë një pjesë të hipotekës dhe ta regjistrojë hipotekën pjesërisht.

Një dispozitë pa të cilën rregulla nuk ka efekt, është sanksioni, i cili duhet t'i vihet zyrëtarit të Zyrës kadastrale të komunës në rast të regjistrimit, që bie në kundërshtim me ligjet në fuqi. Zyrtari i zyrës kadastrale, përveç përgjegjësisë penale dhe disiplinore, duhet të bëjë edhe kompensim adekuat të palës së dëmtuar.

Ky projektligj dhe as ai i vjetri nuk ka përputhshmëri dhe as interferencë me Ligjin për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore Numër 03/L-154 për sa i përket mënyrës së fitimit dhe humbjes së të drejtave mbi pronën e paluajtshme. Mirëpo, Lëvizja "Vetëvendosje" do ta votojë në parim këtë projektligj, por do të jemi aktivë në komisione për të inkorporuar të gjitha mangësitë e këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shefi i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Mendojmë se ligji meriton që të votohet. Grupi Parlamentar i Aleancës do ta votojë në parim këtë projektligj. Me siguri se do të ketë nevojë për ndryshime të vogla gjatë punës nëpër komisione. Faleminderit!

KRYESUESI: Për Grupin Aleanca Kosova e Re, kush flet? Sevdije Lama e ka fjalën!

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re mbështet në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 2002/5 për themelimin e regjistrimit të të drejtave të pronës së paluajtshme, me rekomandimet e komisionit përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sasha Rashiq, flet për SLS!

SAŠA RAŠIĆ: Hvala, poštovani predsedavajući!

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke je razmotrila Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakona 2002/5 o osnivanju registra imovinskih prava na nepokretnu imovinu i u načelu ćemo podržati ovaj zakon i svoj doprinos dati kroz funkcionalnu komisiju.

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin “6+” Mufera Shinik!

MÜFERA ŞINIK: Teşekkür ederim.

Sayın Meclis Başkanı yardımcısı

Sayın Başbakan yardımcıları

Sayın Bakanlar ve

Değerli Milletvekilleri

Taşınmaz mülkiyete mülk hakları kayıtlarının kurulmasına ait 2002/5 numaralı Yasanın değişmesi ile tamamlanmasıyla ilgili Yasa Tasarısı, Kosova vatandaşları için çok büyük önem taşımaktadır. İvedilikle işlenmesi gereken bu yasa tasarısında önemli eksiklikler görülmektedir.

Bu eksiklikleri yasa tasarısının ikinci okunuşuna kadar fonksiyonel komisyona sunacağımızı bildirerek, 6+ Parlamento Grubu olarak birinci okunuşunu kabul ediyoruz. Teşekkürler.

KRYESUESI: Faleminderit! Ne nuk kemi emër tjetër që është i interesuar të diskutojë. Presim një minutë të vijnë njerëzit për ta votuar ligjin.

Unë nuk dua të mbaj moral, se këtu ka deputetë të vjetër dhe të rinj, po koalicioni qeverisës e di që e ka detyrim ta krijojë shumicën. Po, detyrim të zgjedhurish që të mirren me ligjet kanë edhe të tjerët, kështu që mos e bëni si sport, kishe po i flasim pesë fjalë e të ikni pa i bërë ligjet. Kjo kërkohet për çdo ligj deri në fund, se kjo është seancë për ligje sot.

Momentalisht në sallë ka 69 deputetë, regjia le të bëhet gati dhe deputetët ta votojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e regjistrimit të drejtave të pronës së paluajtshme. Votojmë tash.

Ligji në lexim të parë votohet me 59 vota “për” dhe 7 “kundër”.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

Kalojmë në pikën e re, të gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Ekonomiko-Social

Ftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë këtë projektligj. Urdhëro, zotëri!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Poštovane kolege ministri,

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Pre svega, ovaj zakon je već bio u Parlamentu prošle godine u prošlom sazivu, ali nije stigao do kraja da bude regulisan, odnosno usvojen, tako da mislim da samim tim što poslanici koji su već bili u prošlom mandatu već znaju one ukupne informacije u vezi zakona, tako da smatram da neće biti problem usvojiti ga, a pored toga siguran sam da znate da je to bio jedan od onih u progresu riportu koji imamo svakih šest memeci, predstavljen je jedan od onih stavki koja je uvek bila kao obaveza Ministarstva za rad da taj sam savet, Socijalno-ekonomski savet profunkcioniše. Tako da ću ja pokušati da vas ukratko informišem šta u stvari sam Ekonomski-socijalni Savet treba da radi i šta je njegova poenta samog funkcionisanja tog organa.

Kao i svako drugo društvo Jugoistočne Evrope, i Kosovo prolazi fazu tranzicije u pravcu tržišne ekonomije i konsolidovanja demokratije, potrebni i neophodni proces u primeni i prilagođavanju uloge i funkcije mnogih institucija, obuhvatajući u tome i samo socijalno partnerstvo.

Od početka procesa integracije u samoj Evropskoj zajednici, socijalna dimenzija se smatra kao jedno od vrlo jakih stubova socijalnog evropskog modela.

Proces integracije koji obuhvata balkanske zemlje, sve se više bazira u strukturnim vezama između ekonomskog povećanja i balansiranja socijalnog interesa, realizovanih putem dijaloga na raznim nivoima: na nacionalnom, sektorijalnom i na nivou kompanija.

Sloboda pregovaranja i osnovna prava radnika i poslodavaca su jedna potrebna osnova za adekvatan razvoj i funkcionisanje politika zapošljavanja, ekonomskih politika, takođe i socijalnih.

Glavni cilj donošenja ovog zakonskog akta jeste stvaranje jedne zakonske infrastukture, gde bi se odredili - definisali odredbe za osnivanje, strukturu i funkcionisanje Socijalno-ekonomskog saveta, koji bi bio jedan od mehanizama dosta značajnih i odgovornih u politikama zapošljavanja, socijalne zaštite i ekonomskim politikama.

Socijalno - ekonomski savet biće nezavisni i nepolitički organ, koje će da posluži kao jedan organ za konsultacije između organizacija poslodavaca, posloprimaoca i same Vlade.

Prema odredbama ovog zakonskog akta koji se danas razmatra, ovim zakonskim aktom određuje se i utvrđuje način osnivanja Ekonomsko-socijalnog saveta, podsticaj socijalnog

dijaloga između socijalnih partnera i utvrđivanje zadataka, odgovornosti i kompetencija odnosno nadležnosti ovog organa koji je od posebnog interesa za institucije Kosova.

Takodje, sa odredbama ovog zakona su definisani – određeni i kriterijumi za stupanje organizacija u samom savetu. Prema tome, u samom savetu, koji je ranije bio tripartitni savet, sada postoje 15 članova odnosno predstavnika tri određenih različitih institucije, u ovom slučaju predstavnike Vlade, kojih ima 5, predstavnika poslodavaca, kojih ima takođe 5 i predstavnika sindikata odnosno posloprimaoca, kojih ima 5.

Ovaj Nacrt zakona je jedna novina u okviru zakonske infraskture Kosova, jer po prvi put se uređuje zakonom delokrug odgovornosti i razvoj aktivnosti jednog organa, koji će biti sastavljen od predstavnika poslodavaca, predstavnika posloprimaoca i Vlade Kosova.

Sam savet već funkcioniše od početka 2008, a i mi smo u tom savetu već imali određene napretke i dijaloge same. U samom savetu ima predstavnike pored Vlade, pored Ministarstva za rad, Ministarstva obrazovanja, Ministarstva trgovine i industrije i Ministarstvo poljoprivrede i Ministarstva lokalnog razvoja, ekonomije, izvinjavam se. U drugom sektoru poslodavaca imamo četiri predstavnika Privredne komore Kosova, jedan je predstavnik Alianse kosovskih biznisa. Sa strane sindikata imamo predstavnike iz BSPK odnosno Udruženi sindikati i nezavisni sindikati Kosova i takođe KSDK, koji imaju dva svoja članova u tom predstavljanju i mi smo našim tim delovanjima pored razmatranja različitih zakona, kao što jedan od njih moram da pomenem – Zakon o radu, sada smo skoro imali pre nedelju dana jedan zaključak predloga koji će verovatno skoro biti razmatran i u Uredu premijera, to je bilo u vezi utvrđivanja minimalne zarade, odnosno utvrđivanje minimalne zarade za rad. Prema tome, mi smo sve ovo vreme bili funkcionalni. Ovo što se danas predlaže i zakon, je samo da to kažem, takvo legalizovanje, odnosno stavljanje u jedan normalan okvir koji bi mogao da ima podršku i da dalje nastavi da funkcioniše.

Mi smo se i potrudili sa strane Ministarstva da obezbedimo i normalne uslove za rad samog saveta, tako da mi pokrivamo i tu tehničku sveru u kome smo angažovali i dva službenika koji će voditi računa o svim aspektima koji su bitni.

Uglavnom Savet je i do sad funkcionisao vrlo transparentno i mislim da je u pravcu socijalnog delovanja u tom progresu pridruživanja, ovaj Socijalno-ekonomski savet vrlo bitno.

Prema tome, znate i sami da se mi svi trudimo da pratimo te naše linije odnosno da pratimo te preporuke koje su dolazile od strane Evropske unije tako da je u ovom slučaju jedna od tih preporuka, po meni, vrlo značajnih za razvoj tog nekog socijalnog dijaloga, jer ipak sve šta god radimo, sve počinje dijalogom. Hvala vam puno!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fikrim Damka, nëse e do fjalën? Kryetar i komisionit funksional!

FIKRIM DAMKA:

Sayın Meclis Başkanı yardımcısı
Sayın Bakanlar ve
Değerli Milletvekilleri

Kosova Cumhuriyeti Meclisinin İş Yönetmeliğinin 56. maddesinin 2. fıkrasına dayanarak, 27.04.2011 tarihinde Sağlık ve Sosyal Çalışma Komisyonu toplantısında, Kosova'da Sendikalar Organizasyonunu düzenleyen Yasa Tasarısı görüşülerek, Meclisin İş Yönetmeliğinin 54.maddesine uygun olduğu, Kosova'daki yasalara uyumlu olduğu ve demokrasi sürecinde Kosova'da sendikaların kurulması, bunların çalışma yöntemlerinin belirlenmesi ve işçi haklarının korunmasını düzenleyen bu yasa tasarısının aynı zamanda Avrupa Birliği yasalarına harmonize edildiği, Kosova bütçesine etkisinin fazla olmadığı tespit edilmiştir.

Üş dilde hazırlandığı, fakat İngilizce dilinde çok kötü tercüme edildiği ve bunun düzeltilmesi gerektiği görüşü, komisyon tarafından oybirliğiyle ilk okunuş için Meclise sevk edilmesi kabul edilmiştir.

Komisyon olarak bu Yasa Tasarısının ilk okunuşunun Meclis tarafından onylanmasını ve gerekli düzeltme ve teklifleri komisyona iletilerek, yasanın en iyi şekilde son halinin almasını değerli milletvekillerinden beklemekteyiz.

Teşekkürler.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk është koha, po është edhe koha të theksohet që kur të flitet në emër të komisioneve - që krijojnë në veti tërësinë e Kuvendit, të flitet në gjuhë zyrtare të Kuvendit.

Individualisht, çdo deputet e ka të drejtën e shprehjes në gjuhën e vet, por kur flitet për aktet dhe në emër të komisioneve të gjithë Kuvendit, flitet në gjuhët zyrtare.

Për Partinë Demokratike, flet deputetja Flora Brovina!

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Përshëndetje, të gjithëve,

Rregullimi i marrëdhënieve ekonomiko-sociale në vend është një parakusht dhe obligim kushtetues. Ministri tha se Këshilli Ekonomiko-Social në të vërtetë funksionon prej vitit 2008. Projektligji i tillë ka qenë në mandatin e kaluar në Parlament dhe është aprovuar, në parim, mirëpo nga Komisioni për Shëndetësi dhe Çështje Sociale është stagnuar procedura më tutje për shkak të mungesës së ligjit bazë, nga ku del edhe ky projektligj, e është Ligji i punës. Pra, me Ligjin e punës, si një ligj bazë, parashihet formimi i Këshillit Ekonomiko-Social dhe tani pas aprovimit të këtij ligji, pra, është në rregull që të aprovojme edhe projektligjin dhe projektligjet tjera që dalin nga Ligji i punës.

Projektligji për Këshillin Ekonomiko-Social është një ndër ligjet bazike që rregullon marrëdhëniet në mes të partnerëve të interesuar për rregullimin e çështjeve ekonomiko-

sociale e që janë tri palësh, pra: punëdhënësit, punëmarrësit dhe Qeveria. Këta partnerë duhet të ndihen të barabartë dhe ndihen në Projektligj, duke qenë se prezantojnë interesat e tyre vetjakë dhe pa dallime nacionale, sociale dhe gjinore. Kjo fjala gjinore mungon në Projektligj dhe duhet t'i shtohet. Kjo ka qenë edhe vërejtje e mëhershme në komision ku kam marrë pjesë.

Ky Këshill Ekonomiko-Social është një ndër organet e pavarura nacionale për konsultim, për çështje të rëndësishme që rregullojnë marrëdhëniet e punës, marrëdhëniet dhe çështjet tjera që dalin nga politikat sociale dhe Ligji i punës, si dhe politikat ekonomike të vendit.

Unë do të thosha dhe do t'i shtoja këtij projektligji edhe politikat sociale, duke përfshirë edhe sigurimet shoqërore, të cilat sikur i kemi lënë pas dore dhe për të cilat duhet të interesohemi më shumë pasi që këto po shkaktojnë probleme dhe janë të lidhura me marrëdhëniet e punës dhe me interesat të cilat i përfaqëson ky këshill trepalësh.

Sa i përket legjislacionit, gjithashtu mendoj që ky këshill në të ardhmen, duke qenë edhe i plotësuar me komisionet që parashihen të formohen – komisionet profesionale, duhet të ketë një ndikim më të madh në nxjerrjen e legjislacionit shumë të nevojshëm në këtë lëmi. Në përgjithësi, ky projektligj është i nevojshëm të plotësohet me vërejtjet që do t'i japim edhe pas propozimit që ia bëj komisionit pra për çështje sociale, që të organizojë një debat të hapur me të tre këta partnerët bashkëbisedues që prezantojnë në këshill.

Vërejtja ime ka të bëjë edhe me përfaqësimin në rastet kur partnerët, si janë punëdhënësit dhe punëmarrësit, më shumë se pesë përfaqësues, i plotësojnë kushtet si zgjidhen ata. Këto çështje sigurisht do të debatohen në këto tryeza ose të rrumbullakëta ku do t'i shqyrtojmë këto çështje.

Çështja e financimit, për mua mbetet diskutabile pasi që raporti financiar më duket i vjetruar, është nga mandati i kaluar dhe nuk jep shumë shpjegime për këtë periudhë.

Në përgjithësi, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike në parim e jep pëlqimin për këtë ligj shumë të domosdoshëm dhe më se të nevojshëm për zgjidhjen e marrëdhënieve të politikave socialo-ekonomike të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete Brovina! Për Grupin Parlamentar të LDK-së, flet deputeti Bahri Thaçi!

BAHRI THAÇI: Faleminderit, zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar projektligjin e ofruar nga Qeveria. Ky projektligj rregullon organizimin, fushëveprimin dhe funksionimin e Këshillit Ekonomik-Social.

Themelimi i këtij Këshilli Ekonomiko-Social është i një rëndësie të madhe, bazuar në fushën të cilën ai e mbulon, e që është dialogu social në të cilin përfshihet realizimi i të drejtave ekonomiko-sociale, profesionale për të punësuarit dhe për punëdhënësit.

Titulli i projektligjit lë për të diskutuar, më se duhet të jetë këshill ekonomik-social apo këshill social-ekonomik. Nga teksti i projektligjit konstatojmë e kemi të bëjmë me rregullativë e cila përcakton normat e sjelljes së subjekteve të partneritetit social dhe se primare për këtë ligj është themelimi dhe funksionalizimi i një këshilli që do të koordinonte çështje sociale me përfaqësuesit e të tre partnerëve socialë: punëdhënësit, punëmarrësit dhe të Qeverisë.

Projektligji, në nenin 15 paragrafi 8, parasheh përcaktimin e shumave mujore të kontributeve të organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve me anë të aktit nënligjor. Konsiderojmë se një zgjidhje e kështillë është në kundërshtim me parimin e përcaktimit të detyrimeve dhe të drejtat e subjekteve të së drejtës me akt nënligjor.

Projektligji nuk rregullon në tërësi çështjen e financimit dhe shfrytëzimit të buxhetit të Këshillit Ekonomiko-Social. Mungojnë dispozitat të cilat do të saktësonin apo së paku do të përcaktonin parametrat e krijimit të hyrave gjegjësisht të buxhetit të Këshillit Ekonomiko-Social, si dhe parametrat për shfrytëzimin dhe ndarjen e atyre mjeteve.

Neni 17, paragrafi 4 i Projektligjit duhet të riformulohet dhe, sipas nevojës, t'i shtohen dispozita të tjera të cilat caktojnë mënyrën e votimit, si votim i fshehtë apo votim i hapur, e jo votim ndaras, institut juridik ky i panjohur në procedurat e votimit dhe vendimmarrjes.

Ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës angazhohemi gjatë procesit të shqyrtimit të mëtejme në komisionin parlamentar përkatës që të amendamentohet, të plotësohet dhe rrjedhimisht të përmërisohet dhe si i tillë të jetë ligj funksional që do të rregullonte çështjen të cilën e mbulon, e sikur që u tha më lartë, janë shumë të rëndësishme për qytetarin e Republikës së Kosovës. Sa janë këto të rëndësishme, për çdo ditë e konstatojmë me pacientë të cilët shpeshherë kanë nevojë të madhe për mbrojtje shëndetësore, sepse vijnë të sëmurë dhe fatkeqësisht nga etika mjekësore duhet t'iu ofrojmë një pushim mjekësor prej disa ditëve deri sa të sanohet gjendja shëndetësore e tyre dhe, jam kategorik – nuk guxojnë ta shfrytëzojnë atë të drejtë legjitime sepse, në të shumtën e rasteve, e humbin vendin e punës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për “Vetëvendosjen” flet deputetja Aurora Bakalli!

AURORA BAKALLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për Këshillin Ekonomiko-Social lejon funksionimin e këtij këshilli, i cili do të jetë përgjegjës për politikat e punësimit, mirëqenien sociale dhe politikat ekonomike dhe si të tillë e konsiderojmë mjaft të rëndësishëm.

Megjithatë, kemi hasur në shumë vërejtje gjatë shqyrtimit të këtij ligji dhe disa më të mëdha do t'i them këtu.

Në nenin 2 dhe gjithkund në tekst mendojmë se fjala “punëmarrësit” do të duhej të zëvendësohet me fjalët “të punësuarit” apo “punëtorë”, sepse krijohet një huti, thua se është fjala për një kompani që kontraktohet për të kryer një punë.

Në nenin 6, te përbërja e KES-it parashihen të jenë 5 përfaqësues të organizatës së punëtorëve, 5 punëdhënës dhe 5 përfaqësues nga Qeveria e Kosovës. Konsiderojmë se punëtorët janë në disfavor numerik, kështu që do të duhej bërë diçka që të vendosej një baraspeshë.

Ndër opsionet që do t’i jepnim ne, është për shembull që vendimet që prekin drejtpërdrejt çështjen e punëtorëve, të merren me 4/5 e votave apo me 12 vota. Një mundësi tjetër është edhe inkuadrimi i shoqërisë civile në këtë përbërje apo të paktën t’i jepet rol i fuqishëm monitorues shoqërisë civile.

Tek neni 9, ku flitet për përgjegjësitë dhe kompetencat e KES-it, do të duhej në një paragraf në mënyrë të qartë të thuhet se KES-i është përgjegjës për caktimin e pagës minimale vjetore. Pra, në pikën 1.6 mund të thuhet – “të përcaktojë pagën minimale vjetore dhe këtë t’ia rekomandojë Qeverisë së Republikës së Kosovës në fundin e çdo viti paraprak”. Mirëpo, gjithashtu, te marrja e vendimit të pagës minimale, mendojmë se kjo duhet të bëhet ose me konsensus apo me 12 anëtarë, gjegjësisht 4/5 dhe rrjedhimisht do të ndërrojë edhe paragrafi i parë i nenit 17, ku flitet për vendimet, se si merren vendimet brenda KES-it.

Tek neni 11, ku është paraqitur skanogrami i KES-it, mendoj se mungon, nuk përmendet kryesuesi, kryesuesi përmendet diku shumë më poshtë në ligj dhe mendoj se pika 11.1 do të duhej të ishte se KES-i udhëhiqet nga kryesuesi i KES-it.

Kur flitet për organet, është mirë të thuhet – organet administrative. Gjithashtu, tek organet administrative të KES-it, sekretariati do të duhej të ishte i pari, e më pastaj të radhiten komisionet profesionale dhe grupet negociatore.

Ky ndryshim do të nënkuptonte që tërë renditja e Ligjit të ndryshonte dhe së pari të flitej për kryesuesin, pra neni 20 të bëhet neni 12, pastaj për sekretariatit e kështu me radhë.

Te neni 12, pika 6, ndër të tjera thuhet se anëtarët e komisionit nuk mund të kenë nivelin më të ulët se udhëheqësit e divizionit të departamentit të ministrive përkatëse. Konsideroj se ky është një diskriminim ndaj profesionistëve të kualifikuar, aq më tepër kur dihet se tek ne politika ndërhyrës edhe në përzgjedhjen e nivelit të drejtorëve.

Neni 19 parasheh se kryesuesi i parë do të jetë përfaqësues nga Qeveria, ndërkaj nuk parashihet kush vjen në radhë në mandatin e ardhshëm.

Neni 20, thuhet – kryesuesi të përgatisë raportin vjetor për punën e KES-it. Ky është mandat i sekretariatit e jo i kryesuesit, ndërkaj kryesuesit i takon t’i bëjë vërejtjet dhe ta nënshkruajë atë.

Varianti në gjuhën angleze është përpunuar në mënyrë skandaloze, sigurisht me google-translater dhe kërkon ripunim të tërësishëm. Edhe teksti në gjuhën shqipe ka nevojë për korrigjime.

Ne, në parim do ta mbështesim këtë ligj, me kusht që këto propozime të merren në konsiderim, sepse në formën e tanishme nuk mund të realizojë atë për çka është draftuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit deputete! Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës i kam dy të paraqitur, po më duket. Kush flet? Deputetja Time Kadrijaj!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të nderuar,

Këshilli Ekonomiko-Social themelohet me qëllim të vendosjes dhe zhvillimit të dialogut social në Kosovë për të punësuarit dhe punëdhënësit, për çështje të rëndësisë së veçantë që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave të tyre ekonomike, sociale e profesionale që realizohen nëpërmes zgjidhjeve të kontesteve në marrëveshje dy palëshe apo tre palëshe.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka bërë shqyrtimin e Projektligjit për Këshillin Ekonomik-Social dhe do ta votojë në parim me qëllim që kontributin e vet do ta japë në komisionin parlamentar ku bëhet shqyrtimi i këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar Kosova e Re, Gëzim Kelmendi!

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Koalicioni për Kosovë të Re, në parim do ta përkrahë Projektligjin për Këshillin Ekonomik-Social me qëllim që në shqyrtimin e dytë do të merren parasysh të gjitha analizat dhe vërejtjet e komisionit përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin “6+”, kush flet? Deputeti Albert Kinolli!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar “6+”, pas shqyrtimit të Projektligjit për Këshillin Ekonomiko-Social dhe pas rekomandimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në parim do ta miratojë këtë projektligj, ndërsa vërejtjet e veta eventuale do t'i japë përmes komisionit përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk kemi të paraqitur në emër të grupeve politike parlamentare. Jelena Bontiq, besoj është për SLS! Urdhëro!

JELENA BONTIĆ:

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Kalojmë në diskutimet e deputetëve. Fjalën e ka deputeti Ramiz Kelmendi!

RAMIZ KELMENDI: I nderuari kryesues,

Unë desha të kyçem pak rreth çështjes së pagës minimale. Marrëveshja në mes të punëdhënësit dhe punëkryerësit për pagë sociale nuk duhet të ekzistojë. Paga minimale në Kosovë duhet të jetë mbi 200 euro për të gjitha ato kompani që kanë bilanc pozitiv të punës së vet. Nëse ato kompani kanë bilanc negativ të punës së vet, mund të jetë ndoshta edhe më e ulët, me një koeficient apo me një përqindje të caktuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Sali Asllanaj!

SALI ASLLANAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë e mora fjalën që pikërisht të flas diçka kundër atij propozimi që e dha zoti Kelmendi, sepse konsideroj që edhe ky këshill ekonomiko-fiskal është i ndërtuar në formë të tillë që objektivisht bëhet diçka që gjëja po marrim në konsideratë mendimet e klasës punëtore, të themi në atë gjuhën e kaluar, dhe të njëjtën kohë të mos veprohet asgjë. Sepse, vetë përbërja e Këshillit Ekonomiko-Social është e tillë që objektivisht e kemi rezultatin 10 me 5 në favor të punëdhënësve. Edhe Qeveria e Kosovës është një punëdhënës dhe atë shumë i fuqishëm, edhe biznesmenët janë krejt ata burrat e mirë që e kanë një krah në qeveri, thjeshtë është një dekorim i këtij këshilli ekonomik-social.

Mendoj që propozimi i deputetes Bakalli ka qenë mjaft i qëlluar dhe në këtë aspekt kisha dashur ta përsëhendes dhe ta përkrah, që ky këshill të formohet në një formë të tillë që objektivisht më shumë të dëgjohet mendimi i punëmarrësve, sepse me këtë formë do të eliminonim format tjera organizative të sindikatës, siç është rruga, protestat e tjera.

Tash, do të ishte mirë që ky këshill të përbëhej nga 5, 5, por me një pjesëmarrje simbolike të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndoshta me 1 anëtar dhe me 3-4 anëtarë nga shoqëria civile. Në këtë formë do t'u jepnim hapësirë shumë më të madhe punëmarrësve, të cilët për momentin janë në gjendje katastrofale. Prandaj, thashë, tingëllon pak i majtë ky diskutim i imi, por gjendja është e tillë që ka nevojë nganjëherë të jemi edhe të majtë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Relikë, zoti Ramiz Kelmendi ka replikë!

RAMIZ KELMENDI: Unë kam qenë një kohë anëtar i Këshillit Ekonomiko-Social dhe e kam parë që në atë këshill ekziston mbivotimi në mes të punëdhënësve dhe punëmarrësve, për arsye se gjithnjë qeveria ishte në krahun e punëdhënësve. Prandaj, ishte dashur që me këtë ligj ta ndryshojmë këtë raport dhe pjesëmarrja e Qeverisë le të

jetë si një pjesëmarrje e përshtatjes apo të përafrimit të kërkesave dhe ofertës që bëjnë punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Pse e qita edhe një herë çështjen e të ardhurave personale minimale? Të ardhurat personale minimale eliminohen nga disa tatime, sidomos nga tatimet në fondin pensional. Prandaj, këto të ardhura personale të propozuara janë të ardhura sociale për arsye se nuk do të shkojë asnjë cent në fondin pensional të punëtorit i cili punon për të ardhmen e vet që të ketë pension të më vonshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Prapë, replikë! Zoti Asllanaj, urdhëro, shkurt!

SALI ASLLANAJ: Zoti Kelmendi, në asnjë mënyrë nuk e kontestoj atë që e thashë edhe unë, sepse konsideroj që vërtet edhe biznesi ose punëdhënësi, edhe Qeveria janë një kategori e njëjtë. Objektivisht, të dyjat kanë interes të njëjtë. Paske pas fatin për të qenë në Këshillin Ekonomik-Social në kohën kur idetë paskan qenë të majta më shumë dhe ka shkuar, por nëse vjen një qeveri e djathtë, atëherë kishte për të qenë katastrofale për punëtorët. Faleminderit!

KRYESUESI: Ah, kjo e majtë, e djathtë! S'di a e dini ju të dytë kush është, por punë tjetër është. Lutfi Zharku e merr fjalën!

LUTFI ZHARKU: I nderuar, nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Shkurtimisht disa vërejtje parimore në lidhje me Projektligjin, do të vazhdoj sipas neneve që janë. Së pari, në lidhje me kriteret për përfaqësim të punëmarrësve dhe punëdhënësve. Janë disa kriterë, besoj disa prej tyre janë të pamatshme ose në masë të madhe nganjëherë nuk e përfaqësojnë, nuk e kanë peshën apo rëndësinë e duhur, sikurse që është numri i marrëveshjeve apo numri i kontesteve të zgjidhura. Po ashtu, edhe 10% e numrit të të punësuarve, besoj se është një shkallë shumë e lartë dhe ndikon në pengimin e formimit të organizatave tjera sindikale apo, në rastin e punëmarrësit, në pengimin e formimit – themelimit të shoqatave të ndryshme të biznesit.

Sa i përket organizatës së punëdhënësve, organizatave të punëdhënësve, kam edhe një vërejtje tjetër se numri i regjistrimit, numri i bizneseve të regjistruara nuk bëhet, nuk mund të merret sipas asaj që është në Administratën Tatimore të Kosovës, sepse institucioni zyrtar për regjistrimin e bizneseve është Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë.

Në lidhje me përfaqësimin e institucioneve tona, ne kemi aty Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Tregtisë e Industrisë, MASHT-in dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Unë personalisht besoj që në këto është dashur të jetë edhe Ministria për Zhvillim Ekonomik duke marrë parasysh rëndësinë e asaj ministrie të posa themeluar, posaçërisht po flasim për çështjen e pagës minimale. Dihet se paga minimale është një ndër indikatorët kyç që mund të ndikojë në punësimin apo në zhvillimin ekonomik të vendit, kështu që pa i nënvlerësuar Ministrinë e Arsimit dhe

Ministrinë e Shëndetësisë, besoj se përparësinë më të madhe do ta kishte Ministria për Zhvillim Ekonomik.

E kam të pa qartë sa i përket funksionimit të sekretariatit. Në ligj thuhet, në projektligj në realitet thuhet që sekretariati përbëhet prej 3 përfaqësuesve të Qeverisë, të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, kurse në realitet sekretariati kryen punë teknike, administrative, operative, profesionale. Nëse kemi të bëjmë me punë administrative, thjeshtë teknike, besoj se përfaqësimi nuk është i nevojshëm, por do të ishte një punësim normal apo shërbyes civilë, kështu që sekretariati nuk besoj se duhet të jetë me përfaqësim, por normal si të punësuar apo shërbyes civilë sikurse janë në institucionet tjera të Kosovës.

Sipas nenit 15, sa i përket buxhetit, unë personalisht mendoj që buxheti i Këshillit Ekonomik-Social duhet të jetë pjesë e buxhetit të Ministrisë për Mirëqenie Sociale dhe bashkë ai buxhet i paraparë për KES-in të aprovet nga Qeveria dhe të miratohet nga Kuvendi si miratim i buxhetit të konsoliduar të Kosovës që bëhet në bazë vjetore.

Jam kundër asaj që të paguhen anëtarët e Këshillit Ekonomik-Social, të gjithë anëtarët e Këshillit Ekonomik-Social pavarësisht a janë përfaqësues të institucioneve apo të punëmarrësve apo të punëdhënësve, ata përfaqësojnë organizatat e tre sipas detyrës zyrtare dhe nuk duhet të paguhen.

Dhe, në fund, krejt në fund, sa i përket kryesimit, unë besoj se kryesimi nuk duhet të jetë në rrotacion, por çdoherë duhet të jetë kryesimi nga ana e Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zharku! Diskutuesi i fundit është deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Deri sa më erdh rendi, shumë gjëra u thanë këtu, mirëpo po e potencoj vetëm një apo dy vërejtje që i kam shumë, mendoj unë, thelbësore sa i përket Ligjit por edhe funksionimit të Këshillit në përgjithësi, e ajo është pikërisht formati apo karakteri që e ka ky këshill, për shkak se këtu shihet që dy prej funksioneve të cilat janë kryesore të këtij Këshilli, siç thuhet në nenin 8 të tij, janë këshillimi dhe udhëzimi i institucioneve të Republikës së Kosovës në krijimin dhe realizimin e politikave së punës, të mirëqenies sociale dhe të politikave ekonomike, si dhe 1.2. nxitja e konsultimeve në mes palëve, si dhe nënshkrimeve i kontratave dhe i marrëveshjeve kolektive në nivel nacional.

Pra, në njëfarë mënyre ne e kemi një këshill, i cili nuk ka kurrfarë kompetencash, përveç ta këshillojë Qeverinë dhe, në anën tjetër, këtij Këshillit i mëvishet edhe një funksion i cili është tejet i rëndësishëm, e që është nënshkrimi i kontratës dhe marrëveshjes kolektive.

Konsideroj që një mënyrë e këtillë e dizajnit të këtij Këshilli është vetëm sa për ta pasur atë, e jo që do të kemi ndonjë ndikim të këtij Këshilli në atë për çka ky zotohet se do ta mbulojë, pra fushëveprimin të cilin do ta mbulojë.

Pastaj e kemi te neni 9, ku listohet një listë e gjatë, dhjetë sosh detyra dhe përgjegjësi dhe kompetenca të Këshillit dhe më pastaj në nenin 10 shihet faktikisht karakteri i vërtet i këtij këshilli, ku thuhet që në nenin 10 pika 3, Ministria përkatëse është e detyruar që në afatin prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së vlerësimit – të rekomandimit, ta informojë KES-in për qëndrimin e saj lidhur me çështjen në fjalë. Dhe pika 4, thotë që – në rastet kur vlerësimet, rekomandimet janë të papranueshme për ministrinë përkatëse, KES-i mund t’ia paraqesë Qeverisë së Kosovës vlerësimin – rekomandimin lidhur me çështjen në fjalë. Dhe, këtu përfundon puna e KES-it. Pra, në këtë mënyrë shihet që Këshilli Ekonomiko-Social nuk do të ketë kurrfarë kompetence ose mundësi ndikimi në çështjet që kanë të bëjnë me çështjet ekonomike dhe veçanërisht ato sociale.

Ne dimë, këtë e kemi parë në Kosovë, domethënë, për sa i përket mënyrës se si trajtohen punëtorët dhe si trajtohen përgjithësisht ata nga punëdhënësit si në kushtet e punës, po ashtu edhe në kushtet tjera që iu ofrojnë, si te pagat dhe te pushimet e tjera, ka raste shumë eklatante të shkeljes jo vetëm të ligjeve në fuqi, por edhe të një etike të sjelljes ndaj punëtorëve, por konsideroj që kjo çështje nuk lëngon për shkak të mungesës së ligjeve, por lëngon për shkak të mungesës së mekanizmit për zbatimin e ligjeve, ku i bie përgjegjësi ekzekutivit dhe brenga ime është se edhe ky ligj do të jetë një ligj i cili do të na mundësojë neve si deputetë, por edhe si qytetarë të Kosovës, të themi nesër që e kemi ligjin dhe e kemi këshillin, por realisht nuk do të sjellë kurrfarë ndryshimi real në sferën për të cilën po flasim.

Unë e di që dialogu është i rëndësishëm dhe dialogu është i mirëseardhur, mirëpo ne nuk duhet po ashtu të harrojmë faktin se për sa i përket marrëdhënies në mes punëdhënësit dhe punëtorit apo punonjësit, nuk është çështje vetëm që mund të zgjidhen krejt me dialog, për shkak se aty çështje më e madhe janë interesa kundërthënëse dhe këto interesa kundërthënëse nuk konsideroj se do të mund të zgjidhen të gjitha prej tyre nga ky këshill. Natyrisht që Kosovës i nevojitet një infrastrukturë e mirëfilltë ligjore, e cila e mbron punëtorin nga punëdhënësi dhe i cili ia mbron të drejtat punëtorit dhe ia mbron atij, domethënë, e mbron atë në njëfarë mënyre nga punëdhënësi dhe nga arbitrariteti i mundshëm i punëdhënësit.

Po ashtu, edhe një fjalë desha ta them për këtë ligj, e që u cek këtu, është te çështja e burimeve financiare për punën e KES-it. Konsideroj dhe edhe unë pajtohem me deputetin Zharku që KES-i ishte dashur të financohet vetëm nga buxheti i Kosovës, pra të financohet nga Kuvendi i Kosovës, në mënyrë që t’i iket kështu ndikimit që mund ta ketë KES-i nga donacionet apo financimet tjera që mund t’i vijnë. Ne e shohim këtu që në nenin 1.2, më falni, në nenin 15 pika 1.2 te burimi financiar, thuhet që ai financohet edhe nga kontributet e organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve, pra këtu automatikisht krijohet një mundësi e disbalancës për shkak se dihet qartë që organizatat e punëmarrësve kanë mundësi të gjenerojnë shumë më shumë kapital, sesa ato të punëdhënësve dhe në këtë mënyrë rrezikohet që KES-i të bie nën ndikimin e punëdhënësve, si dhe pika 1.3. e cila është, mendoj unë, në formën e vetë të shkruar, absolutisht e pa pranueshme, e kjo është – donacionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Konsideroj që duhet të ceket qartë se çfarë donacione dhe nga kush vijnë,

për shkak se kjo e lë të hapur shumë mundësinë e financimeve të ndryshme që mund t'i vijjnë KES-it dhe të cilat mund ta dëmtojnë interesin e punëtorëve të Kosovës dhe qytetarëve të Kosovës në përgjithësi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet, Ymeri! Nuk ka deputetë të tjerë që duan të flasin për ligjin.

Në sallë kemi 73 deputetë. Ju lutem, të bëhemi gati ta votojmë Ligjin – Projektligjin për Këshillin Ekonomiko-Social. Votojmë tash:

Ligji miratohet, në parim, me 65 vota “për” dhe 5 “kundër”.

Jemi në orën 12,35. Ju jap pushim deri në orën 14:00!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI SABRI HAMITI: Kolegë të nderuar, po vazhdojmë punën! Pika e shtatë e rendit të ditës është:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organizimin sindikal në Kosovë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime, prandaj janë përmbushur kushtet për shqyrtim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës të paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!
Dame i gospodo, narodni poslanici,

Aktuelno, na Kosovu delokrug sindikata uređuje se sa Zakonom o radu, koji je usvojen u decembru prošle godine, a administrativnim upustvom za regulisanje sindikata i sa nekim drugim zakonskim podaktima.

Sloboda za osnivanje i učlanjenje u sindikatima jeste civilno-grđansko pravo, koje je poznato svuda na svetu, jedna od osnovnih prava radnika.

Poštovanje načela slobode udruženja u sindikat ima suštinski značaj za potrebno funkcionisanje sistema radnih odnosa u jednom demokratskom društvu.

Sa druge strane, značajna je i sloboda osnivanja sindikata, gde sindikati odigravaju značajnu ulogu u razvoju i funkcionisanju sistema tržišne privrede i socijalnog dijaloga.

Cilj ovog Nacrta zakona jeste garantovanje sloboda prava zaposlenih na Kosovu da bi se organizovali u sindikat i to prema međunarodnim standardima. Takođe, sa ovim Zakonom utvrđuju se uslovi i kriterijumi za osnivanje sindikata, njihovo registrovanje, relacija - odnosi sindikata sa Vladom, zaštita ekonomskih, profesionalnih, industrijskih i socijalnih prava za radnike, sindikalni legitimiteti, unapređenje i razvoj socijalnog dijaloga između socijalnih partnera, eliminsanje formi sindikalne diskriminacije i druga pitanja iz sindikalnog delokruga.

Imajući u vidu cilj ovog zakonskog akta, normativno uređenje ove oblasti jeste primarni objekat Ministarstva za rad i socijalnu zaštitu, tako da glavna načela koje ovaj nacrt zakona reguliše, su:

1. uređenje, obezbeđenje zakonskog prava za radnike da ostvaruju i da se udružuju - učlanjuju u sindikat prema njihovom izboru, bez nekog prethodnog ovlašćenja;
2. preduzimaju sve potrebne mere da radnici slobodno deluju u okviru sindikata,
3. da stvaraju uslove za sindikalno optimalno delovanje; i
4. da se poštuje sindikalna sloboda i prava za učlanjenje u sindikat.

S obzirom da je reč o jednom Zakonu od posebnog interesa za poslodavce i posloprimaoca na Kosovu, ja vas najiskrenije molim da razmotrite ovaj Nacrt zakona i da na osnovu toga imate i konkretnu i svrhishodnu diskusiju.

Takođe, ovaj zakon je još jedan u sklopu zakona koji utvrđuje ta osnovna prava i obaveze i mogućnosti bilo radnika, bilo tih instrumenata koji su legitimni za zaštitu prava i ja bih još jednom podsetio i da se vratim ponovo na onaj zakon koji je malo pre prošao, da i KES i ovaj Zakon o sindikalnom organizovanju je to pokrenuto bilo od same 2008. godine.

Ja moram da podsetim da je put od samog početka do danas bio vrlo trnovit i da sve ono što smo radili, bilo kroz taj dialog, bilo kroz predlaganje ovakvih zakona je bio balansiran pristup između želje posloprimaoca i mogućnosti poslodavaca.

U ovom slučaju, i mi kao Vlada smo jedna vrsta poslodavca, naravno, zato se možda pravi, da nazovem, neka paralela zajedno sa ostalim predstavnicima poslodavaca, ali poenta baš sindikalnog organizovanja i Socijalno-ekonomskog saveta je baš to – nalaženje mogućnosti ujedinjenja tih želja i mogućnosti.

Ja sam iskoristio jednu reč na zadnjem sastanku, u kojem sam rekao da je ovo maksimum optimuma. Svaki od naših predloga, bez obzira što treba iscrpno izlaganje i iscrpni dogovori, je uvek bio maksimum optimuma. Znači, to je način na koji bi mogli da funkcionišu, uz dogovor. Jer znam da nikad neće biti iste želje posloprimaoca i ono što

poslodavac nudi, nikada neće biti isti. To se dešava svugde i treba znati da je to svugde tako. Nikad ista cifra nije. Ali, doći do jednog zaključka u kome se svi prećutno slažemo da je to realno, e to je po meni uspeh. Jer stvarno mislim da sve ono što smo do sada predložili jeste bio uspeh, i jeste da je neko od posloprimaoca rekao da je to malo, naravno da je neko od poslodavaoca rekao da je to mnogo, ali smo prećutno došli do saglasnog rešenja, do predloga koji svi podržavaju. A to, ipak, treba ceniti u ovom našem društvu koje je malo kompleksno.

Još jednom vas molim da razumete sve ove poteškoće kroz koje prolazimo, sve ovo usklađivanje mišljenja svih relevantnih faktora i da na osnovu toga pokušamo da zajedno stvorimo jednu bazu... Opet da kažem da je ovo baza za dijalog. I šta god budemo radili kroz bilo koji savet, treba da bude kroz dijalog.

Ja se zahvaljujem svima unapred i hvala još jednom!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Tani hap debatin për diskutim, në parim, të ligjit. Sipas Rregullores, fjalën e merr kryetari i Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputeti Fikrim Damka! Deputeti Fikrim Damka, me kartelë të Enis Kervan!

FIKRIM DAMKA:

Sayın Meclis Başkanı yardımcısı

Sayın Bakanlar ve

Değerli Milletvekilleri

Kosova Cumhuriyeti Meclisinin İş Yönetmeliğinin 56. maddesinin 2. fıkrasına dayanarak, 27.04.2011 tarihinde Sağlık ve Sosyal Çalışma Komisyonu toplantısında, Kosova'da Sendikalar Organizasyonunu düzenleyen Yasa Tasarısı görüşülerek, Meclisin İş Yönetmeliğinin 54.maddesine uygun olduğu, Kosova'daki yasalara uyumlu olduğu ve demokrasi sürecinde Kosova'da sendikaların kurulması, bunların çalışma yöntemlerinin belirlenmesi ve işçi haklarının korunmasını düzenleyen bu yasa tasarısının aynı zamanda Avrupa Birliği yasalarına harmonize edildiği, Kosova bütçesine etkisinin fazla olmadığı tespit edilmiştir.

Üş dilde hazırlandığı, fakat İngilizce dilinde çok kötü tercüme edildiği ve bunun düzeltilmesi gerektiği görüşü, komisyon tarafından oybirliğiyle ilk okunuş için Meclise sevk edilmesi kabul edilmiştir.

Komisiyon olarak bu Yasa Tasarısının ilk okunuşunun Meclis tarafından onylanmasını ve gerekli düzeltmele ve teklifleri komisyona iletilerek, yasanın en iyi şekilde son halinin almasını değerli milletvekillerinden beklemekteyiz.

Teşekkürler.

KRYESUESI: Tash bëjnë deklaratat e veta shëfat e grupeve parlamentare ose përfaqësuesit e caktuar të tyre. Për PDK-në, deputetja Salihe Mustafa!

SALIHE MUSTAFA: I nderuari kryesues,
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka analizuar Projektligjin për organizimin
sindikal. Në parim e mbështesim këtë projektligj, por kemi disa vërejtje.

Vërejtjet tona janë, shembull te neni 2, ku flitet për përkufizimet, pika 1.14, ku thuhet
“Sindikata përfaqësuese është organizata sindikale me numër më të madh të anëtarëve të
punësuar të nivelit përkatës”. Duhet të jetë “Sindikata qendrore”.

Te neni 4, ku flet për të drejtat për anëtarësim në organizatën sindikale, thuhet “Anëtari i
sindikates nuk mund të jetë punëdhënësi i sektorit privat”. Duhet t’i shtohet “dhe
punëdhënësi i sektorit publik në kuptimin juridik”.

Te neni 7, flet për krijimin e kushteve për veprim sindikal nga punëdhënësi, pika 2.5.
Krijimin e kushteve optimale për organizimin e mbledhjeve dhe të aktiviteteve të
ndryshme sindikale, ku duhet t’i shtohet “duke u afruar edhe hapësirat dhe sallat për
mbledhje”.

Neni 10, te zgjedhjet në sindikatë, pika 1. Të gjithë anëtarët e sindikatës kanë të drejtë të
jenë zgjedhës dhe të zgjedhur, përveç anëtarëve të cilët ushtrojnë pozita menaxheriale ose
poste vendimmarrëse partiake. Ky nen duhet të riformulohet dhe të thuhet “Të gjithë
anëtarët e sindikatës kanë të drejtë të jenë zgjedhës, të zgjedhur, përveç të emëruarve
politikë në pozita menaxheriale”.

Te neni 12, kushtet dhe kriteret për regjistrimin e sindikatave, pika 2, “Shoqata sindikale
si njësi themelore organizative mund të regjistrohet në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies
Sociale, nëse ka së paku 25 anëtarë sindikalë”. Ky nen nuk duhet të ekzistojë, ngase
krijon mundësi të përçarjeve të sindikatave. Shoqatat sindikale anëtarësohen në sindikatat
përkatëse pa pasur nevojë që të regjistrohen veç e veç në Ministrinë e Punës dhe
Mirëqenies Sociale, me nga 25 vetë.

Te neni 21, prona e sindikatës, thuhet se “Organizatat sindikale kanë të drejtë të kenë
pronë të luajtshme”, mendojmë se duhet t’i shtohet “pronë të luajtshme dhe të pa
luajtshme”.

Te neni 27, ku flitet për presionin sindikal, dy paragrafëve paraprakë duhet t’i shtohet
edhe paragrafi tre, ku flet për nevojën, përdorimin e presionit sindikal. Kryesia e
sindikates formon këshillin grevist, i cili këshill menaxhon me llojin e presionit sindikal,
grevë apo protestë.

Edhe një herë, Grupi Parlamentar i PDK-së e voton projektligjin dhe kontributin tonë do
ta japim në komisionet përkatëse. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të LDK-së, Rita Hajzeraj-Beqaj!

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar, apo zoti kryesues!
I përshëndes të tre ministrat, nga 19 ministra që i ka Qeveria jonë, me siguri tani janë në takime më të rëndësishme se seanca e Kuvendit të Kosovës.

Sa i përket ligjit në fjalë, e kemi Projektligjin për organizimin sindikal në Kosovë. Ky ligj ka qenë nevojë e kahershme që të vjen në Parlamentin e Kosovës. Ky projektligj pra rregullon të drejtat, liritë e punëmarrësve për themelimin, bashkimin, organizimin vullnetar në sindikatë, me qëllim të përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave ekonomike, sociale dhe profesionale të punëtorëve nga puna dhe marrëdhënia e punës.

Sindikata luan rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe funksionimin e ekonomisë së tregut, si dhe mbrojtjen e të punësuarve nga çdo lloj i diskriminimit që iu bëhet atyre nga ana e punëdhënësit, duke bërë përpjekje për zgjedhjen e çështjeve kontestuese me marrëveshje ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit.

Të nderuar deputetë,
Projektligji për organizimin sindikal përcakton të drejtat dhe liritë e punëmarrësve për themelimin, bashkimin, organizimin e lirë dhe vullnetar në sindikatë për qëllim... do të thotë qëllimi i saj është përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave ekonomike, sociale dhe profesionale të punëtorëve që dalin nga puna.

Projektligji përbëhet prej 32 neneve dhe përmban dispozitat duke filluar nga qëllimi, përkufizimi, e drejta për bashkim, për anëtarësim, themelimin e organizatave sindikale, krijimin e kushteve për anëtarësimin në sindikatë, zgjedhjet në sindikatë, pushimi i anëtarësisë, kushtet dhe kriteret për regjistrimin në sindikata, dialogu social, burimet financiare, pronat e sindikatës, përgjegjësia e tjera.

Konventa ndërkombëtare për të drejtat ekonomike dhe sociale, të drejtën në formimin dhe bashkimin në sindikata e njeh të drejtën e çdonjërit sipas zgjedhjes të tyre, që të formojnë sindikata për promovimin, për mbrojtjen e interesit ekonomik dhe social, siç është e drejta e grevës.

Prandaj, bashkimi në një organizatë ka qenë gjithmonë një mënyrë për njerëzit që të shtojnë siguri në një vend të punës, ashtu edhe në komunitet. Palët shtetërore, pra qeveria është e detyruar që të krijojë standarde minimale, ku nuk do të lejohet të bien kushtet e punës të asnjë punëtori.

E drejta për punë për më tepër kërkon mbrojtje nga përjashtimi dhe në çdo rast shteti duhet të sigurojë mbrojtjen nga diskriminimi gjatë kohës së punës. Edhe pse e drejta për punë shumë herë është keqinterpretuar, në këtë pikëpamje ajo i kërkon shtetit apo qeverisë të garantojë punë për çdo njeri dhe apelon që t'i ushtrojnë politikat për të arritur ekonomi stabile, zhvillim social dhe punësim të plotë dhe produktiv.

Në memorandum shpjegues thuhet se e drejta e punëtorit është në pajtueshmëri me parimin kryesor të ILO-s, pra Organizatën Ndërkombëtare të Punës, si dhe një numër i konventave ndërkombëtare dhe rekomandimeve për të drejtat në punë. Megjithatë,

shihet se projektligji i kanë munguar shfrytëzimi i legjislacionit ndërkombëtar të punës dhe është dashur që sponzoruesi t'i marrë në konsiderim konventat e punës të vitit 2003. Pra, zoti ministër, këto konventa i keni anashkaluar plotësisht, si dhe pjesët përcjellëse të tyre. Prandaj, mbetet detyrë e komisionit funksional që gjatë amendamentimit për bazë t'i marrë të gjitha këto konventa ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të cilat janë të lidhura ngushtë edhe me të drejtën e formimit të sindikatës dhe në bazë të tyre të bëjë harmonizimin e ligjit me standardet e legjislacionit evropian.

Gjithashtu, kërkohet që dispozitat të jenë të qarta, konkrete dhe të sakta, duke u bazuar në udhëzimin e hartimit të legjislacionit. Pra, në këtë drejtim konsideroj se komisioni funksional gjatë amendamentimit duhet të mbështetet në nenin 16 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe në nenin 19, që përcakton se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.

Kërkoj të fshihen dispozitat e ofruara në këtë projektligj që nuk kanë karakter legjislativ, ashtu siç evitohet, do të ishte evituar përsëritja e panevojshme e dispozitave ligjore ekzistuese. Konsideroj se këtij projektligji pra i ka munguar, edhe një herë po them, konsultimi i jashtëm nga ana e ekspertëve dhe ka vërejtje në fushën e zbatimit që përcakton fushën e rregullimit të aktit juridik, në mënyrë që marrëdhëniet e caktuara në shoqëri rregullohen për herë të parë në këtë aspekt, andaj në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së konsideroj se ne si deputetë dhe anëtarët tanë në komisionin funksional do ta japin kontributin e tyre për amendamentimin, plotësimin e këtij projektligji.

Meqenëse ky projektligj është jashtëzakonisht i rëndësishëm për shoqërinë tonë dhe ka qenë jashtëzakonisht i nevojshëm, ne e përkrahim, në parim, duke i marrë parasysh kërkesat tona. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Për Grupin e “Vetëvendosjes” deputetja Aurora Bakalli!

AURORA BAKALLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Lidhur me Projektligjin për organizimin sindikal në Kosovë, Grupi ynë parlamentar ka disa vërejtje të cilat do t'i parashtroj këtu. Si edhe në projektligjin paraprak, mendojmë edhe këtu se fjala “punëmarrës” duhet të zëvendësohet me fjalën “i punësuar” ose “punëtor” sepse shkakton hutim të panevojshëm në projektligj.

Vërejtje tjetër është ajo e nenit 11, lidhur me pushimin e anëtarësisë sindikale, që mendojmë se do të duhej të ishte pjesë e brendshme e organizimit sindikal, pra statuti i organizatës do të duhej të parashih kur përjashtohet një anëtar, shoqatë apo federatë sindikale nga organizimi sindikal.

Tek neni 12, ku flitet për kushtet dhe kriteret e regjistrimit të sindikatave, në paragrafin 2 thuhet se shoqata sindikale, si njësi themelore organizative, mund të regjistrohet në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale nëse ka së paku 25 anëtarë sindikalë. Dhe ne

mendojmë se ky numër do të duhej të ishte më i vogël, kështu për shembull, numri prej 10 anëtarësh do të kishte qenë adekuat për kushtet tona, duke pasur parasysh se ekonomia jonë është ende në fazat e hershme të zhvillimit dhe kryesisht mbizotërojnë ndërmarrjet e vogla. Në këtë mënyrë, një numër i madh punëtorësh që punojnë në ndërmarrje të vogla iu privohet mundësia që të krijojnë shoqatë sindikale.

Dhe, në anën tjetër, sipas përkufizimit të shoqatës sindikale, nuk kuptohet se mund të bashkohen disa ndërmarrje që të formojnë një organizatë sindikale.

Vërejtje tjetër është se tek neni 20, lidhur me burimet financiare, te donacionet e ndryshme, mendojmë se duhet të precizohen prej nga vijnë këto donacione dhe në mënyrë të veçantë të përjashtohen donacionet nga qeveria dhe punëdhënësit me qëllim të shmangies së kontrollimit të sindikatës.

Në nenin 25, mbi rolin e qeverisë në garantimin e lirive sindikale, mendojmë se ky nen duhet të hiqet tërësisht apo të paktën të redukohet dhe futet në nenin 3 apo 4.

Neni 27, që trajton presionin sindikal, siç tha edhe kolegja nga PDK-ja, mendojmë se duhet të qartësohen format e presionit sindikal dhe fjalë do të duhej përafërsisht të formulohej kështu: “Për realizimin e kërkesave sindikale lejohen format e presionit sindikal, si protestat dhe grevat e punëtorëve, në pajtim me ligjet e aplikueshme”.

Shkurtesat në tekstin në gjuhën shqipe janë lënë si ato në anglishte, për shembull, Konfederata Ndërkombëtare e Sindikatave të Lira është shkruar si ICTFU, pra nga gjuha angleze Internacional Confederation of Free Trade Unions. Teksti në gjuhën shqipe ka nevojë për korrigjime, ndërsa teksti në gjuhën angleze ka nevojë për një revidim rrënjësor.

Megjithatë, edhe përkundër këtyre vërejtjeve, në parim do ta mbështesim këtë ligj, me kusht që do të bëhet përpunimi tij në të ardhmen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Për Koalicionin Kosova e Re, deputeti Gëzim Kelmendi! Për Aleancën! Mirë, Time Kadrijaj... Po, s'bëhet nami nëse prishet rendi. Time Kadrijaj, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Po, sikur t'ua kishim marrë rendin juve të LDK-së, na kishit qitur prej salle!

KRYESUESI: E re je ti! A e di qysh është, qysh thonë grekët e vjetër – të egër janë ata që janë rishtas në pushtet! Urdhëro!

TIME KADRIJAJ: Të nderuar deputetë,

I nderuari kryesues,

Ky projektligj është i një rëndësie të veçantë për interesin e punëtorëve, interesin e tyre ekonomik, social dhe profesional nga puna dhe marrëdhënia e punës.

Ky projektligj, rregullon dhe përcakton të drejtat dhe liritë e punëtorëve për themelimin dhe organizimin e lirë dhe vullnetar në sindikata. Është organizatë shoqërore e pavarur nga Qeveria, partitë politike dhe nga punëdhënësi, ajo do t'i mbrojë të drejtat dhe interesat e punëtorëve. Ishalla ndodh kështu, se në të kaluarën e kemi një përvojë të hidhur, se organizatat sindikale kanë qenë të manipuluar nga Qeveria dhe rast konkret është Organizata Sindikale e Shëndetësisë, të cilët janë manipuluar nga Qeveria dhe nuk i ka mbrojtur të drejtat e punëtorëve shëndetësorë.

Ky projektligj do të analizohet në komisionin përkatës. Pajtohem me vërejtjet e kolegëve paraprakë. Grupi Parlamentar i Aleancës do ta votojë këtë projektligj dhe do të japë kontributin e vet në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju kisha lutur, për të qenë më të saktë. Grupet parlamentare le të tregojnë më herët, le të paraqiten më herët, kush flet në emër të grupit, se nuk është e mundur që njeriu t'i identifikojë cili e ka të drejtën ose shenjë që flet në emër të grupit ose për vetë. Tash, unë po besoj që Gëzim Kelmendi është për Koalicionin Kosova e Re. Urdhëro!

GËZIM KELMENDI: Po! Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Unë, pa dashur të marr shumë kohë nga koha juaj, pasi që shumica e vërejtjeve u përmendën edhe nga kolegët paraprak, kisha për të veçuar kryesisht vërejtjen tonë te neni 12, konkretisht te pika 2, ku kufizohet numri anëtarëve për të formuar një sindikatë, shoqatë sindikale, në mënyrë që ajo të jetë valide që të anëtarësohet në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kështu që ne parashtrojmë si vërejtje, ky numër të zvogëlohet dhe të këtë mundësi të hapë mundësi më të mëdha të formimit të shoqatave sindikale.

Njëherësh, ne si Koalicion miratojmë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të SLS, Murselj Haljilji!

MURSELJ HALJILJI: Hvala, predsedavajući!

Uvaženi ministri,

Dame i gospodo poslanici,

Parlamentarna grupa SLS je razmatrala ovaj nacrt zakona. Smatramo da je pozitivan. Naravno, postoje pravopisne slovne greške na verziji na srpskom jeziku i smatram da ćemo i uz neke naše predloge dati da se ovaj nacrt zakona poboljša u radu parlamentarne komisije. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash për Grupin “6+”, a ka? Kush është? Duda Balje!

DUDA BALJE: Zahvaljujem, gospodine predsedavajući!

Nakon razmatranja Nacrta zakona o sindikalnom organizovanju i činjenice da sloboda na sindikalnu organizaciju je jedna od osnovnih prava radnika, kao i zaštite ekonomskih, socijalnih i profesionalnih interesa rada i radnog odnosa, Parlamentarna grupa “6+” podržava zakon u načelu jer ga smatra krajnje potrebnim i korisnim. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! S'ka më, grupet i dhanë deklaratat rreth ligjit, në parim. Fjalën e merr deputetja Lumnije Morina.

LUMNIJE MORINA: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Dua të shpreh edhe unë mendimin tim lidhur me Projektligjin për organizimin sindikal të Kosovës, i cili sot na është ofruar për shqyrtim. Mendoj se ky projektligj e pasuron infrastrukturën ligjore të Kosovës dhe konsideroj se ka qenë nevojë për ta rregulluar dhe përcaktuar të drejtat dhe liritë e punëtorëve.

Me këtë ligj do të rregullohen të drejtat për anëtarësim në organizatat sindikale, themelimi i këtyre organizatave, krijimi i kushteve për veprim, anëtarësimi në sindikatë, zgjedhjet në sindikatë e tjera. Pasi që sindikata është një organizatë e pavarur nga Qeveria, nga partitë politike dhe nga punëdhënësi, atëherë konsideroj se neni 10, pra është fjala për zgjedhjet në sindikatë, duhet të precizohet më mirë se kush duhet të ketë të drejtë të zgjedhet dhe kush nuk ka të drejtë të zgjedhet në sindikatë.

Propozoj që neni 10, paragrafi 1, ku thuhet se, po citoj: “Të gjithë anëtarët e sindikatës kanë të drejtë të jenë zgjedhës dhe të zgjedhur, përveç anëtarëve të cilët ushtrojnë pozita menaxheriale ose poste vendimmarrëse partiake”, t'i shtohet edhe ky tekst për sqarim e precizim më të plotë. Domethënë, dhe “organet legjislative, ekzekutive në të gjitha nivelet e pushtetit!.

Mendoj se nuk ka kuptim që për personat në pozita menaxhuese dhe pozita vendimmarrëse partiake të ndalohet me ligj pjesëmarrja në organet e sindikatave, ndërsa për personat në legjislativ dhe ekzekutiv në të gjitha nivelet e pushtetit të mos precizohet pozita e tyre në kuadër të sindikatave. Po flas prej përvojës, sepse në nivelin lokal ka pasur ndeshje të këtyre pozitave me sindikatën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Diskutuesi i fundit është deputeti Visar Ymeri. Dhe, kthehuni në banka, për votime!

VISAR YMERY: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Desha vetëm shkurtimisht të ndalem në tri çështje për sa i përket këtij ligji, të cilat u përmendën në një farë forme apo tjetër nga parafolësit.

Çështja e parë, ka të bëjë me konventat ndërkombëtare. Unë konsideroj se ky ligj është tejet i rëndësishëm dhe natyrisht që kishte për të qenë mirë që të merren ose t'i marrë parasysh edhe përvojat e vendeve tjera, veçanërisht ato parimet e vendeve tjera, parimet ndërkombëtare të cilat e rregullojnë këtë të drejtë shumë të rëndësishme për organizimin e punëtorëve dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Nuk mendoj se mjafton të thuhet vetëm se do t'i marrë ky ligj parasysh konventat ndërkombëtare, mirëpo konsideroj që duhet të specifikohen ato, e veçanërisht të specifikohet një konventë, e cila fatkeqësisht nuk figuron as në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e ajo është Konventa

Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, konventë kjo e cila është më e rëndësishmja për sa i përket këtyre fushave dhe është më e rëndësishmja në të drejtat që iu jep punëtorëve gjithandej nëpër botë.

Çështja e dytë, ka të bëjë me sanksione që parashihen ose fatkeqësisht nuk parashihen në këtë ligj. Për shembull, te neni 24, thuhet që ndalohet ndërhyrja, pra ndalohet çdo akt ndërhyrjeje në krijimin e programeve sindikale dhe ka pastaj ndalesa të ndryshme për sa i përket ndërhyrjes në sindikata, mirëpo në asnjë nen në këtë ligj nuk precizohet se në çfarë mënyre do të intervenohet kundër këtyre ndalesave. Pra, në njëfarë mënyre ky na lë të kuptojmë që vetëm ndalohet me ligj dhe rrjedhimisht krejt çka munden organet e drejtësisë të thonë në këtë rast është që nuk bën të ndërhyhet, mirëpo nuk ka kurrfarë neni apo klauzole sanksionuese ndaj atyre që ndërhyjnë në këto çështje.

Për sa i përket nenit 25, këtu u përmend, do të thotë, e përmendi edhe deputetja Aurora Bakalli se ky duhet të hiqet fare dhe desha të ngrejë çështjen për sa i përket një anomalie që paraqitet në vet këtë nen. Pra, ne po flasim këtu për Ligjin i cili u garanton punëtorëve të drejtën për t'u angazhuar në sindikatë dhe pastaj neni 25 pika 1 thotë – Qeveria e Kosovës garanton të drejtën për organizim dhe veprim të lirshëm sindikal. Edhe Qeveria e Kosovës dhe secili punëdhënës tjetër këtu përbrenda dhe secili institucion përbrenda Kosovës duhet t'i nënshtrohet këtij ligji, pra nuk ka nevojë që të përsëritet një gjë që tashmë po dihet me ligj.

Te neni 27, te presioni sindikal, konsideroj se është e rëndësishme, përveç asaj që u përmend, do të thotë që të specifikohen dhe të përmenden në mënyrë eksplicite ato të drejtat të cilat i kanë punëtorët për ta organizuar apo ushtruar presionin sindikal, konsideroj që është pak problematik edhe ky përdorimi i fjalës “dhunë” këtu për shkak se vetë koncepti “dhunë” kërkon shumë për t'u definuar dhe rrjedhimisht nën formën siç është përdorur këtu konsideroj që mund të keqpërdoret, do të thotë, nga interpretuesit e ligjit, se për shembull thotë që “ndalohet përdorimi i dhunës dhe marrja e masave ndëshkuese gjatë organizimit të formave të presionit sindikal”, mirëpo nëse e pyet punëdhënësin, edhe greva është dhunë. Pra, nëse e pyet punëdhënësin, çfarëdo forme e organizimit sindikal për interesat e punëtorëve që doemos shkojnë në kundërshtim me interesat e tij, ai atë do ta konsideronte si dhunë ndaj pronës së vet dhe dhunë ndaj personit të vet. Prandaj, konsideroj se kërkohet nga komisioni funksional që të punojë pak më shumë në këtë dhe disa gjëra t'i bëjë më eksplicite, në mënyrë që punëtorët ta kenë të qartë se çfarë të drejta gëzojnë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Nuk ka të tjerë që duan të flasin. Tash bëhemi gati që ta votojmë, në parim, Projektligjin për organizimin sindikal në Kosovë. Teknika është gati, ju lutem, votojmë tash:

Në sallë janë 63 deputetë, 61 kanë votuar “për”, 2 “kundër” – miratohet në parim Projektligji për organizimin sindikal në Kosovë.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë tutje. Pika e tetë është Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga zjarri, po unë nuk po e shoh zëvendëskryeministrin këtu. Propozoj që të kalojmë në pikën tjetër, pikën nëntë:

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim

Ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti ministër, urdhëro!

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuari, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë që sot do të paraqes Projektligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim.

Vlerësojmë lartë kontributin tuaj që në procesin e diskutimit dhe të miratimit të këtij projektligji të kontribuoni në përmirësimin e mëtutjeshëm të projektit të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, i cili është i sponsorizuar nga Ministria e Financave.

Hartimi dhe miratimi i Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim përbën një hallkë të rëndësishme në vazhden e reformave institucionale që po ndjek dhe zhvillon Qeveria e Republikës së Kosovës në kuadrin e hapjes dhe zbatimit strategjik të marrëveshjeve për integrim evropian, me qëllim të institucionalizimit, rregullimit dhe standardizimit të auditimit ligjor, të llogarive të shoqërive tregtare, por edhe rregullimet e nevojshme ligjore për organizimin dhe mbikëqyrjen publike të profesioneve të audituesve dhe kontabilistëve, si profesione publike me interes në radhë të parë publik, por edhe për kompanitë e biznesit.

Këto rregullime bëhen akoma më të domosdoshme si për kushtet aktuale të ekonomisë globale, ashtu edhe për shkak të një boshllëku ligjor, në të cilin gjendemi pas miratimit të Ligjit për shoqëritë tregtare.

Kjo fushë ka qenë dhe ende është e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/30 për themelimin e Bordit të raportimit financiar të Kosovës, si dhe të regjimit të raportimit financiar të organizatave afariste, rregullore e cila do të fuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Në hartimin e këtij projektligji, janë marrë parasysh rekomandimet e Bashkimit Evropian, Direktiva e Tetë, progresi i raportit të Komisionit Evropian, standardet ndërkombëtare të auditimit, standardet ndërkombëtare të kontabilitetit e të raportimit

financiar, përvojat e deritanishme të organizimit të profesionistëve, të ekspertëve kontabël e të kontabilistëve të miratuar.

Rregullimi ligjor i kësaj fushe dhe publikimi i pasqyrave financiare të kompanive, është në radhë të parë në interes të vetë drejtuesve dhe pronarëve të tyre, për marrjen e vendimeve të drejta, për zhvillimin e kompanisë, për mënyrën e investimeve të burimeve, për politikat kredimarrëse, për orientimet në treg. Por, pasqyrat financiare transparente të standardizuara janë të domosdoshme edhe për interesat e tjera publike, si për mbrojtjen e kreditorëve, për uljen e informalitetit në ekonomi, për shmangien e invazionit fiskal, për krijimin e kushteve për një konkurrencë të ndershme. Besoj se një rol të rëndësishëm për hartimin dhe për publikimin e pasqyrave financiare korrekte e transparente kanë profesionistë kontabël që angazhohen në mbajtjen e kontabilitetit e përgatitjen e pasqyrave financiare dhe ekspertë kontabël të cilët kanë mision publik për verifikim ligjor të këtyre pasqyrave.

Duke pasur parasysh rolin e ekspertëve të kontabilistëve të miratuar dhe rëndësinë dhe domosdoshmërinë e auditimit ligjor të llogarive e të shërbimit kontabël në shoqëritë tregtare, për të cilët kam bindje se ju e keni në konsideratë këtë, duhet të ndalem në disa momente kryesore që bëjnë të domosdoshme rregullimin ligjor dhe përshkojnë frymën e këtij projektligji si: kontabiliteti, sistemi i raportimit financiar, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit Kosovar për Raportime Financiare, ndalimin e konfliktit të interesave, ndalimin e keqpërdorimit të informatave, përgatitjen e pasqyrave financiare, procedurën e auditimit, kualifikimet e kërkuara për kontabilistë të certifikuar si dhe licencimin e auditorëve.

Ekonomia e Kosovës, ka arritje dhe ka bërë progres viteve të fundit dhe kjo në rend të parë si rezultat i politikave adekuate ekonomike, krijimit të ambientit të përshtatshëm për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe ndërtimit të kapaciteteve njerëzore dhe institucionale.

Një nga barrierat kryesore në çdo vend, por në vendin tonë drejt tërheqjes së investimeve të huaja, padyshim është edhe mungesa e një sistemi të sigurt të raportimit financiar dhe strukturave të besueshme rregullative. Synojmë që përmes një sistemi të mirëfilltë të raportimit financiar, bashkërisht me një sistem të fuqishëm dhe efikas të tatimeve, si dhe një strukturë të ligjit për shoqëri tregtare, të fuqizojmë Kosovën si një vend të favorshëm për të bërë biznes. Kështu do të bëjmë edhe një hap para në drejtim të tërheqjes më të madhe të investimeve të huaja si një nga parakushtet esenciale të zhvillimit më të hovshëm ekonomik.

I nderuar zoti kryesues,
Kabinet qeveritar,
Deputetë të nderuar,

Unë jam i bindur dhe besoj se me kontributin tuaj, ky projekt mund të përmirësohet edhe më tej. Duke ju falënderuar edhe një herë për vëmendjen tuaj, në këtë seancë mirëpres se çdo koment, vërejtje apo sugjerim dhe siguroj se Ministria e Financave, Qeveria do t'i japë mbështetje çdo iniciative për zhvillimin e kësaj baze ligjore.

KRYESUESI: Zoti ministër, ju faleminderit!

Fillojmë diskutimin e projektligjit, në parim.

Fjalën e merr kryetarja e Komisionit funksional për Buxhet, Financa, deputetja Safete Hadergjona.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për kontabilitet, raportin financiar dhe auditim sipas Rregullores së punës dhe ka përcaktuar grupin punues që do të punojë në këtë projektligj, në mënyrë që ky projektligj të përmirësohet. Komisioni është i mendimit se projektligji i paraqitur nga Qeveria, edhe përkundër përmirësimeve të theksuara që ka në krahasim me versionet e mëparshme që i kemi pasur në Kuvend, në mandatin e kaluar dhe që nuk janë miratuar, ai prapëseprapë ka nevojë të përpunohet dhe të amendamentohet. Komisioni për Buxhet dhe Financa do të punojë që versioni përfundimtar për miratim në Kuvend, të jetë më i kompletuar dhe më gjithëpërfshirës se prapë kanë mbetur pa u përfshirë një mori vërejtjesh që kanë qenë në draftin e parë të cilin nuk e ka miratuar Kuvendi.

Në projektligj duhet rregulluar disa çështje me rëndësi siç janë: përcaktimi më i qartë i detyrimeve për raportin financiar, mënyra e ngritjes profesionale për kontabilistë dhe auditorë, mënyra e licencimit të kontabilistëve dhe auditorëve. Duhet të përcaktohen më qartë kushtet që duhet të plotësohen për ushtrimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit, kushtet për themelimin e organizatave biznesore të kontabilitetit dhe auditimit si dhe mënyra dhe kushtet për themelim apo licencim të shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit.

Duhet të përcaktohet se kush duhet t'i nënshtrohet auditimit dhe raportimit financiar pranë Këshillit të raportimit, prandaj në këtë drejtim, ne duhet të thirrëmi tek shumë etnitete që duhet të raportojnë, te disa ligje tjera që kanë nevojë të përmirësohen, sidomos në përcaktimin e këtyre njësive ekonomike. Ligjit për kontabilitet dhe raportim financiar, duhet t'i nënshtrohen të gjitha njësitë ekonomike fitimprurëse. Mënyra si është definuar në nenin 3, shumë njësi ekonomike na mbesin jashtë përmbushjes së detyrimit ligjor të raportimit dhe të auditimit. Për shembull, në neni 3, është e përcaktuar se shoqëritë tregtare duhet të raportojnë dhe duhet të auditohen. Me këtë ligj që është në fuqi, nocioni shoqëri tregtare i len shumë njësi jashtë mënyrës së raportimit dhe të auditimit, prandaj ne duhet të punojmë ngushtë me Komisionin për Zhvillim Ekonomik, për Infrastrukturë dhe Tregti e Industri, që vërtet ta përmirësojmë Ligjin për shoqërinë tregtare i cili është në procedurë apo të bëjmë harmonizimin në mes të këtyre ligjeve dhe ligjit i cili është në përpunim e sipër.

Aktualisht kjo fushë është rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut, 2001/30, kështu që Projektligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, është i harmonizuar me direktivat dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian. Miratimi i projektligjit nuk ka

implikime buxhetore, pasi që rregullorja në fuqi e parasheh mekanizmin përcjellës për zbatimin e këtij ligji.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, së bashku me Ministrinë e Financave, Zyrën ligjore të kësaj ministrie dhe të gjithë aktorët që shprehin interes për këtë projektligj do të bashkëpunojë për amendamentim sa më të shpejtë dhe t'i sjellë në Kuvend amendamentet e këtij projektligji.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka miratuar projektligjin dhe ka rekomanduar që Kuvendi ta miratojë. Prandaj ftoj të gjithë deputetët që ta votojnë në parim Projektligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!
Për Grupin e PDK-së, Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin, rregullon sistemin e kontabilitetit, raportimin financiar të shoqërive tregtare, kërkesat për auditim, kualifikimet për kontabilistë të certifikuar, licencimin e auditorëve dhe firmave vendore dhe të huaja të auditim. Po ashtu ky projektligj rregullon kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit Kosovar për Raportim Financiar.

Ky këshill i propozuar në këtë projektligj, është autoritet rregullativ i pavarur dhe duhet të jetë përgjegjës për nxjerrjen e standardeve të kontabilitetit, auditimit dhe raportimit financiar, të rregullojë arsimimin dhe trajnimin e kontabilistëve profesional dhe auditorëve ligjor, t'i mbikëqyrë shoqatat profesionale të kontabilitetit si dhe të monitorojë dhe të sigurojë përputhshmëri me kërkesa ligjore nga të gjithë pjesëmarrësit në sistemin e raportimit financiar.

Projektligji i është i harmonizuar në direktivat dhe legjislacionin të Bashkimit Evropian në këtë fushë. Hartimi i këtij projektligji ka qenë më se i domosdoshëm për faktin se kjo fushë shumë e rëndësishme, aktualisht është e rregulluar me Rregulluar 2001/30, rregullore që ka hyrë në fuqi në vitin 2001. Vërejtjet dhe sugjerimet rreth këtij projektligji do t'i adresojmë në Komisionin funksional përkatës dhe unë si pjesë e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, do ta japim kontributin tonë në vërejtjet dhe sugjerimet. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, mbështet këtë projektligj dhe njëkohësisht kërkon edhe nga kolegët tjerë deputetë që ta mbështesin projektligjin në fjalë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Fjalën për Grupin Parlamentar Lidhjen Demokratike, e merr deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit shumë, profesor!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, natyrisht që e ka shqyrtuar këtë projektligj, duke marrë parasysh se kjo fushë akoma ka qenë e rregulluar me Rregullore të UNMIK-ut. Ne shprehim pakënaqësinë tonë për shkak që ligjet të cilat, vijnë sidomos që kemi të bëjmë në fushën e kontabilitetit apo raportimet, duhet të kenë një harmoni më të madhe në ligjet tjera, siç është ligji për shembull për shoqëri tregtare, i cili ka ardhur para pak kohësh dhe ne kemi vërejtur këtu që ka mospërputhje e sidomos në fushën e raportimit.

Ajo çka unë dua të them dhe e përmbylli dhe i propozoj Qeverisë që mund ta formojë edhe një ministri të kontabilitetit edhe një zëvendësministër për kontabilitet dhe auditim dhe kështu plotësohet kjo fushë dhe besoj që kontributi më i madh, atëherë do të jetë edhe i deputetëve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Qoftë me humor, na more në qafë me këto tri propozime. Fjalën e merr për Grupin e Vetëvendosjes, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: I nderuari kryesues,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, synon të rregullojë çështjet që kanë të bëjnë me kontabilitetin, procedurat e raportimit financimi, auditimin si dhe çështjet tjera që ndërlidhen me ecurinë financiare të shoqërive tregtare në Republikën e Kosovës. Po ashtu me këtë ligj parashihet të themelohet edhe Këshilli kosovar për raportim financiar si një autoritet i pavarur rregullativ i cili do të mbikëqyrë të gjithë pjesëmarrësit në kuadër të sistemit për raportim financiar si dhe do të mbikëqyrte zbatimin e ligjit.

Ne e kemi vlerësuar këtë ligj me kujdes dhe e mbështesim në parim, mirëpo i kemi disa vërejtje për disa nene të caktuara, a të cilat kërkojnë që edhe të shqyrtohen dhe pastaj përmes Komisionit Funkcional edhe të ndryshohen po të riformulohen.

Duke pasur parasysh rëndësinë e zbatimit të këtij ligji, për klimën biznesore në Republikën e Kosovës, si dhe në anën tjetër faktin se Këshilli i raporton Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe se në projektligj nuk është fare nuk është shtjelluar matja e performancës së këshillit, mendojmë se është vënë në pikëpyetje pavarësia e këtij këshilli. Përveç të këtyre çështjeve të përgjithshme, janë edhe disa specifike që kanë tërhequr vëmendjen tonë. Për shembull, në kreun II, neni 3, pika 2, thuhet: “Shoqëritë tregtare që kryejnë aktivitetin e tyre me mjete shoqërore apo publike, do të përgatisim pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme në pajtim me këtë ligj” Mënyra se si është përpiluar ky nen, duket sikur kemi të bëjmë vetëm me ndërmarrjet publike ose shoqërore dhe fare nuk përmenden organizatat biznesore të themeluara me kapital aksionar apo vetanak, pra siç e parasheh edhe Ligji për shoqëri tregtare i cili do t’i kthehet këtij Kuvendi.

Te kreu II, neni 11, nen ky i cili rregullon çështjen e përbërjes, dorëzimit dhe publikimit, pasqyrave financiare të shoqërive tregtare KKRF dhe MTI, ndër të tjera në këtë nen thuhet: “Pasqyrat financiare të shoqërive tregtare auditohen në pajtim me SNA, dorëzohen dhe publikohen në KKRF dhe një kopje dorëzohet në MTI, jo më vonë se 30 prilli i vitit vijues për vitin e kaluar” Ky nen duhet riformuluar në mënyrë që të ndajë përgjegjësinë e shoqërisë tregtare, e që është angazhimi i kompanisë për auditim dhe auditimin e pasqyrave apo raporteve financiare, si dhe dorëzimi i tyre në KKRF dhe MTI, ndërkohë që përgjegjësia për bërjen publike të pasqyrave është e KKRF-së, dhe për këtë duhet të caktohet një afat ligjor. Në këtë mënyrë, publikut dhe palëve të interesuara do t’ju bëhej me dije se në cilën periudhë kohore do të mund t’ju qaseshin informatave për sa u përket pasqyrave dhe raporteve financiare të ndërmarrjeve.

Kreu III, neni 14, i cili i rregullon çështjet e funksioneve dhe përgjegjësi të KKRF-së, në përgjithësi ky nen i përmbledh mjaft mirë përgjegjësitë e KKRF-së, për sa i përket standardeve të kontabilitetit të kontabilitetit të Kosovës, standardeve të auditimit dhe të atyre të edukimit profesional. Por, në këtë nen, nuk është përfshirë fare çështja e udhëzimeve për shoqëri tregtare sa i përket zbatimit të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit ose apo standardeve ndërkombëtare për raportim financiar.

Nëse pika 3 dhe 4 të nenit 17 do të kalonin në nenin 14, atëherë do të ishte një pasqyrë më e qartë e funksioneve dhe e përgjegjësi të KKRF-së dhe vërejtja e fundit te kreu III, neni 17, pika 3, 4, 5 dhe 6, neni 17 në përgjithësi e rregullon çështjen e raportimit të KKRF-së pranë Qeverisë, ndërsa nenet 3, 4, 5 dhe 6, më tepër kanë të bëjnë me funksionet dhe përgjegjësitë e KKRF-së, të cilat janë të përfshira në nenin 14. Prandaj, rekomandojmë që të riformulohet neni 17, në mënyrë që të reflektojë vetëm obligimet për raportim ndaj Qeverisë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Për Grupin Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, flet deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Grupi Kuvendor i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, në parim përkrah këtë projektligj i cili është mjaft me rëndësi dhe u theksua edhe nga vetë ministri i Financave edhe pse ky projektligj edhe në mandatin e kaluar është shqyrtuar dhe ka pasur të metat e shumta, prapë ka të meta dhe e përkrahim mendimin edhe të kryetares së Komisionit për Buxhet dhe zotit Visar Ymeri, që ato vërejtje duhet që të inkorporohen në këtë ligj dhe shpresoj se Grupi punues dhe deputetët e Aleancës do ta japin kontributin e tyre në Komisionin funksional dhe në komisionet e përhershme që ky ligj të jetë i zbatueshëm në Republikën e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Për Koalicionin Kosova e Re, e paraqet qëndrimin deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re, e mbështet në parim, përkatësisht në lexim të parë tekstin e këtij projektligji edhe gjithashtu thekson se duhet të merren masa që teksti në punën e mëtejme të përmirësohet, të jetë më i qartë për arsye se ky ligj ka një rëndësi shumë të madhe për përparimin e raportimit financiar dhe zhvillimin e kulturës së raportimit financiar, i cili përbën një nga problemet e mëdha që ndikon në një informalitet të lartë të ekonomisë në Kosovë dhe gjithashtu në rritjen e riskut në biznes.

Ajo që duket se është një problem kryesor këtu është, qartësia e këtij ligjit lidhur me obligimet për raportim financiar, domethënë nuk është shumë qartë e definuar dhe dy duket se ky ligj instalon një administrim të tepërt dhe një burokraci dhe duhet të shihet se sa është e nevojshme kjo shkallë e burokracisë dhe administrimit, për arsye se unë nuk jam i sigurt se nuk ka implikime buxhetore. Implikime buxhetore ka gjithsesi, por ndoshta edhe tash janë ato implikime por, sa po shoh unë këtë administrim, mund të ndodhë që ato implikime buxhetore të rriten në një të ardhme, por duhet të shihet, duhet të shihet domethënë me kujdes. Problemi edhe me këtë projektligj është: teksti, gjuha. Unë kisha propozuar meqë, edhe pse kjo ka të bëjë me të gjitha ligjet që gjithsesi para se ligji të dërgohen në Kuvend, të kalojnë në një reaktorë nga një lektor profesional, domethënë një redaktor që e kupton fushën për të cilën nxirret ligji dhe një lektor gjuhësor. Përndryshe nuk është mirë që Kuvendi ynë t'i kalojë ligjet të cilat kanë probleme të tilla gjuhësore ose probleme të kuptimit të tekstit dhe përmbajtjes së tyre. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoteni deputet! Për Grupin Parlamentar SLS, deputeti Mursel Halili.

MURSELJ HALJILJI: Zahvaljujem, gospodine predsjedavajući!

Uvaženi ministri,

Dame i gospodo poslanici,

Parlamentarna grupa SLS će podržati ovaj Nacrt zakon u načelu, s tim da se slažemo sa prethodnim govornicima koji su istakli neke primedbe sa kojima se slažemo, naročito pitanje usklađenosti sa nekim drugim zakonima i nacrtima zakona iz ove oblasti. Naravno, pitanje koje je veoma bitno, to su odredbe vezane za preciznost oko načina, vremena izveštavanja, jer to može dovesti do nejasnoće koje opet mogu dovesti do nesprovođenja zakona, odnosno kaznenih mera.

Mi smatramo da obzirom da je u toku i Nacrt zakona o trgovačkim društvima, da član 4. koji ovde egzistira bi trebalo da se izbriše zato što se ponavlja ista materija, jer kao što znate, u Nacrtu zakona o trgovačkim društvima postoji odrednica koja kvalifikuje poslovne organizacije, odnosno privredne subjekte, pa se to isto ponavlja u članu 4. Naš predlog je da se taj član 4. izbriše, jer takve odredbe već imamo i imaćemo u Zakonu o trgovačkim društvima. Ponavljam, mi ćemo u načelu podržati ovaj nacrt zakona. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Për Grupin parlamentar “6+”, Duda Bale!

DUDA BALJE: Zahvaljujem, predsedavajući!

Nakon razmatranja Nacrta zakona o računovodstvu, finansijskom izveštavanju i reviziji, Parlamentarna grupa „6+“ donela je odluku da podrži Zakon u načelu, jer na adekvatan način cilja da reguliše pitanje iz oblasti računovodstva, procedura finansijskog izveštavanja, revizije i drugih pitanja bitnih za trgovačka društva. Smatramo za vrlo korisnim inicijativu za formiranje kosovskog Saveta za finansijsko izveštavanje, kao nezavisni regulativni organ za nadgledanje svih učesnika u sistemu finansijskog izveštavanja. Uz korekciju evidentnih anomalija, Nacrt zakona će biti od velike koristi za našu državu. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Tani fjalën e ka deputeti Lutfi Zharku!

LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të mundohem vetëm shkurt, nga ana profesionale duke marrë parasysh të kaluarën time në Bord dhe duke marrë parasysh natyrisht që ministri nga ana profesionale i di këto punë jashtëzakonisht mirë.

Po filloj së pari me raportimin vjetor apo opinionin e auditorit. Në ligj jepet që auditori duhet të jetë një opinion mbi zhvillimet dhe performancën e biznesit, analizën financiare dhe indikatorët kyç jo financiar, zhvillimet e parashikueshme, aktivitetet, hulumtimet dhe zhvillimet e tjera. Mendimi i jem personal është, që një opinion i tillë i auditorit nuk ka nevojë. Ne nisemi nga përvoja e kaluar që edhe kompanitë ndërkombëtare shumë të njohura, kanë pasur raporte të auditimit jashtëzakonisht të mëdha, por në moment të caktuar kanë falimentuar, kështu që nuk di sa është ajo e nevojshme të jetë së paku për nivelin tonë, për zhvillimin tonë të ekonomisë.

Te inventarizimi apo regjistrimi që bëhet në çdo ndërmarrje në fund të vitit, po më duket se është një gafë, është një lëshim teknik, përndryshe rregullisht bëhet regjistrimi i mjeteve themelore, obligimeve, tash detyrimeve që po ju thuhet dhe kapitalit, por po mungojnë kërkesat. Dihet se borxhet e këqija janë një ndër elementet që e rëndojnë ekonominë tonë nga ana financiare, po flasim pasqyrat financiare, janë kategori që duhet paraqitur për shkak që ndikojnë drejtpërdrejtë në përcaktimin e fitimit. Sa i përket përbërjes së Këshillit kosovar për raportimet financiare, e kam një përshtypje që nganjëherë po e monopolizojmë Odën Ekonomike të Kosovës, si përfaqësues ekskluziv i biznesit. Qëndrimi im është që aty duhet të jetë nga biznesi, nga shoqatat e biznesit. Ne aktualisht i kemi tri shoqata të biznesit, e kemi edhe Aleancën Kosovare të Biznesit edhe Odën Ekonomike Amerikane, kështu që do të ishte mirë ata tre përfaqësuesit të jenë nga shoqatat e biznesit.

E njëjta të them vërejtje shkon për sekretarinë administrative sikurse që e patëm edhe për Këshillin ekonomik social. Edhe këto te sekretaria administrative, nuk është e qartë ajo sekretaria a kemi të bëjmë me shërbyes civil, a kemi të bëjmë me të punësuar, se thjeshtë, nëse kryetari i Këshillit ka të drejtë ta zgjedhë dhe ta shkarkojë, nga ana ime

nuk është, së paku bindja ime është, që nuk është ajo e drejtë. Ata janë punëtorë dhe nuk duhet të jetë emërimi apo shkarkimi i tyre kompetencë e drejtpërdrejtë e kryetarit të Këshillit, por ata të punësohen në mënyrë profesionale në bazë të konkurseve.

Te kontabilistët e certifikuar apo auditorët, thuhet se një auditor, apo mund ta mbajë titullin auditori i certifikuar apo kontabilist i certifikuar vetëm nëse është anëtar i rregullt i një shoqate të kontabilitetit dhe auditimi. Unë nuk e kam të qartë a është anëtarësimi i një kontabilisti apo auditori obligativ në shoqata të auditorëve dhe kontabilistëve të certifikuar apo është çështje vullnetare? Mendimi im personal është që ajo duhet të jetë çështje vullnetare e jo obligative.

Te shoqatat profesionale të kontabilitetit dhe auditimit, kusht për t'u licencuar nga ana e Këshillit kosovar për raportim financiar, është që ato të jenë anëtarë në Shoqatën ndërkombëtare para se të licencohen. Ndoshta e kam gabim, veç nuk mund dikush të jetë anëtar i një shoqate ndërkombëtare të anëtarësohet para se të jetë i licencuar si shoqatë e auditorëve apo kontabilistëve në vendin tonë. Kështu që duhet të jetë e kundërta, ata duhet së pari të licencohen nga ana e Këshillit kosovar, e tek pastaj ata të kërkojnë njohje, pranim ndërkombëtar në ndonjë shoqatë tjetër.

Në nenin 24.3, prapë mendoj se ndoshta është një lëshim. Nuk thuhet në mënyrë decisive Bordi për standarde dhe raportim financiar që është i tashëm, në mënyrë automatike a bartet, a shndërrohet në këshill për raportim financiar se një pasuri e tjera barten, por anëtarët, po më duket se kanë metë pezull ajo çështje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Unë shoh që të gjitha grupet e mbështesin në parim ligjin. Diskutues të tjerë nuk ka. Përfaqësuesi i Qeverisë, nuk e do fjalën. Ju lutem, bëhuni gati ta votojmë ligjin.

Votojmë, tash.

Në sallë janë 64 deputetë, 59 votojnë “për”, 4 “kundër” 1 abstenim. Miratohet Projektligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim.

Kërkohej nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregullore të Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Tash i kthehemi pikës së përparme:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga zjarri

Lus ministrin Hamza, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputet,

Më lejon të prezantoj para jush Projektligjin për mbrojtjen nga zjarri, i sponzoruar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligji për mbrojtjen nga zjarri është hartuar duke u bazuar në strategjinë legislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2011, dhe në pajtim të plotë me Rregulloren e punës së Qeverisë, numër 01/2007. Qëllimi i Projektligjit për mbrojtjen nga zjarri, është përcaktimi i mekanizmave mbrojtës për parandalimin e shkaqeve dhe përhapjes së zjarrit, duke përfshirë edhe shpërthimet me qëllim të mbrojtjes së njerëzve pasurisë dhe mjedisit. Ky projektligj shfuqizon Ligjin nr. 02/L-41 për mbrojtjen nga zjarri, i cili është i miratuar në Kuvendin e Kosovës, me 6 prill 2006.

Arsyeja për hartimin e këtij projektligji qëndron në faktin se me ligjin ekzistues është mbuluar edhe fusha e zjarrfikjes dhe shpëtimit, kurse tani me këtë projektligj zjarrfikja dhe shpëtimi trajtohen, por kjo veprimtari do të rregullohet me ligj të veçantë. Gjithashtu projektligji synon edhe avancimin e mbrojtjes dhe parandalimit të shkaqeve dhe përhapjes së zjarrit me trendët më të reja në këtë fushë. Projektligji për mbrojtjen nga zjarri është harmonizuar me Kushtetutën dhe instrumentet ligjore të cilat janë pjesë direkte e zbatimit në Republikën e Kosovës, andaj ndryshimet dhe plotësimet në këtë ligj, u janë përshtatur rrethanave të reja të krijuara në Republikën e Kosovës.

Gjatë hartimit dhe finalizimit të këtij projektligji, janë marrë parasysh edhe eliminimi i të gjitha barrierave të panevojshme administrative, me qëllim të krijimit të mjedisit të favorshëm afarist për bizneset në Republikën e Kosovës. Ky projektligj përmban 8 krerë dhe gjithsej 41 nene, duke filluar nga dispozitat e përgjithshme, dispozitat shpjeguese, dispozitat përcjellëse dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare. Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, nevojën e avancimit të kuadrit ligjor si dhe duke i marr parasysh prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kërkoj nga ju miratimin në parim të këtij projektligji. Ju faleminderit për vëmendjen tuaj.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Tash, në emër të komisionit funksional nuk do të paraqitet askush, sepse ky komision ndodhet në një vizitë zyrtare jashtë vendit, mirëpo kemi rekomandimin me shkrim për Kuvendin të Komisionit, i cili rekomandon miratimin e këtij ligji. Atëherë edhe më mirë, Ibrahim Makolli do të flasë në emër të Komisionit. Urdhëro, zoti deputet!

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me 6 maj 2011, shqyrtoi në parim Projektligjin për mbrojtjen nga zjarri dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji për mbrojtjen nga zjarri.

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional, para shqyrtimit të parë të Projektligjit për mbrojtje nga zjarri, në mbledhjen plenare, e shqyrtoi këtë projektligj dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime për miratim në parim.

Komisioni pas shqyrtimit në parim të projektligjit në fjalë, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

Edhe në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, e përkrahim projektligjin në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Problemi është që këtu thotë do të raportojë Ahmet Isufi, masandej në kllapa është se nuk janë këtu hiq. Me rëndësi është që vendimi është marrë dhe proceduralisht kjo është më e rëndësishmja. Pra, do të marrin fjalën përfaqësuesit e grupeve parlamentare ose shefat, sido që të donë ata.

Për Partinë Demokratike, deputeti Fadil Demaku.

FADIL DEMAKU: Ju faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i partisë Demokratike ka analizuar këtë projektligj, ka dhënë vërejtjet dhe sugjerimet përmes anëtarëve të vet në Komisionin përkatës dhe e përkrah miratimin në parim të këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Për Lidhjen Demokratike, gjegjësisht grupin e saj parlamentar, Vjollca Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: I nderuari kryesues,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen nga zjarri dhe gjatë shqyrtimit kemi hasur në nene ku i kemi vërejtjet tona.

Me anë të projektligjit, Qeveria si dhe në disa ligje të tjera, bën centralizimin e shërbimeve, gjë që ne po thirremi vazhdimisht në të kundërtën apo në decentralizim, gjë që është në kundërshtim me Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale dhe ligjet për vetëqeverisje lokale.

Është një projektligj shumë konfuz, jo i qartë që të lë mundësi interpretimesh të ndryshme, ashtu siç konvenon në rastet e caktuara. Me këtë projektligj, reduktohen apo hiqen në tërësi kompetencat e komunave, duke u fokusuar i tërë ky shërbim në nivel qendror. Një prej shembujve të tillë, është dhënia e pëlqimit për elaborate për mbrojtjen

nga zjarri, për objektet që ndërtohen në komuna, përkatësisht kontrolli ligjor, sipas projektligjit, bëhet nga agjencioni në fjalë dhe jo nga stafi komunal për parandalimin dhe hulumtimin nga zjarri.

A tha komunat nuk kanë stafe profesionale, të gatshme për të bërë një gjë të tillë? Ne, si grup parlamentar, jemi kundër zhveshjes së komunave nga ushtrimi i kompetencave për t'i ushtruar agjencioni. Gjithashtu ky agjencion dhe vetë themelimi i tij është pa bazë ligjore, me ligjet në fuqi dhe legjitimohet me këtë projektligj. Prandaj, kjo Qeveri ka rënë në këtë nivel që edhe shërbimet e tilla t'i fokusojë për interesa grupore e jo të qytetarëve.

Andaj, e kam dilemën që Qeveria do ta shtojë edhe një ministri të re, atë për mbrojtjen nga zjarri, duke marrë parasysh tërë këto kompetenca të Agjencionit për Menaxhimin e Emergjencave. Bazuar në projektligjet e miratuara, siç ishte ai pak më parë, në pjesën e parë të seancës, ai për bashkëpunim dhe partneritet ndërkomunal, mendojmë që komunave t'u lihet apo t'u mundësohet bashkëpunimi me marrëveshje të ndryshme edhe në sektorin për të cilin po flasim. Andaj ky projektligj është një mesazh i keq dhe rrezikon të shndërrohet në praktikë të keqe. Ne angazhohemi për fuqizimin e komunave, si në fushat e përgjegjësisë dhe autonomisë, që është praktikë e vendeve evropiane, gjegjësisht e institucioneve të zhvilluara që funksionojnë në pajtim me standardet më të larta të qeverisjes. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje", deputeti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Ju faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i lëvizjes "Vetëvendosje", e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në parim e përkrah miratimin e tij. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Bali Muharremaj.

BALI MUHARREMAJ: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni t'ju drejtohem dhe t'ju parashtroj disa çështje të cilat kanë të bëjnë me ligjin e ri për mbrojtjen nga zjarri.

Në fakt, siç e dini edhe ju ky Kuvend, natyrisht në një përbërje tjetër të vitit 2006, ka miratuar Ligjin për mbrojtjen nga zjarri. Atëherë është menduar se dispozitat e atij ligji, kanë rregulluar në mënyrën më të mirë të mundshme çështjet të cilat i takojnë sigurisë së qytetarëve të Republikës së Kosovës. Edhe me të filluar implementimin e tij në praktikë, janë vërejtur mangësi të cilat e shoqërojnë këtë ligj dhe dispozitat e tij, të cilat nuk kanë definuar saktë dhe mjaftueshëm në kuptimin e qëllimit të tyre, gjë që ka shkaktuar konfuzitet në radhët e atyre që janë marrë në zbatimin e këtij ligji.

Mu për këtë ka dalë edhe iniciativa për ndryshimin dhe plotësimin e tij dhe gjatë punës së grupeve të ekspertëve, në bërjen e këtyre ndryshimeve dhe plotësimeve të nevojshme është vërejtur se ka shumë ndryshime për të bërë. Prandaj, me anë të konsensusit, midis grupeve të ekspertëve dhe propozimet e institucioneve relevante, anekënd Kosovës që e mbulojnë këtë fushë, është marrë vendim për hartimin e ligjit të ri për mbrojtjen nga zjarri.

E di shumë mirë, siç e dini edhe ju, natyrisht, që të gjitha vendet e zhvilluara çështjes së mbrojtjes dhe sigurisë i kushtojnë vëmendje të posaçme dhe ju e dini që me këtë ligj rregullohen pikërisht çështjet e mbrojtjes së jetës dhe të mirave materiale të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Më lejoni t'jua përkujtoj fakte të gjendjes aktuale në vend. Jeni dëshmitarë të ekspazionit që po ndodh në aspektin e ndërtimit të objekteve të llojeve të ndryshme. Nganjëherë këto objekte ndërtohen në vend të cilat as minimalisht nuk i plotësojnë kushtet elementare e lere më masat e mbrojtjes të cilat gati edhe nuk aplikohet fare.

Me dispozitat e ligjit ekzistues nuk janë saktësuar aq sa duhet përgjegjësitë, prandaj është menduar që kjo gjë të rregullohet me ligjin e ri, siç thashë edhe më herët. Mirëpo, këtu nuk po shihet ose nuk po shoh çfarë është ndryshuar, çka është plotësuar, çka është rregulluar, cilat nga dispozitat definojnë saktë punët dhe përgjegjësitë për zbatimin e tyre? Mos të flasim për çështje të cilat fare nuk janë definuar apo nuk janë definuar sipas mënyrës e cila garanton rritjen e shkallës së mbrojtjes kur janë në pyetje jeta dhe të mirat materiale të qytetarëve të Kosovës.

Në ligjin e ri me sa kamë vërejtur nuk është thënë asnjë fjalë lidhur me çështjen e formimit të shoqatave vullnetare të zjarrfikësve si dhe në mjediset rurale ashtu edhe në ato urbane, mënyra e financimit të tyre, mbështetja financiare, pajisjet e të tjera.

Me sa kam njohuri gjithkund kësaj çështje i kushtohet vëmendje e posaçme dhe zgjidhje sipas mënyrës e cila garanton dhe ofron mundësi për krijimin e kushteve për siguri më të lartë. Në këtë ligji i cili ndodhet para neve nuk po shoh dispozitën në të cilën saktësohet mënyra e sigurimit të pronave.

A keni pyetur vetveten sa është numri i zjarreve vetëm gjatë një viti, gjatë një sezone verore dhe si ato si në objekte ashtu edhe në sipërfaqe të hapura, sa e sa vlera kombëtare po shkojnë në pa kthim? Pra, duhet të presim që gjërat na ndodhin para syve, te na rrinë duarkryq, të shkojmë apo të veprojmë në mënyrën stihike për zgjidhjet e tyre.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në parim do ta përkrahë këtë ligji, mirëpo besoj që do të ketë ndryshime në plotësimin ose në leximin e dytë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Koalicioni Kosova e Re, Makolli e tha në emër të tyre më herët.

Grupi SLS, Sasha Rashiq.

SAŠ RAŠIĆ: Hvala, poštovani predsjedavajući!

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke razmotrila je Nacrt zakona o zaštiti od požara. Smatramo da ovaj zakon treba da prođe kroz prvo čitanje, s tim što treba određeni nedostaci da se otklone kroz funkcionalne komisije, pa ćemo ga podržati u načelu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupe të tjera nuk ka të paraqitur. Të lutem, e prekni atë farë pulle dhe jepeni emrin, mos të bëjë vaki secilën herë t'ju them kush, cili je ti? Albert Kinolli, në emër të Grupit "6+". Mos pritoni ta prekni atë farë letre!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit!

I nderuari zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar "6+" e ka shqyrtuar në hollësi projektligjin për mbrojtjen nga zjarri dhe pas arsyetimit të rekomandimit nga komisioni përkatës, Grupi Parlamentar "6+" vlerëson se ky projektligj i ka plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme dhe në parim do ta votoj këtë projektligj, ndërsa vërejtjet e veta do t'i paraqet përmes Komisionit funksional për Punë të Brendshme dhe Siguri. Faleminderit!

KRYESUESI: Tash fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përgjithësisht i tha në emër të grupit, Vjollca, deputetja, po vetëm do të doja t'ua tërheq vëmendjen në 2 – 3 çështje, që edhe unë pajtohem në aspektin e kufizimit ose marrjes ose cenimit të autonomisë së veprimit të institucioneve, për mendimin tonë edhe kompetente, edhe legjitime, komunave.

Neni 5, tek përgjegjësitë e komunave vetëm shikojeni se çfarë përgjegjësish kanë komunat asfare, faktikisht është një përshkrim në tri pika, shumë gjenerale që realisht komuna i zhvesh të qenit përgjegjës, por edhe kompetent për këtë çështje të rëndësishme.

Po ashtu, neni 13, për shembull te çështja që ka të bëjë me kushtin për dhënien e lejes për ndërtim. Atje duhet të saktësohet saktë, sepse lenë amulli nëse thua organi kompetent, nesër atë leje mund ta lëshojë kujt i teket nëse se thua Drejtorati po e zëmë komunal për urbanizëm ose si e ka emrin, drejtorati komunal përkatës, duhet specifikohet qartë sepse kjo po e përsëris lejon mundësinë që s'dihet kush është ai organ kompetent a është në komunë apo në nivel qendror?

Po ashtu te neni 14 te leja e përdorimit, konsiderojmë që edhe këtu duhet të ketë saktësi kush është ai që e jep lejen e përdorimit, është fjala për objektin përkatës, sepse në të kundërtën edhe këtu ka realisht edhe paqartësi edhe do të ketë mundësi të dilemave. Po ashtu edhe një shqetësim që është shfaq edhe në emër të, sa kam parë edhe te komuna tjera, shikoni këtu cenohet për të regjistruar një makinë të zjarrfikësve që është pronë e komunës, ju duhet ta regjistroni në Agjencinë përkatëse për zjarr atje çka është përkatëse, realisht s'je pronar më asaj libreze, duhet ta kesh në emër të atyre dhe ti atë

makinë nëse ju tekët atyre ta marrin dhe e parkojnë ku të donë dhe nuk je pronar. Edhe këtë unë mendoj që do të duhej edhe pa dilemë të jetë kompetencë e komunave. Them thjeshtë mendoj që indicet e tilla që çdo gjë do të duhej të centralizohej nuk e bëjnë një ligj i cili do të mund të ishte në funksional. Fundi i fundit komunat nuk mund të jenë vetëm servis të disa institucioneve qendrore. Faleminderit!

KRYESUESI: Jo, nuk mund të jenë, po s'duhet të jenë, Ismet, ishalla. Komunat servis nuk janë.

Deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj që është koha e fundit që do të duhej të kishte ardhur ky ligj për ta rregulluar këtë fushë. Mendoj që para asaj që është me rëndësi që kjo ose ajo kompetencë të jetë e komunës ose e nivelit qendror, është me rëndësi a do ta kemi një shërbim të saktë, të mirë, funksional për qytetarët e vendit?

Ajo qysh e kemi pasur deri tash në terren ka qenë një gjendje jashtëzakonisht e rëndë, qoftë nga mënyra e trajtimit të këtyre punëtorëve, ju e dini nëpër komuna këta zjarrfikësit janë trajtuar si shërbyes civilë. Pajisjet kryesisht kanë qenë dhe mbeten kryesisht donacion të markave të ndryshme që janë zor të mirëmbahen. Po ashtu sistemi i trajnimit të tyre ka qenë jashtëzakonisht i vështirësuar për shkak të statusit të tyre. Me këtë ligj ndoshta nuk përmbillet krejt, por është një rrugë e mirë dhe është një rast i mirë që t'i jepet përgjigje përfundimtare këtij mekanizmi dhe është rast i mirë po ashtu që me anë të ligjit të ketë një partneritet me qenë se edhe komuna edhe niveli qendror përmes Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave, tani përfundimisht këtë fushë do ta trajtojnë më mirë dhe përmes këtij ligji unë mendoj që po ashtu ka mundësi të ndryshohet për atë janë edhe grupet punuese deri në votimin e fundit.

Ky ligj definitivisht e nxjerr këtë mekanizëm në përputhje me standardet më të mira të vendeve perëndimore. Pas analizave të shumta përmes një rishikimi funksional të institucioneve të Qeverisë, kohë më parë me anë të partnerëve tanë është nxjerrë një ide për me pas këtë ligj dhe unë mendoj që është mënyra më e mirë për ta përmbyll këtë proces të organizimit të trajtimit të emergjencave në Kosovë. Faleminderit!

KRESUESI: Faleminderit!

Nuk ka tjerë deputetë që kërkojnë fjalën. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën. Atëherë, ju lutem, të bëheni gati që ta votojmë në parim Projektligjin për mbrojtjen nga zjarri, votojmë tash.

Në sallë kemi të pranishëm 66 deputetë.

Konstatoj se me 51 vota "për", 15 "kundër" dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për mbrojtjen nga zjarri. Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kadastrë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime. Prandaj, janë përmbushur kushtet për shqyrtim në parim të këtij projektligji. Ftoj ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zotin Dardan Gashi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës ta paraqesë para deputetëve në Kuvend dhe ta arsyetojë këtë projektligj.

DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetët,

I nderuar ministër (a s' paska më asnjë),

Projektligji për kadastrin pason si ndryshim i Ligjit për kadastrë nr. 2003/25 i njëjti më herët ka pësuar ndryshime dhe plotësime me ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për kadastrë të vitit 2007.

Përmes këtij ligji do të ndërtohet kadastrë i cili shërben si bazë për regjistrimin e të drejtave pronësore me krijimin e njësive kadastrale për parcela, ndërtesa, pjesë të ndërtesave dhe **përvojave** dhe në ndërtimin e informacioneve kadastrale.

Kadastrë mbështet veprimet e personave fizikë dhe juridikë për qëllime administrative, juridike, ekonomike dhe shkencore.

Ky projektligj është në pajtueshmëri me legjislacionin dhe politikën e BE-së, nuk ka kërkesa buxhetore, por do të krijojë bazën për krijimin e të ardhurave dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm afarist për biznese në Republikën e Kosovës.

Me këtë projektligj përcaktohet administrimi i kadastrit i cili është regjistër zyrtarë i parcelave, ndërtesave, pjesëve të ndërtesave dhe përvojave, siç janë linjat e tensionit të lartë, të energjisë elektrike, gypat e ujësjellësit dhe kanalizimit e të ngjashme.

Përmes këtij ligji synohet organizimi i strukturave të kadastrave në nivel qendror dhe lokal, fuqizimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të drejtave të pronës së paluajtshme, zbatimi i Direktivës të Komisionit Evropian të vitit 2007 lidhur me të dhënat hapësinore për secilin shtet, të cilat duhet të jenë në pajtim me kriteret dhe normativat e Bashkimit Evropian, krijimin e bazës ligjore për

realizimin e disa projekteve të rëndësishme nga lëmia e kadastrit e në veçanti rindërtimi i informacioneve kadastrale që pritet të financohet nga Banka Botërore e që janë planifikuar të financohen gjatë vitit 2011, si dhe zbatimi i risive në sistemin teknologjik dhe kriterëve të përcaktuara nga instrubucione ndërkombëtare siç janë .. kadastrit në nivelin më të lartë, ku mundësohet krijimi i një regjistri më të kompletuar, krijimi i infrastrukturës shtetërore, i të dhënave hapësinore në Kosovë, si dhe sistemi i adresave në Republikën e Kosovës. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Radha është e raportuesit të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Përshëndetje, kryetar!

Përshëndetje, kolegë deputetë!

Komisioni, në mbledhjen e 3 majit 2011, ka shqyrtuar në parim Projektligjin për kadastrë dhe ka vendosur që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim. Të miratohet në parim Projektligji për kadastrë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën. Regjia, kartela e deputetes Valbona Dibra.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Projektligjin për kadastrin dhe i jep një mbështetje parimore këtij projektligji duke cilësuar si një progres në drejtim të rregullimit të gjendjes kadastrale në republikën e Kosovës dhe vlerësojmë se ky ligj është një përpjekje që të ndryshojë ligji ekzistues për kadastrë dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e kadastrit.

Ligji rregullon disa çështje parimore për gjendjen kadastrale, në radhë të parë definon kompetencat dhe autorizimet e Agjencionit Kadastral të Kosovës, menaxhimin e këtij agjencioni, pastaj rregullon zyrat komunale kadastrale duke vendosur një rend dhe një rregull që ka munguar në komunikimin institucional midis Agjencionit kadastral dhe zyrave kadastrale. Gjithashtu vendos bazat e mira ligjore për rregullimin e fushës së kadastrit, menaxhimin të kadastrit, subjekteve kadastrale dhe segmenteve të rëndësishme për përparimin e këtij segmenti të rëndësishëm të administratës publike.

Kështu që ne e shohim të nevojshme që të miratohet ky ligj, të diskutohet dhe për momentin kemi dy vërejtje parimore që propozojmë që ministri t'i marrë parasysh, sidomos Komisioni funksional.

E para ka materie në këtë ligj komplet kaptina ku flet për rindërtimin e gjendjes kadastrale është një materie politike, një materie që nuk është objekt i normimit ligjor dhe ne sugjerojmë Komisionin funksional që të merret me këtë materie në mënyrë që të mos krijojmë brenda ligjit norma të përkohshme, sepse shtrohet pyetja çka do të ndodhë kur përfundon rindërtimi i aparatit kadastral, a duhet të ndërrohet ligji apo duhet të shfuqizohet ligji, kjo është materie që rregullohet me strategji me strategji të Ministrisë dhe ne mendojmë që duhet të shqyrtohet komplet materia për rindërtimin e aparatit kadastral.

Çështja e dytë, teknika ligjore në këtë ligj nuk është në rregull. Komplet ligji është draftuar me një teknikë jo standarde sepse në disa vende apo me dhjetëra vende në ligji

përdoret shprehja ministri do të bëjë, do të bëjë, domethënë përdoret një situatë hipotetike që nuk është tipike për ligjin, ligji është prekloziv dhe ai gjithmonë merr parasysh normimin pozitiv, normimin e tashëm nuk praktikohet në ligj me thanë do të bëja, pastaj përdoret nëse ka situata hipotetike dhe ne propozojmë Komisionit funksional që krahas diskutimeve të tjera ta rishikojë këtë ligj në aspektin e standardeve të normimit ligjor dhe mos të lejojë situata hipotetike në ligj, sepse ligji është prekloziv dhe duhet të jetë krejtësisht i qartë. Marrë në tërësi ligji është i pranueshëm dhe ne do të japin si Grup Parlamentar kontributin gjatë leximit të dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të LDK-së, deputeti Imri Ahmeti.

IMRI AHMETI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për kadastrë dhe në parim do ta mbështetë këtë projektligj. megjithatë, ka vërejtje të caktuara të cilat në fazat e mëtejshme të shqyrtimit të këtij projektligji do t'i paraqesë.

Gjatë shqyrtimit ne kemi vërejtur se edhe përmes këtij projektligji vërehet një tendencë e centralizimit të kompetencës në këtë fushë dhe një tendencë e favorizimit të sektorit privat në lëmin e gjeodezisë dhe të kadastrit, në raport me zyrat komunale të kadastrit dhe kjo më së mirë mund të ilustruhet në nenin 5.4 ku Agjencia Kadastrale e Kosovës nëse e vlerëson performancën e mirë të një agjencie të sektorit privat, mund të nxjerr vendim për ndërprerjen e kryerjes së matjeve kadastrale nga zyrat komunale të kadastrit. Për ne kjo paraqet një formulim jo të mirë dhe kjo paraqet një sinjal që shumë shpejtë kjo e drejtë do të hiqet komunave dhe do të kalojë në sektorin privat.

Gjithashtu ka çështje të pa harmonizuara në vetë dispozitat e këtij projektligji. Për shembull neni 4.8 Agjencia Kadastrale e Kosovës është përgjegjëse për licencimin e kompanive dhe gjeodetëve, ndërsa në po këtë nen por në pikën 11.3 e propozon anulimin e licencës, pa e specifikuar kujt i propozon këtë anulim.

Ndërkaq, në nenin 11.4 propozon anulimin e certifikatës të aktiviteteve kadastrale në zyrat komunale të kadastrit, do të thotë e rezervon për vete të drejtën Agjencia Kadastrale e Kosovës që kur të dojë të tërheqë certifikatën për zyrat komunale të kadastrit, pa e specifikuar në cilat raste dhe për cilat arsye mund të ndodhë kjo çështje.

Për të mos marrë shumë kohë, besoj që Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës do ta mbështesë në parim duke dhënë kontribut në Komisionin funksional. Faleminderit, për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të "Vetëvendosjes", Afrim Hoti.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes gjatë shqyrtimit kanë gjetur disa vërejtje që unë do t'i paraqes.

Problemi i pronave dhe definimi i titullarëve të pronësisë është një problem shumë i madh dhe i ndjeshëm, si në Kosovë, gjithashtu edhe në vendet me një të kaluar komuniste. Kosova gjatë periudhës së komunizmit zhvilloi një sistem kadastral të menaxhimit të pronave në një masë që mund të quhet i kënaqshëm, përpos problemeve që kanë qenë si rezultat i sistemit socialist të trajtimit të tokës. Ka munguar evidenca e saktë kadastrale mbi gjeometritë e pronave dhe titujt e pronësisë. Një problem tjetër evidentë është edhe çështja e përkufizimit të kufijve të jashtëm të Kosovës, problem ky i cili kërkon një qasje serioze dhe profesionale si nga ana e pushtetit qendror ashtu edhe atij lokalë. Marrë në përgjegjësi Projektligji për kadastrin është draftuar në mënyrë shumë të cektë dhe nuk garanton qartësi të plotë gjatë implementimit të tij. Për shkak të disa veprimtarive që përshkruhen në këtë projektligj si për shembull: incizimet ajrore, sistemi i adresave dhe përvojave nuk ofron garanci buxhetore dhe kapacitete adekuate që do të mundësonin implementimin e këtij ligji dhe këto veprimtari nuk janë praktika botërore. Për shembull në kreun e II neni 4.5 thuhet se kryeshefi i agjencisë i përgjigjet ministrit, ky nen nuk duhet të ishte fare në këtë projektligj, sepse kjo çështje është e rregulluar me ligje të tjera të shërbimit civil.

Po ashtu, edhe neni 4 dhe 5 nuk janë kompakt në vete dhe nuk e zgjidhin strukturën organizative të institucioneve të kadastrës. Për shembull në nenin 5.1 thuhet se zyra përkatëse komunale kadastrale është organ komunal. Mendoj se kjo zyrë duhet të funksionojë në kuadër të kuvendit komunal, por të jetë organi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, sepse deri më tani këto zyra janë organe komunale dhe përgjegjësia e tyre profesionale e stafit të tyre është shumë e vogël. Në mungesë të kësaj përgjegjësie në shumë zyra komunale kadastrale kanë ndodhur keqpërdorime të detyrës zyrtare dhe shërbim shumë i dobët për qytetarët. Kadastrin është lëmi shumë komplekse për nga ana profesionale dhe organet komunale nuk janë në gjendje të bëjnë një monitorim të mirëfilltë profesional të këtyre zyrave, si dhe nuk çmohet sa duhet nga ana e tyre ngritja e kapaciteteve profesionale të këtyre zyrave.

Në nenin 6.1 të këtij projektligji thuhet se Agjencia Kadastrale e Kosovës licencon kompanitë gjeodete dhe gjeodetët. Mendohet se pas kësaj pike do të duhet të shtohet edhe një pikë tjetër, ku do të cekej se me krijimin e Odës së Gjeodetëve Profesionalistë kjo përgjegjësi do t'i bartej kësaj ode. Arsyeimi i kësaj që e thashë është se licencimi i kompanive dhe gjeodetëve nga Agjencia Kadastrale e Kosovës ka filluar që nga viti 2008, licencimi është një kompetentë shtetërore e deleguar te sektori privatë vetëm për matjen në terren. Në të gjitha vendet e zhvilluara evropiane ky licencim bëhet nga Oda e gjeodetëve e cila në mënyrë strikte do t'i monitoronte punët e tyre dhe do t'i ndihmonte institucionet shtetërore.

Në këtë rast Agjencinë Kadastrale të Kosovës për mbikëqyrje profesionale sipas dispozitave të cilat do të krijoheshin në Kreun e III, neni 2.2.4 flitet për përvojat, përvojat duhet të hiqen si njësi kadastrale pasi që nga praktikat botërore kadastrin i përvojave nuk menaxhohet nga kadastrat e tokës, por nga komunat dhe kompanitë publike.

Neni 11, po ashtu duhet të hiqet pasi figuron i panevojshëm dhe është i pa i implementuar dhe tani nuk është pjesë e kadastrit. Po ashtu edhe neni 16 është i panevojshëm.

Ndërsa neni 22, duhet të hiqet nga projektligji pasi që nuk konsiderohej se është normale që Agjencia Kadastrale e Kosovës të jetë kompetente për bërjen e incizimeve ajrore. Kjo është punë e kompanive private dhe nuk ka ndonjë shembull në botë që ndonjë agjenci e tillë merret me këtë punë, përpos rasteve kur agjencitë kadastrale kanë institute të posaçme gjeodezike.

Edhe neni 23 duhet të hiqet nga ligji pasi që kjo është kompetencë e komunave dhe Zyrës së regjistrimit civil. Është e pakuptim që Agjencia Kadastrale e Kosovës të merret me aktivitete të tilla kur ka shumë probleme të karakterit kadastral të pazgjidhura. Ekzistojnë edhe shumë përskrime të tjera që është vështirë të kuptohen edhe nga vetë profesionistët, për shembull në Kreun e VII, neni 29.2 përskruhet që vendimet e tilla i merr ministria kjo nuk do të ishte praktikë e mirë dhe bie ndeshë me rregulloren për funksionimin e qeverisë. Pasi që Agjencia Kadastrale mund të mos jetë në varësi të ministrit por kryeministrit apo Kuvendit. Po ashtu edhe aspekti financiar dhe kostot e projektligjit nuk janë të shpjeguara si duhet. Për shembull në nenin 30 thuhet se kryeshefi e përgatit buxhetin e agjencisë, gjë që mua më duket një termë joparimor.

Me këtë unë do të përfundoja duke shtuar se nuk mund të ketë investime serioze pa një kadastrë funksionale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Fillimisht dua të them se Grupi Parlamentar i Aleancës do ta mbështesë në parim këtë projektligj dhe do të provojë që kontributin e vet ta japë nëpër komisione ku do të kalojë projektligji, ndërsa unë personalisht dua të them se ky është një shembull tipik i një projektligji ku ka munguar vizioni politik, po administrata e ka hartuar ligjin. Nuk duhet të ketë dro ministri për shkak se ky ligj është hartuar para se ta marrë detyrën ministri Dardan Gashi, mirëpo shihet tepër qartë që në këtë rast kemi të bëjmë me një rast tipik kur administrata harton ligjin e politika duhet ta votojë, domethënë që është paradoks që rrallë ndodhë, ndërsa lidhshipi politik i Qeverisë, zoti ministri që ka qenë në detyrë mungon absolutisht, totalisht për shkak se idetë politike janë, ky ligj është zhveshur prej politikës e nuk guxon të jetë kështu, domethënë nëse dikush keqkupton politika është ajo që vendos se çka ndodh me vendin, ndërsa administrata i kryen punët edhe i zbaton.

Në anën tjetër, ndoshta e ka një të mirë projektligji është i shkruar shumë mirë, është ndër ligjet e radha që vinë që është shkruar mirë, që shihet qartë se çka donë hartuesi i ligjit që në këtë rast nuk është Qeveria e Kosovës paradoksalisht është administrata edhe Agjencioni Kadastral, domethënë është Ministria e Mjedisit dhe Agjencioni Kadastral, e di që ka kapacitete në Ministri të Mjedisit për të shkruar ligje, mirëpo, kjo nuk është mënyra qysh duhet të punohet në demokraci. Udhëheqjen politike, vijat politike i

përcakton politika, që do të thotë Qeveria që është e zgjedhur politikisht, ndërsa administrata kryen pjesën tjetër të punës.

Ndoshta tani na shndërrohet pak punë më e lehtë në komisione që Kuvendi ta japë vinë politike, me qenë se Qeveria nuk e ka dhënë, me qenë se po them edhe një herë projektligji është i punuar mirë duke pasur parasysh synimet për të cilat shihet qartë se ekzistojnë, i thanë parafolësit e mijë, janë disa synime të cilat definitivisht se politika do të hezitonte t'i jepte. Në aspektin e shtruarjes së ligjit i kisha përgëzuar edhe Ministrinë e Mjedisit edhe Agjencionin Kadastral, mirëpo ish -ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë ka qenë dashur t'i japë idetë e veta politike ose të Qeverisë, idetë politike të Qeverisë se çka synojmë të arrijmë me këtë ligj.

Edhe një herë do ta votojmë projektligjin se është tepër i domosdoshëm dhe do të synojmë që bashkë me grupet tjera parlamentare, të arrijmë që të kemi një dorë të vendimeve çfarë duhen të jenë sa i përket këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar për Koalicionin Kosova e Re, Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, i nderuari zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re përkrahë në parim Projektligjin për kadastër, vërejtjet dhe sugjerimet tona do t'i përcjellim në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputetja Jasmina Zhivković e ka fjalën.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem, predsjedniče!

Parlamentarna grupa SLS je upoznata sa sadržajem Nacrta zakona o katastru, samim tim upoznata je sa prednostima i nedostacima ovog Nacrta zakona. Grupa je odlučila da podrži ovaj nacrt, a svoj doprinos daće kroz odgovarajuće komisije. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar "6+", deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuari zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pas shqyrtimit të detajizuar të Projektligjit për kadastër dhe pas rekomandimit dhe arsyetimit nga ana e Komisionit përkatës dhe pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara të nevojshme, Grupi Parlamentar "6+" në parim do ta votojë këtë projektligj për kadastër, kurse vërejtjet e mundshme dhe kontributin do ta japë përmes Komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të lajmëruar nuk kemi për debat.

Në sallë kemi 67 deputetë.

Kështu po hymë në procedurën e votimit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatoj se më 54 vota “për”, 8 “kundër” dhe një abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për kadastër.

Kërkohet nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

Me këtë konstatoj përfundimin e punimeve të kësaj seance plenare. Mirupafshim, në mbledhjen e ardhshme!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve